



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 23 QERSHOR 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 23.
JUNA 2009. GODINE

QERSHOR – JUNI
2009

Seancën e kryesoi, **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 97 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Në agjendën e sotme kemi vetëm një pikë të rendit të ditës. Po i paralajmëroj edhe deputetët që janë lajmëruar për fjalë. Driton Tali, e ka kërkuar fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Duke pasur parasysh atë që po ndodh në Parlament dhe pa dashur që të bëhet kjo praktikë apo ta teproj dhe ta patronizoj këtë foltore, më duhet t'ju drejtohem juve dhe opinionit të gjerë për një fenomen që nuk po ka të ndalur, ai është presioni dhe kërcënimet që po na bëhen ne deputetëve për arsye të ndryshme.

Unë personalisht ka kohë që marr kërcënime të llojeve të ndryshme, por të shtunën e kaluar, pra, para tri ditësh, në një lokal të Prishtinës, derisa unë po dilja nga ai vend, m'u afrua zoti Luan Berisha me fjalët: "T'i ma ke përmendur emrin", duke aluduar në seancën e kaluar, ku debatua për privatizimin në Kosovë dhe pastaj m'u kërcënua dhe më ofendoi. Është shumë e vërtetë që unë emrin e këtij personi e pata përmendur në debatin për privatizim, që e mbajti Kuvendi para disa javësh. Siç e dini, të nderuar të pranishëm, në atë seancë pata thënë, mes tjerash, se ajo që ka ndodhur gjatë privatizimit, është për të dhembur barku. Nëpunësi shumë i lartë i AKM-së, Luan Berisha, menjëherë pasi u privatizua "Llamkosi" bëhet drejtor gjeneral i "Llamkosit", pra i ndërmarrjes, privatizimi i së cilës është shumë i dyshimtë, për çka kanë pësuar jo vetëm qindra punëtorë dhe familjet e tyre, por edhe tërë ekonomia kosovare.

Të nderuar qytetarë,

Kalimi i një nëpunësi shumë të lartë nga institucioni apo agjencioni, i cili e privatizon ndërmarrjen në fjalë, si drejtor gjeneral në atë ndërmarrje, është në kundërshtim me normat dhe praktikat afariste, për shkak të dyshimeve për marrëveshje të brendshme.

Dhe, siç po shihet, zotit Luan Berisha nuk i pengon që të bëjë veprime të tilla, por i penguaka se një deputet po ia përmendka emrin, shih ti, dhe atij deputeti i kërcënohet dhe e fyen. Për këtë që po e them, kam edhe dëshmitarë.

Unë po i them zotit Luan Berisha, por edhe vagabondëve të tjerë, se do të vazhdoj kështu, siç kam bërë deri më tani, duke i përmendur me emra, pa pardon, të gjithë ata për të cilët kam fakte, e ata le të vazhdojnë të më kërcënojnë dhe të bëjnë presione, shantazhe të ndryshme.

KRYETARI: Regjia, ia zgjatni pak kohën!

DRITON TALI: Unë do të vazhdoj kështu, sepse kështu i kam premtuar elektoratit dhe do të vazhdoj edhe më tutje t'i mbaj premtimet e mia derisa ta kem mandatin. Po ashtu,

unë do të vazhdoj ta bëj jetën time të zakonshme, ashtu siç e kam bërë deri më tani, e vagabondët dhe rrugaçët e Kosovës le të vazhdojnë të ma zënë rrugën e të më kërcënojnë, ta shohim se a do të kenë sukses. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Unë, për hir të së vërtetës, dua të them se çështjet e tilla nuk janë për seancën plenare, janë për polici dhe mendoj që është mirë që këto kërcënime t'i qoni në adresë të duhur dhe të mos e shfrytëzoni Kuvendin për çështje të tilla. Faleminderit! Do të thotë, kanë tërhequr fjalën të tjerët.

Vazhdojmë. Në agjendë të sotme kemi vetëm një pikë të rendit të ditës:

- Informata për incidentin në Dhomën e Provave të Policisë së Kosovës

Para se të fillojmë me procedim të mëtejshëm, ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 22.7 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje të plotë me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2009, ka arritur marrëveshje për formën dhe kohëzgjatjen e diskutimeve për debatin lidhur me pikën e sotme të rendit të ditës. Pra, Kuvendi duhet ta dijë se Kryesia ka vendosur dhe ka autorizuar Kryetarin që ta thërrasë për një informatë, që më tepër do të duhej të ishte interpelancë se sa debat, por megjithatë, Kryesia ka vendosur kështu me shëfat e grupeve parlamentare.

Diskutimi për deputetët duhet të zgjasë deri në 5 minuta, ndërsa për anëtarët e Kryesisë, kryetarët e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisionit funksional, deri në 10 minuta. Fjala hyrëse dhe sqarimet e ministrit janë të pakufizuara.

Në pajtim me Rregullën 22.7 të këtij propozimi, e hedh në votim vendimin që faktikisht ka qenë vendim i Kryesisë me shëfat e grupeve parlamentare.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se më 69 vota “për”, 8 “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet vendimi i Kryesisë dhe i shëfave të grupeve parlamentare. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me procedimin e mëtejshëm. Ftoj ministrin për Punë të Brendshme, zotin Zenun Paraziti, që para deputetëve të paraqesë informatën.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Zoti Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj fillimisht t'ju them që kam përgatitur një informatë, jo shumë të zgjeruar për rastin, për shkak të sugjerimeve që kam marrë nga hetuesit, për shkak se procesi është në dinamikë, në pikën më dinamike të hetimit dhe gjithçka që mund të jepej më shumë, kam sugjerimin që mund ta komprometojë procesin e hetimit të rastit.

Më lejoni, po ashtu, të shpreh konsideratën time për deputetët për shkak se kohëve të fundit, siç e dini, kemi pasur në Kosovë momente të rëndësishme të sigurisë dhe Kuvendi i Kosovës i ka trajtuar të gjitha këto dhe shumica prej këtyre, për të mos thënë të gjitha këto çështje, kanë mbetur të trajtuara vetëm në aspektin e sigurisë dhe me kujdesin më të madh ato nuk janë politizuar për qëllime politike ose qëllime të tjera.

Më lejoni t'ju kumtoj këto informata të cilat i kam marrë nga Policia e Kosovës dhe të cilat fokusohen në çështjen ose në rastin e Dhomës së Provave në polici.

Në bazë të raportit të Policisë së Kosovës, jam informuar se më datën, në natën mes 24 e 25 prill 2009, persona, deri më tani ende të panjohur, duke kaluar pengesat fizike, përfshirë murin me tela gjemborë, nga ana e pasme e objektit dhe duke shfrytëzuar shkallët emergjente prapa objektit të Policisë së Kosovës, përmes derës për hyrje - dalje emergjente, në katin e pestë, kanë hyrë brenda objektit ku ka qenë Dhoma e Dëshmive. Përkundër asaj që dhoma ku janë mbajtur evidencat ka qenë e siguruar me dy dyer, njëra e rëndomtë, ndërse tjetra e hekurt, kryesisht kanë arritur që me forcë, duke përdorur mjete të forta, t'i hapin dyert dhe të depërtojnë brenda në këtë dhomë.

Në bazë të regjistrimit të evidencave të ruajtura nga policia, është konstatuar se me këtë rast janë vjedhur: 47 kilogramë e 627 gramë substanca narkotike të llojit heroinë, të cilat kanë të bëjnë me tri raste të ndryshme, 3828 euro, 520 rupi të Indisë, 6.5 milionë lira të Turqisë, 5000 lejë të Rumanisë dhe 950 lekë të Shqipërisë, që kanë të bëjnë gjithsej me 4 raste të ndryshme.

Po ashtu, dua të sqaroj edhe para jush, me qenë se ka pasur interpretime të tjera në media, se nuk bëhet fjalë për shuma të mëdha kur është fjala për lira të Turqisë, por është për një shumë simbolike, diku as 10 euro.

Masat e ndërmarra: Policia e Kosovës ka ndërmarr një sërë veprimesh operative të përcaktuara me parime dhe procedura të policisë për sigurimin e vendit të ngjarjes ku ka ndodhur rasti dhe me qëllim të mbledhjes si dhe sigurimit të dëshmive dhe provave si pjesë e procedurës hetimore.

Fillimisht, pjesëtarët e policisë kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin dhe ekzaminimin e vendit të ngjarjes, duke angazhuar njësitë e specializuara të krim-teknikës dhe shikimin e vendit të ngjarjes.

Si rezultat i shikimit të vendit të ngjarjes dhe mbledhjes së gjurmëve nga njësitë e specializuara, janë kryer një sërë veprimesh, duke grumbulluar gjurmë dhe mikrogjurmë të cilat janë dërguar në laborator për ADN. Janë marrë gjurmë të gishtërinjve me gjurmë të tjera të vendit të ngjarjes.

Me qëllim të koordinimit më të mirë të veprimeve hetimore- operative, analitike dhe të mbështetjes së nevojshme administrative, në momentin që jam njoftuar nga drejtori i përgjithshëm, kam kërkuar nga ai që ky rast të trajtohet me një prioritet absolut. Si rezultat i kësaj, drejtori i përgjithshëm i policisë, në bazë të kompetencave që ka, ka angazhuar një ekip të hetuesve policorë profesionalë për zbardhjen sa më të shpejtë të të gjitha rrethanave, motiveve dhe implikimeve të tjera në lidhje me të dyshuarit, arrestimin dhe sjelljen e tyre para drejtësisë.

Detyrat dhe angazhimet e Grupit hetues ose të task-forcës, si është quajtur në opinion, janë mbështetja e hetuesve bartës të lëndës në grumbullimin, hulumtimin dhe analizën e të gjitha informacioneve në lidhje me rastin, mbështetja dhe koordinimi i veprimeve në organizata, në institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, koordinimi me Policinë e EULEX-it, me polici të vendeve fqinje, por edhe të vendeve të tjera, si dhe mbështetja e nevojshme logjistike dhe administrative.

Prej momentit kur ka ndodhur rasti, janë zhvilluar hetime intensive nga zyrtarët policorë nën udhëheqjen e prokurorit. Rasti është në mbikëqyrjen e prokurorit ndërkombëtar nga Prokuroria Speciale dhe janë duke u zhvilluar hetime ndaj disa të dyshuarve të mundshëm.

Në vazhden e veprimeve hetimore, Policia e Kosovës, më datën 2 qershor 2009, gjatë një operacioni në pikën kufitare Hani i Elezit ka arrestuar tre persona meshkuj, kurse 2 femra janë shoqëruar në polici. Për shkak të përcjelljes për një kohë të gjatë nga policia e të dyshuarve, në momentin që ata kanë tentuar për t'u larguar nga Kosova, policia ka zhvilluar operacionin e kapjes së tyre në pikën kufitare të Hanit të Elezit. Dëshiroj t'ju njoftoj se kjo është vetëm një nga pistat e hetimeve të policisë që ka qenë. Arrestimi është bërë me dyshimin se këta persona janë involvuar në aktivitete kriminale.

Në momentin e arrestimit, njëri nga të dyshuarit kishte dokumente dhe identitet të rrejshëm dhe të falsifikuar dhe i njëjti ka tentuar të arratisë nga pika kufitare në kohën kur ishte duke kaluar kufirin, mirëpo policia kishte arritur që ta arrestojë. Ndërkohë, janë arrestuar edhe dy meshkuj të tjerë, të cilët kishin identitet të rrejshëm, si dhe janë shoqëruar edhe dy femra që ishin së bashku në automjet.

Në lokacionet e personave të armatosur është kryer kontrollimi i shtëpive, ku është konfiskuar një armë automatike AK-47, një maskë dhe dëshmi të tjera.

Nga tre të arrestuarit, dy prej tyre kishin urdhër arrest më herët për vepra penale, tentim vrasje dhe armëmbajtje pa leje nga Prokuroria e Qarkut në Prishtinë dhe Mitrovicë. Personat e arrestuar janë duke u hetuar nga policia dhe për involvimin e mundshëm të tyre në vjedhjen e rëndë në Dhomën e Dëshmive në polici.

Më lejoni të kaloj edhe në disa informacione që kanë për qëllim edhe sqarimin e përgjegjësisë, në këtë drejtim.

Ju e dini se Ligji për policinë i përcakton qartë edhe përgjegjësitë tona menaxheriale. Drejtori i përgjithshëm i Policisë, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe zbardhjen e këtij rasti, ka themeluar grupin e veçantë ose task-forcë për mbështetjen e hetimit të rastit.

Në bazë të Ligjit për policinë, drejtori ka pavarësi operacionale në menaxhimin dhe udhëheqjen me Policinë e Kosovës dhe si rezultat i shfrytëzimit të autorizimeve të tij, ai ka themeluar këtë grup të veçantë për ta mbështetur hetimin, ose për t'i mbështetur hetimet që janë duke u zhvilluar nga hetuesit dhe bartësit e rastit.

Gjithashtu, me këtë rast, drejtori i Policisë ka suspenduar 5 zyrtarë policorë, nga të cilët disa kanë qenë përgjegjës për sigurinë e objektit, ndërsa disa të tjerë kanë pasur përgjegjësi menaxheriale.

Sa i përket involvimit të Inspektoratit Policor, ju informoj se në bazë të Ligjit për inspektoratin policor, Inspektorati është i autorizuar të zhvillojë inspektime dhe të raportojë për punën dhe efikasitetin e punës së policisë si dhe ka autoritet t'i hetojë shkeljet e rënda disiplinore, pra të zhvillojë procedura hetimore dhe administrative.

Inspektorati është duke zhvilluar procedurën e inspektimit dhe hetimit administrativ në bazë të autorizimeve që ka dhe varësisht nga zhvillimi i këtyre aktiviteteve ata rekomandimet do t'i sjellin me kohë.

Pa dyshim se rasti i vjedhjes në Dhomën e Dëshmive ka dëmtuar rënd imazhin e Policisë së Kosovës. Që prej fillimit kemi kërkuar nga menaxhmenti i Policisë së Kosovës trajtim të këtij rasti me prioritet absolut, duke u fokusuar në dy aspekte, në adresimin e përgjegjësisë penale, duke zbardhur në tërësi rastin dhe duke sjell para drejtësisë, kryesisht, kryerësit e kësaj vepre të rëndë penale si dhe adresimin e përgjegjësive menaxheriale.

Më lejoni t'ju siguroj se për zbardhjen e këtij rasti janë angazhuar hetuesit dhe zyrtarët policorë më të dëshmuar të Policisë së Kosovës të cilët po punojnë me profesionalizëm dhe përkushtim të lartë për zbardhjen e rastit.

Edhe një herë shfrytëzoj rastin t'i falënderoj deputetët për interesimin e treguar gjatë gjithë kohës, edhe Komisionin Parlamentar për Siguri dhe sqarimet që i dhashë, sidomos për involvimin e Inspektoratit edhe të përgjegjësitë menaxheriale janë kryesisht çështje që janë adresuar disa herë, janë kërkuar edhe nga Komisioni Parlamentar për Siguri.

Zbardhja e rastit dhe sjellja para drejtësisë e të gjithë atyre që kanë qenë të përfshirë në këtë vepër penale, duke mos përjashtuar as zyrtarët policorë, nuk ka alternativë dhe në bazë të raporteve të dinamikës aktuale të procesit hetimor, ju siguroj se do të ketë rezultate konkrete në këtë drejtim.

Më lejoni t'ju them, përpos gatishmërisë tonë për përgjegjësi në çdo rast, jemi shumë të vendosur që të vazhdojmë luftën kundër krimit në përgjithësi. Ju e dini, përkundër rastit, përkundër që një pjesë e madhe e zyrtarëve, oficerëve të policisë, menaxherëve, e kanë përjetuar rënd dhe ka qenë shokues rasti për ta, ata kanë vazhduar me aktivitete dinamike dhe ju keni pasur rast disa prej tyre t'i shihni edhe të plasura në media.

Më lejoni t'ju them po ashtu që Ministria dhe në përgjithësi ministri nuk ka ose ka mundësi të kufizuar ose hapësirë të kufizuar të ndërhyjë në çështjet që janë operacionale të policisë. Me Ligjin për policinë, ministri ka përgjegjësi për zhvillimin e politikave të policisë, përcaktimin e prioritetëve, mbështetjen në zbatimin e legjislacionit, mbikëqyr koordinimin ndërmjet policisë dhe autoriteteve të tjera publike, mbikëqyr bashkëpunimin midis policisë dhe agjencive të tjera dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, zhvillon dhe zbaton strategji për marrëdhënie me publikun dhe marrëdhëniet me organet e tjera përgjegjëse në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, zbaton procedura disiplinore siç është përcaktuar me ligj e tjerë.

Do të ishte e padrejtë, në raste të tilla, pavarësisht se jemi tubuar këtu për një rast që ka dëmtuar imazhin dhe interesimi i gjithë neve është që edhe të zbardhet rasti edhe të ketë përgjegjësi edhe të mos ndodh ky rast, do të ishte e padrejtë sikur të trajtohet ky rast, pa u përmendur edhe aktivitetet e shumta të policisë dhe angazhimin e tyre që në masën më të madhe janë aktivitete të cilat e kanë ndërtuar një imazh pozitiv në opinionin publik, një imazh i cili është konsideruar pozitiv, jo vetëm nga institucionet vendore- qytetarët, por edhe nga institucionet ndërkombëtare.

Polica e Kosovës, me aktivitetet e veta e ka bërë që të kemi ndryshime pozitive për sa i përket krimit në përgjithësi, krahasuar me vitin paraprak.

Të gjitha shënimet që unë i kam sjell, nëse do të ketë nevojë më vonë unë do t'i përmend, është me rëndësi të ceket po ashtu që Policia e Kosovës, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe më në fund si organ që është në kuadër të institucioneve tona, ka marrë përgjegjësitë që të jetë aktive në hartimin e të gjitha strategjive që ne sot jemi duke i përfunduar ose disa prej tyre i kemi përfunduar dhe, do të jetë pjesë aktive në implementimin e tyre, siç janë: strategjia kundër trafikimit me qenie njerëzore, kundër trafikimit me narkotikë, kundër krimit të organizuar, kundër terrorizmit, strategjisë e sigurisë nacionale e tjerë.

Kemi statistika sipas komunave ku policia u ofron asistencë institucioneve të ndryshme. Institucionet, të cilat në baza ditore marrin asistencë nga Policia e Kosovës janë, jo vetëm ato vendore, por edhe ndërkombëtare: Agjencioni Kosovar i Pronës, KEK-u, kuvendet komunale, inspeksionet komunale, Agjencioni Pyjor i Kosovës, Agjencioni Tatimor i Kosovës, agjencionet private të ndryshme, gjykatat, prokuroritë e tjera.

Policia e Kosovës ballafaqohet ose menaxhon edhe vizitat e delegacioneve ndërkombëtare. Në vitin 2008 Republikën e Kosovës e kanë vizituar 131 delegacione ndërkombëtare, nga të cilat, prej shumicës prej tyre, Policia e Kosovës ka marrë mirënjohje për shkak të profesionalizmit dhe trajtimit të këtyre vizitave.

Më lejoni t'ju them që një çështje tjetër e cila e fokuson rolin pozitiv të policisë është edhe lufta e trafikimit me narkotikë dhe së fundi lufta kundër trafikimit. Ju e keni parë raportin nga Stejë Departamenti, Kosova me gjithë atë që është përfshirë për herë të parë në këtë raport, është viti i parë si shtet, jemi rangu në listën, në nivelin me disa vende anëtare të BE-së. Pra, nuk jemi rangu me shumë vende të regjionit të cilat janë në pozita shumë më të ulëta dhe kanë probleme më të mëdha sa i përket trafikimit me qenie njerëzore.

Më lejoni t'ju them që një çështje- sfidë që mbetet për policinë ose për angazhimin e policisë është bashkëpunimi me gjyqësorin. Unë ju përmenda vetëm një rast, i cili involvohet me rastin e incidentit në Dhomën e Provave. Ndodh një arrestim, ku është bërë një hetim i gjatë, janë nën akuza për vepra të ndryshme të krimit të organizuar. Gjatë arrestimit ka pasur tentim të largimit, janë gjetur armë dhe janë liruar, ose një prej tyre, aktori kryesor i kësaj veprë është liruar menjëherë.

Dëshiroj t'ju them që kam statistika sa persona në Kosovë kapen nga policia për armëmbajtje pa leje dhe ju e dini që kjo është vepër penale dhe asnjë prej tyre nuk mbahet -lirohen menjëherë prej gjykatave. Nuk dëshiroj që sot temë të jetë diçka tjetër, unë po ju them që ka mbështetje shumë të vogël, pa e mohuar një rol shumë të madh të numrit të madh të gjykatësve që e bëjnë punën e tyre me përkushtim.

Dëshiroj t'ju them që do të mbetem i hapur për pyetje. Ne do të vazhdojmë, përveç asaj që do të kem gatishmëri për përgjegjësitë tona, me vendosmëri të bëjmë angazhimet tona edhe Policia e Kosovës do të ketë dinamikë të madhe në agjendën e vet për sa i përket luftimit të krimit në përgjithësi. Dhe, po ashtu dëshiroj t'ju them që jemi në fazë të reformave. Edhe Departamenti ku ka ndodhur incidenti është nga departamentet e fundit i tranzicionuar. Vetëm disa ditë para se të ndodhte rasti janë larguar edhe zyrtarët e fundit ndërkombëtar që kanë qenë këtu e të punësuar aty. Pra, kem të bëjmë me një fazë shumë dinamike të tranzicionit. Jemi në rishikim të organizimit të Policisë dhe kjo dinamikë ka filluar më herët. Është një projekt i mbështetur nga partnerët ndërkombëtar që ka të bëjë me rishikimin e strukturave në përputhje me legjislacionin e ri.

Përkundër krejt kësaj dinamike të reformave, ne do të vazhdojmë të punojnë me angazhimet e shtuara, jo vetëm për rastet më konkrete, por në përgjithësi për sundimin e ligjit në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Radha është e Komisionit. E ka fjalën kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Rrustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Zoti Kryeministër,

Zoti ministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë dëgjova fjalën e ministrit dhe më lejoni këtu t'i paraqes disa fjalë dhe mendime të komisionit, të cilin e përfaqësoj sot para jush.

Ka qenë dhe është evident shqetësimi i opinionit publik pas lajmit në media lidhur me vjedhjen në polici dhe konfuzionit të krijuar nga heshtja, joprononcimi nga përgjegjësit brenda strukturave të Policisë së Kosovës për një informim të drejtë lidhur me rastin.

Kjo bie ndesh me Kodin Evropian të Etikës Policore, rekomandimi 2001/ 10 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, 19 shtator 2001, në kapitullin IV, përgjegjëshmëria dhe kontrolli i policisë, pika 62: “ Duhet të nxiten mekanizma për përgjegjëshmërinë, të bazuar në komunikimin dhe mirëkuptimin reciprok midis publikut dhe policisë”.

Kjo mund të krijojë dyshimin se ndoshta edhe në të kaluarën kanë mund të ndodhen edhe raste të tjera dhe ato janë heshtur brenda kuluareve të brendshme të policisë së vendit tonë.

Unë jam interesuar ta di qysh janë edhe qytetarët e Kosovës, mirëfilli për ngjarjen se si ka ndodhur. Do të ishte mirë të raportohet në këtë Kuvend dhe të dihet se cilat kanë qenë veprimet e Drejtorisë së Policisë pas pavarësimit të policisë së vendit, të Kosovës, lidhur me shfrytëzimin e përbashkët të objektit të policisë. Dihet se në objektin ku është bërë krimi, prej kohës së UNMIK-ut dhe vazhdojnë edhe sot e tutje të jenë bashkë dy organe, Prokuroria dhe Policia. Dihet mirëfilli se në policinë e vendit tonë prej vitit 1999 e tutje kush ka mund të jetë i policisë dhe a janë nënshtruar këta policë ndonjëherë kontrollit, të CV-së së tyre para organeve tona përgjegjëse të shtetit. Ne nuk kemi informata që është bërë një punë e tillë dhe duhet të bëhet kjo sa më herët që është e mundur.

Është bërë fjalë shumë për Inspektoratin Policor të Kosovës. Ne në Raportin për vitin 2008 kemi gjetur se me kërkesën e ministrit të Punëve të Brendshme është bërë auditim edhe ka pasur rekomandime nga inspektorati, të cilat nuk janë përfillur nga shefi i policisë së vendit dhe nga menaxhmenti i policisë së vendit. Kjo na ka bërë që niveli për ta kuptuar në komisionin, në gjithë komisionin të cilin unë e drejtoj, se përgjegjësia politike është zvogëluar, në këtë rast, pasi që Qeveria ka kërkuar auditim dhe inspektim nga ky mekanizëm. Po, mbetet e paqartë se a ka pasur kërkesa nga menaxhmenti i Policisë së Kosovës herë pas herë që të shikohet se çka është bërë me ato rekomandime, që shihet mirëfilli se janë dhënë për pasigurinë edhe në vendin ku është bërë vjedhja.

Ne në komision kemi bërë fjalë shumë për task-forcën. Ka pasur mendime se është e paligjshme deri te funksionimi, qysh është duke funksionuar. Kemi ardhur në përfundim se task-forca nuk është e paligjshme, mirëpo task-forca ka pamundësuar për t'u koordinuar me mekanizma të tjerë të sigurisë me agjencion ... qysh është EULEX-i dhe mekanizma të tjerë të shteteve për rreth për t'u koordinuar mirë fillimi edhe mekanizmat e tjerë institucional në vend për ta zbuluar rastin më shpejt që ka qenë e mundur.

Rasti është vlerësuar si vepër penale dhe deri tash kryesit janë të panjohur. Policia ka marrë një varg masash, ka suspenduar disa njerëz, a në fakt nuk kemi asnjë njohuri për ta se deri ku kanë shkuar hetimet. E dimë që njerëzit e Drejtorisë për Krime të Rënda, gjithashtu edhe të sigurimit të objekteve me rëndësi të veçantë, është dashur të merren në përgjegjësi edhe të shihet jo veç nga sistemi menaxherial, nga Policia e Kosovës, por edhe nga Ministria se ku është procesi me këto të dhëna?

Unë e di se në komision kemi filluar që në ditën e parë kur kemi marrë vesh dhe kemi ftuar, përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës në raport para komisionit.

Komandanti i Policisë së Kosovës nuk ka ardhur para komisionit. Drejtorët që janë ardhur para komisionit për të raportuar kanë lajmëruar se ai deri sa në orën 10,00 po zhvillohej takim me ne, ai në orën 13,00 do të udhëtonte për Mal të Zi. Dhe, me të drejtë ne në komision kemi thënë që komandanti i Policisë së Kosovës nuk e duron sistemin e kontrollit parlamentar. Pas kësaj kemi thirrur edhe ministrin, zotin Zenun Pajaziti, në komision dhe ne kemi qenë të kënaqur me komunikimin e komisionit me ministrin.

Komisioni disa herë radhazi deri sa kemi sjellë edhe vendim, ka nxjerrë rekomandimin për shkarkimin nga përgjegjësia menjëherë të drejtorit të Policisë dhe ne nuk kemi rekomanduar Policinë e Kosovës, por kemi rekomanduar Qeverinë e Kosovës. Unë në çdo moment edhe para jush, edhe para gjithsecilit them se është e drejtë e komisionit, e drejtë kushtetuese e rregullave të Kuvendit dhe të rregullave të tjera ligjore në fuqi që ka të drejtë t'i rekomandojë Qeverisë për përmirësimin e gjendjes në siguri në vend dhe kemi bërë një gjë të tillë. E kemi bërë duke e parë në vazhdimësi përgjegjësinë e këtij njeriu në pozitën që e ka mbajtur edhe më herët, jo vetëm lidhur me këtë rast.

Më lejoni që t'i paraqes disa fakte. Zoti Sheremet Ahmeti duhet të largohet nga posti sipas nenit 43.1 (c) për mosplotësimin e detyrave dhe të përgjegjësi të caktuara si zëvendës komisar për Shërbimin Policor të Kosovës, gjatë mandatit të Policisë së UNMIK-ut, përherë ka preferuar t'i shmanget përgjegjësisë, nga edhe rasti.

Vrasja e dy qytetarëve në Pejë, ky rast është heshtur me ndërmarrjen e disa masave të brendshme administrative dhe ngjarja kaloi në harresë. Vrasja e dy qytetarëve në protestën e Lëvizjes për Vetëvendosje, më 10 shkurt 2007, me këtë rast dorëheqje patën dhënë ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisari i Policisë së UNMIK-ut. Paramendoni para çfarë absurdi gjendemi, çfarë niveli i lartë ka dhënë dorëheqje, kurse njeriun që prej paslufte e deri sot vazhdon të jetë komandant i Policisë, ne hezitojmë edhe themi që nuk kemi të drejtë ta rekomandojmë, na është thënë edhe nga Kuvendi që ne s'kemi të drejtë ta rekomandojmë. Është përgjegjësi jo veç e atij, por edhe e imja, në këtë rast, edhe unë do ta shqyrtoj seriozisht pozitën time në të cilën gjendem nëse nuk merren me seriozitet këto rekomandime edhe nuk i shikojmë ne si përgjegjës seriozisht detyrat të cilat jemi duke i bërë në shtetin tonë.

Ky person, kam gjetur sipas disa njerëzve që i kam konsultuar, se udhëhiqet me parimin, që në frëngjisht thonë: le seper dhe nga frëngjishtja thonë, le të shkojnë gjërat ashtu si e kanë rrjedhën e vet.

Ky udhëheqës në krye të institucionit shumë të rëndësishëm të sigurisë nuk garanton leadership të prirë nga modeli demokratik i zbatuesit të ligjit. Si autoritet i parë i SHPK-së edhe tani në postin e drejtorit të përgjithshëm ka bërë shumë lëshime. Unë nuk dua të lëshohem në lëshime të tij, sepse tani janë publike. Unë dua dhe propozoj në emër të komisionit, që kemi qenë unik të gjithë, që Kryetari i Kuvendit të urdhërojë administratën t'i sjellë para jush rekomandimet e komisionit, sepse kemi të drejtë edhe për këtë mund të ballafaqohemi në çdo moment edhe të votohen nga ky Kuvend ...

KRYETARI: Regjia, ju lutem kursejeni kohën! Ne kësaj radhe po e vazhdojmë, po më s'e vazhdoj për asnjë diskutues. Regjia, vazhdojani kohën.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, Kryetar! Unë i kam 10 minuta, më duket se kanë shkuar veç 5. Mirë, më falni! Unë po dua ta kërkoj një punë tjetër tash.

Vendimi i NATO-s për zvogëlimin e forcave në Kosovë është i dëshirueshëm. Ne e dimë dhe besojmë që ata kanë kapacitete analitike për të na besuar se ne, këtu që jemi si Qeveri e Kosovës, ka kapacitete për t'i zëvendësuar ato forca, për dy vjet thuhet se do të jenë 2500 forca. Unë uroj edhe rekomandoj, rekomandim personal, jo i Komisionit, Kryeministrin, që t'i thërras të gjitha kapacitetet, qofshin edhe akademike që kanë të bëjnë me sigurinë, edhe nga ne që jemi në siguri të Kosovës, dhe të krijojmë platformë se si t'i zëvendësojmë ata njerëz. Pra, t'i marrin disa vendime, ta luftojmë krimin e organizuar ashtu qysh duhet, ta luftojmë krimin e organizuar. Unë, besoj sikur se ata që e kanë marrë vendimin e NATO-s, besoj plotësisht në kapacitetet tona nëse dimë ta organizojmë se ne do t'ia dalim dhe do ta organizojmë atë mekanizëm deri më 2010. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e shefave të grupeve parlamentare. Po, para se t'ua jap fjalën shefave të grupeve parlamentar, ju njoftoj se në rend të ditës është Informata për incidentin në Dhomën e Provave të Policisë së Kosovës. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra të nderuar,

Të nderuar deputetë,

Pas pavarësisë së vendit tonë dhe deri më sot, falë institucioneve stabile, efektive dhe efikase, të përgjegjshme të shtetit tonë të ri, kontributit maksimal të qytetarëve të vendit dhe miqve tanë, u arrit të dëshmohet botërisht vetë aftësia politike dhe institucionale e kosovarëve për të vetëqeverisur, garantuar stabilitet politik dhe mbrojtur sigurinë e jetës së qytetarëve të vendit pa dallim etnie.

Kosova si shtet i pavarur, sovran dhe multietnik me institucionet e veta demokratike, dëshmoi përgjegjësinë dhe seriozitetin adekuat në situatat më të rënda nëpër të cilat kaluam në periudhën e pas pavarësisë së vendit deri më sot. Mekanizmat e sigurisë në Kosovë të para pavarësisë së vendit si: Shërbimi Policor i Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, me seriozitet dhe përgjegjshmëri institucionale arritën, jo vetëm të

ballafaqohen me situatat e kohës, por edhe të transformohen në mekanizma efikas institucional të sigurisë si një shtet sovran.

Në këtë kohë është ndërtuar baza institucionale dhe ka filluar me sukses të plotë ndërtimi i Agjencionit Informativ të Kosovës si dhe është aktivizuar Këshilli i Sigurisë Kombëtare të Kosovës.

Për të gjitha këto suksese, krahas suksesit të ne vendorëve, nuk mund të mbetet pa u përmendur edhe kontributi i bashkësisë ndërkombëtare për çka ne u jemi mirënjohës.

Rasti i vjedhjes në Policinë e Kosovës dhe plaçkitja në mes të ditës e Pro Credit Bankës në Prishtinë janë akte qyqare dhe kriminale që duhet inkurajuar organet investiguese të vendit që t'i sjellin para bankës së drejtësisë autorët e krimit. Policia e Kosovës duhet me profesionalizëm dhe pa hezitim të shkojë deri në fund të zbardhjes së këtyre rasteve. Çdo tentativë për paragjykim dhe presion mbi organet e hetuesisë është tentativë për të shantazhuar dhe për t'i ikur të vërtetës.

Policia e Kosovës dhe institucionet e vendit nuk duhet të lejojnë të dërgohen sinjalet e dobësimit të shtetit të kriminelët dhe nxitësit e tyre.

Të nderuar kolegë,

Akuzat të pabazë dhe të nxitura politikisht me motive elektorale të bëra nga segmente të caktuara zyrtarëve të AAK-së që për më tepër se 3 vjet kanë udhëhequr këtë Ministri janë një indikacion negativ dhe shqetësim për qytetarët e vendit, kur kihet parasysh se për raste të tilla kanë qenë të informuar me kohë. Aq më tepër kur ende është e pa qartë në procesin investigues se si ka ndodhur kjo vjedhje, a ishte një akt apo ishte një vjedhje e gjatë në proces, në distancë kohore e prova të ndryshme të policisë dhe akti i fundit i vjedhjes, inskenim mbulese me gjoja vjedhin e një sasi droge siç është i njoftuar opinioni publik?

Të nderuar deputetë,

Është e çuditshme se pas kësaj vjedhje të rëndë nga Ministria e Punëve të Brendshme janë larguar 2 zyrtarë të lartë të kësaj Ministrie. Zyrtari i Inspektoratit të Policisë që do të duhej të ishte përgjegjës për investigimin e sjelljes profesionale të policisë me këtë rast, si dhe zyrtari i emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Të dy apo grupi, tanimë të strehuar në një parti politike akuzuese -zhurmuese për këtë vjedhje. Siç do të jetë, duke

Siç do të jetë, duke mos prejudikuar rastin, ne edhe këtë herë si grup parlamentar inkurajojmë organet e hetuesisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë për investigim të plotë dhe profesional deri në fund, jo vetëm të këtij rasti, por të gjitha krimet e pazbardhura që kanë ndodhur në Kosovës e pasluftës.

Të nderuar deputetë,

Nuk është e drejtë të gjykohet parciaisht një segment as individ nga një dështim apo një sukses, asgjësimi i grupeve kriminale të organizuara në vend, konfiskimi i helmeve të fëmijët tanë si droga dhe lëndë të tjera narkotike, zvogëlimi drastik i prostitucionit në vend dhe niveli i ulët i korrupsionit, janë vetëm disa nga sukseset e dallueshme të policisë sonë dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe vetë shtetit të Kosovës.

Me këtë rast dua të përgëzoj ministrin e Punëve të Brendshme përmes tij edhe gjithë Policinë e Kosovës për suksesin e arritur në arrestimin e mbeturinave të shërbimit sekret të Serbisë në Kosovë që tentonin, me para dhe shantazhe, të njollosin luftën tonë çlirimtare.

Të nderuar deputetë,

Aspekti i sigurisë, sundimi i ligjit dhe zhvillimi i vendit si shtet demokratik me perspektivë euroatlantike janë të lidhura ngushtë mes veti. Nxitja e investimeve të huaja dhe depërtimi i kapitalit të huaj kanë si parakusht sigurinë dhe stabilitetin politik dhe ekonomik të vendit. Andaj, klasa politike dhe institucionet kanë përgjegjësi të japin kontributin maksimal në shërbim të këtij qëllimi.

Pozita dhe opozita- shtet ndërtimin e Kosovës nuk duhet ta politizojnë kundër njëritjetrit, por të gjithë t'i kontribuojnë forcimit të shtetit tonë dhe zhvillimit të demokracisë.

Edhe një herë, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, u japim përkrahje të plotë institucioneve të sigurisë së vendit dhe angazhohemi në thellimin e reformave, jo vetëm në Policinë e Kosovës, por edhe në segmentet e gjëra të sigurisë që ndërlidhen edhe me përmirësimin e situatës në gjyqësorin e vendit dhe përmirësimin e tërësishëm të hallkave të sigurisë dhe stabilitetit të vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka kërkuar anëtari i Kryesisë, zoti Eqrem Kryeziu.

Regjia, fjalën deputetit Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju lutem, më lejoni që të përshëndes Kryeministrin, zëvendëskryeministrat, anëtarët e Kabinetit, natyrisht edhe gjithë kolegët, zonjat dhe zotërinjtë që janë anëtarë të këtij Kuvendi të nderuar.

Unë po flas në cilësinë e anëtarit të Komisionit Parlamentar për Siguri e Mbrojtje, sepse është e vërtetë që jam, e dëshmoj këtë punë, dhe po përpiqem, pak a shumë t'i shpjegoj motivet e reagimit të këtillë të komisionit parlamentar.

Besoj që reagimi ka qenë i nivelit të duhur në raport me përmasat që ka pasur ky akt. Nuk po hy në adresat personale të komisionit në personalizimin, por reagimi duhet kuptuar si shqetësim tepër i ligjshëm. Në fund të fundit, në këtë reagim shoh pozitive thjesht si një kundërvënie e parimit të shokut Lenin:” Haj, tha, sa të mund këto hapësira një kohë të gjatë dhe...”, si rekomandimi i tij, atëherë shumë i urtë, dukej tha:” Për ta luftuar burokracinë, edhe revolucionarët duhet të bëhen nga pak burokratë”. Ne nuk u pajtuam që për ta luftuar antikrimin, ndoshta, duhet ta lejojmë edhe krimin aty brenda. Pra, këtu është krejt esenca. Unë besoj që askush s’duhet të pajtohet me këtë parim, kështu që mbi këto gjëra unë e shoh motivimin e reagimit.

Por, nga ana tjetër, në qoftë se ky akt na përshpejton vetëdijen e një niveli të duhur në raport me situatën ku është Kosova, se secili prej nesh do të duhej të ishte i vetëdijshëm për rëndësinë e reagimit në raste të tilla për hir të Kosovës, atëherë do të ishte, ndoshta, një fatbardhësi në këtë fatkeqësi. Meqë është zoti ministër këtu, që nuk ka të bëjë kjo vetëm me te, por me të gjithë ne, dëmet që mund të pësojë Kosova nga aktet e tilla janë shumë të mëdha. Ne e dimë që kushti po thuaj kryesor i vëzhgimeve të shoqërisë

kosovare, të shtetit të ri të Kosovës, është lufta kundër krimit të organizuar. Mua nuk më intereson kush është drejtor dhe a do të jetë a nuk do të jetë. Mua personalisht, le të më fal kryetari i komisionit. Mua më intereson vetëdija e zyrtarëve të lartë politikë, qoftë në polici, që do të duhej të ishin edhe politik, se këto edhe çdo kund, edhe në Parlament, edhe në Qeveri, se këto akte definitivisht e dëmtojnë rrugën e Kosovës për integrim. Do të thotë, në qoftë se del nga kjo një farë lloj vetëdije e tillë, atëherë këtë e quaj unë fatlumësi në fatkeqësi.

Po ju siguroj se nuk besoj se ndonjë anëtar i Komisionit është gëzuar nga ky akt se i erdhi rasti për të sulmuar këtë. Në qoftë se ka të tillë, unë do të distancohesha nga një gëzim i tillë, por merreni si një shqetësim.

Më lejoni të them diçka krejt intime, që s'e kam shtruar asnjëherë këtë pyetje as në Komision dhe kryetari mund të më kritikojë se po i bëjmë publike gjërat që është dashur për t'i thënë aty. Sipas parallogaritjes së konvertimit të lirave turke në vlerën e sotme në euro, unë kuptova se ato dëshmi janë që nga viti 2004 aty. Pyetja që mua më rëndon është se si është e mundur prej vitit 2004 të pushojnë provat pa marrë asnjë procedurë? Kush është përgjegjës? Më duket sikur është shtyrë deri në momentin kur do të dalë dikush që do duhej t'i tërhiqte krejt prej aty. Për 5 vjet të pushojnë provat e të mos ketë procedurë, më lejoni ta them publikisht, kjo enigmë për mua është, po thuaj tash për tash nuk kam kurrfarë shpjegimi. Pra, në këtë kuptim, ju lutem, ta kuptoni shqetësimin e komisionit dhe nuk do të dëshiroja këtu që të penalizohet reagimi i komisionit, se nuk është në rregull as andej, as këndej. Natyrisht, rekomandimet janë rekomandime dhe si ato përkthehen për të mbrojtur dinjitetin e rrugës së Kosovës drejt integritimit, kjo nuk është punë vetëm e një komisioni por, ju lutem, kuptojeni se reagimet e tilla e shpejtojnë Kosovën në rrugën e saj për integrim, nuk është çështja personalisht te unë ose te dikush tjetër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeziu!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, unë kam disa të paraqitur, por fjalën e ka kryetari i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti Kryeministër,

Zonja dhe zotërinj, deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Mendoj se nganjëherë është për keqardhje kur ka disponim të Kuvendit të Kosovës për të punuar me konstruktivitet për një temë e cila është tepër e rëndësishme për vendin dhe atëherë dikush të tërheq prej konstruktivitetit dhe të kthen në temë, të cilat, realisht, nuk do t'i kontribuojnë aspak debatit të cilin ne po tentojmë ta zhvillojmë sot me qëllimin më të mirë, për të mirën e vendit, për të ardhmen e vendit, për një siguri më të madhe për qytetarët e Kosovës.

Ne kemi ardhur me këtë vullnet, do të provojmë që të vazhdojmë me këtë vullnet, edhe pse po shihet që ka tendencë të tërheqjes së vëmendjes diku tjetër.

Tani, një pyetje e parë është kështu. Kush e kontrollon policinë në një vend demokratik, po e përsëris, në një vend demokratik? Është kontrolli civil, thuhet, mbi policinë. Kontrolli civil ushtrohet kur populli na zgjedh neve, ju, neve, deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe ne deputetët e zgjedhim ministrin edhe ministri e ka autoritetin tonë, do të thotë, drejtpërdrejt të popullit, për të ushtruar kontroll civil mbi uniformat, mbi forcat e armatosura. Tani, ne e dimë që një ministër nuk shkarkohet pse dikush e ka vjedhur

dhomën e provave, ama një ministër duhet të thirret në përgjegjësi nëse nuk merr masa në emër tonin, në emër të popullit, për ato që kanë ndodhur, domethënë për vjedhjen e dhomës së provave.

Sot ne kemi dëgjuar në detaje edhe kemi dëgjuar një fjalë tepër interesante, ministri thotë: “Nëse japim detaje, mund ta komprometojmë rastin”. Është plotësisht e vërtetë, pajtohem, por ne sot këtu nuk kemi ardhur të kërkojmë shenja të gishtërinjve prej ministrit, as emra të njerëzve, as prova materiale të gëzhgojave ose çka do qoftë tjetër. Ne kemi ardhur këtu, e kemi thirrur ministrin për ta dëgjuar cilat janë masat, të paktën prej asaj dite, të cilat i ka ndërmarrë ministri, fjalë për fjalë, pastër. Sa njerëz janë thirrur në përgjegjësi, cilët janë ata? Sa janë shkarkuar, të shkarkuarit po i dimë? Çka ka ndodhur me dhomën e provave, a është vendosur ndonjë alarm, a mos ka ndryshuar dhoma e provave? Cilat janë çështjet e tjera të ndërmarra nëpër dhoma të provave nëpër stacione tjera të policisë? Cilat janë mësimet që i ka nxjerr Ministria e Punëve të Brendshme që 2 muaj? Do të thotë, cilat janë veprimet konkrete të Ministrisë, në dy muajt e fundit? Kjo është ajo që ka qenë dashur të dëgjojmë sot, të paktën, dhe atëherë ne si deputetë e kemi për obligim që të diskutojmë se ku na sjell kjo gjendje, cilat janë pasojat, s’kemi kemi si të mos diskutojmë? Fillimisht ka qenë dashur të thuhet edhe si ka mundur të ndodh, cila derë ka qenë e keqe, cilët roja nuk kanë qenë në vend,? Pra, kjo është ajo që deputetët kërkojnë të dëgjojnë.

Tjetra është kjo. Çka shkakton gjendja? Fillimisht e shkakton mosbesimin tonë dhe mosbesimin e qytetarëve në forcat e rendit dhe në polici. Mos harroni se në 10 vjet e fundit, kthehemi në 8 vjetët e fundit, më saktë, atëherë Shërbimi Policor i Kosovës dhe tani Policia e Kosovës ka qenë institucioni më i besuar prej institucioneve vendore, institucion me të cilin jemi mburrur secili prej nesh. Është rrënuar seriozisht ky besim, jo vetëm vendor, por është rrënuar seriozisht edhe besimi i partnerëve tanë të cilët kanë investuar bashkë me ne në ndërtimin e këtij shërbimi.

Tjetra që ka ndodhur është se qarqet kriminale, qarqet e krimit të organizuar e kanë kuptuar se mund të bëjnë çka të donë. Kjo është pasojë, po ju them, qarqet e organizuara kriminale sot shumë saktë mund të besojnë që asgjë në Kosovë nuk është e pamundshme, aq më tepër se mungon një vullnet politik, të paktën aty e tutje, që të rritet përgjegjësia e njerëzve që të paktën dikush të mendohet dy herë ose tri herë se çka mund të ndodhë nëse diçka e ngjashme ndodh në të ardhmen? Veprimet të cilat i ndërmerr Ministria nuk janë vetëm për të kaluarën dhe ndëshkuese, por janë edhe preventive. Cilat janë veprimet preventive? A ndjehet dikush aq përgjegjës sa thotë se nëse një gjë e tillë ndodh në të ardhmen, këto janë pasojat me të cilat përballlet një individ, i cili, në fund të fundit, është në shërbim të popullit.

Një çështje tjetër që dua ta përmend është edhe çështja e drejtësisë, të cilin e përmendi ministri. Ministri e akuzoi drejtësinë se është e ngadalshme, se i lëshon njerëzit. Ministri këtu nuk është ai që duhet të ankohet se sistemi i drejtësisë është i ngadalshëm ose se gjyqtarët nuk punojnë si duhet. Ministrja e Drejtësisë duhet të vijë këtu edhe të na thotë neve- Kam propozuar që të ndryshohet ligji ose Kodi penal për shkak se këto janë pasojat e kësaj që cilat i ka Kosova për shkak të këtij kodi, shembull ta marrim. Nëse do të kishim dëgjuar diçka kësi soji, kish për të qenë gati perfekt.

Çështje tjetër që dua të përmend është se çka ka sjellë deri këtu? Nuk ka ndodhur për një ditë që dikush ta marrë guximin të futet e të vjedh në polici, sepse duhet goxha guxim,

duhet goxha përgatitje, duhet goxha informacion, nuk është diçka e lehtë, për këtë arsye shumica e njerëzve po e quajnë krim i organizuar.

A ju kujtohet juve çështja e vajit disulfurik që ka hyrë në Kosovë, kurrkush kurrë nuk ka marrë përgjigje, kush e ka porositur atë vaj, për çka ju ka dashur ai vaj, kush e ka paguar atë vaj dhe ku ka shkuar ai vaj? Pra, një temë tepër e madhe që i ka mbuluar të gjitha mediat e Kosovës është heshtur, asnjë përgjigje prej policisë, asnjë raport prej policisë, asnjë gjë, dhe tani na thonë neve se drejtësia i ka fajet. Po, mos harroni se kur janë arrestuar mjekët, s'ka pasur nevojë hiq për drejtësi, ama janë kualifikuar menjëherë, kanë dalë në kamera menjëherë. Kur janë arrestuar me gabim agjentët e BND-së, ka dalë menjëherë në shtyp, kanë dalë menjëherë në kamera, u bë menjëherë temë e madhe. Kur janë arrestuar agjentët të BIA-s, mirë që janë arrestuar, një komentim për policinë, menjëherë janë kualifikuar, ama dy tema kanë mbetur pa u kualifikuar ose tri. Pse kanë mbetur ato tema pa u kualifikuar, dyshimi është ekzakt se kanë pasur të bëjnë me krimin e organizuar edhe kjo ne si deputetë na brengos edhe më tepër se çka ka ndodhur, nëpër cilat shkalla ka hyrë dikush në dhomën e provave?

Do t'i nxjerr disa konstatime tona shumë shkurt, me qenë se edhe kolegët e mi do të flasin. Ne mund të konstatojmë me keqardhje se nuk shohim vullnet serioz politik për t'u marrë me këto çështje. Ne shohim mosinteresim të strukturave policore ose mosinteresim të nevojshëm, nivel të nevojshëm për të shkuar më tutje në zbardhje. Ne shohim elemente të rrënimit të qëllimshëm të sistemit të sigurisë në Kosovës dhe ne kërkojmë shpjegime se si mund të na thotë dikush ne që Kosova është vendi më i sigurt në Kosovë, diçka që po përsëritet.

Të nderuar kolegë deputetë,
Unë kaq pata. Faleminderit që më dëgjuat!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Zoti kryesues,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë,

Besoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm për temën që po e trajtojmë, për rëndësinë që ka ajo, jo vetëm për institucionin për të cilën po flasim, por për të gjithë qytetarët e vendit, për shkak të ndjeshmërisë që ka kjo çështje.

Informata e Ministrit të rendit edhe pse sipërfaqësore për shkak, siç tha, të ndjeshmërisë së kësaj çështje, megjithatë le për të kuptuar për seriozitetin e saj si dhe të nevojës për shqyrtim më specifik.

Të nderuar kolegë,
Më lejoni të them se nga të gjitha institucionet e deritashme të vendit, Policia e Kosovës është paraqitur si një ndër storiet më të suksesshme në gjithë jetën tonë institucionale. Megjithëkëtë, të gjithë ne e kemi të qartë se Policinë e Kosovës, që nga fillimi i ndërtimit të saj e deri më sot, e kanë përcjell ngritjet dhe rëniet, dukuri që ngjanë pothuaj se gjithkund ku institucionet janë në ndërtim e sipër. Sikurse që ka

pasur ngjarje të cilat kanë rritur imazhin e këtij institucioni, pa ashtu kanë ndodhur edhe raste të cilat kanë ndikuar në uljen e imazhit të tij brenda dhe jashtë vendit.

Ngjarja më e fundit, ku në Dhomën e Dëshmime, në objektin e Policisë është kryer vjedhje e rëndë, është një ngjarje e rëndë dhe një goditje më tepër për imazhin e Policisë së Kosovës. Kjo ngjarje dhe ngjarjet e tjera na bëjnë të mendojmë se cili është niveli i profesionalizimit të Policisë së Kosovës dhe sa kanë bërë institucionet e Republikës së Kosovës për ta përkrahur këtë institucion në ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizimin e saj?

Duhet të potencohet, që vjedhja në Dhomën e Dëshmime është rast shumë i rëndë dhe i cili besoj se duhet të shfrytëzohet, në radhë të parë, për të bërë analiza të thella lidhur me gjendjen në Policinë e Kosovës, si në kuadro, po ashtu edhe në edukimin, trajnimin e tyre profesional dhe të kapaciteteve teknologjike me qëllim që të jenë më efikas.

E dimë që Policia e Kosovës e ka trashëguar një sistem nga UNMIK-u dhe ky sistem duhet të përshtatet dhe të dakordohet me ligjet e aplikueshme, duke përfshirë këtu, në mënyrë të veçantë, Ligjin për Policinë e Kosovës. Sfidë tjetër është edhe spastrimi i radhëve të Policisë së Kosovës dhe eliminimi i individëve me të kaluar të dyshimtë, si dhe të personave të tjerë brenda saj që janë të involvuar në aferat e ndryshme. Ky rast duhet të shfrytëzohet në radhë të parë për:

- Zbatimin sa më të shpejtë në tërësi të Ligjit për Policinë e Kosovës,
- Përfundimin e procesit të reformave në të gjitha nivelet e Policisë,
- Ngritjen e profesionalizimit të Policisë së Kosovës përmes edukimeve dhe trajnimeve të specializuara në bazë të standardeve ndërkombëtare.

Rasti i vjedhjes në polici nuk duhet të shfrytëzohet për ta dëmtuar Policinë e Kosovës, këtë institucion të ndërtuar me vështirësi dhe të procesit të rikonstruktimit dhe profesionalizimit të tij, por duhet të shfrytëzohet për të bërë një analizë të qartë dhe gjithëpërfshirëse për ndërtimin e kapaciteteve profesionale dhe të afta për të qenë në zbatim të ligjit dhe të rendit.

Të nderuar kolegë,

Mijëra pjesëtarë të Policisë së Kosovës, të cilët me përkushtimin më të madh, të pamotivuar financiarisht e moralisht e meritojnë, së paku përkrahjen e këtij institucioni më të lartë të vendit. Rastet e tilla nuk duhet shërbyer për të njollosur mijëra uniforma të policisë së vendit për të qenë në mbrojtje të rendit e të jetës. Nëse nuk kemi arritur t'i motivojmë financiarisht, të nderuar kolegë, atëherë së paku meritojnë mbështetjen morale.

Pjesëtarët e Policisë së Kosovës i nënshtrohen rrezikut permanent nga individë dhe grupe të caktuara dhe sidomos pas arrestimit, shumica nga ata lirohen, të cilët pastaj mund të jenë dhe do të jenë gjithnjë rrezik potencial për ta. Ju, po ashtu, e dini se sa është penguar Policia e Kosovës në kryerjen e detyrave të saja nga ndërhyrja e politikës. Besoj të gjithë jemi të vetëdijshëm për këtë.

Për fund, kolegë të nderuar, kërkojmë me ngulm hetimin e këtij rasti deri në fund dhe vënien para drejtësisë të aktorëve, por, po ashtu, duke marrë parasysh natyrën e rastit dhe hetimet në këto raste, mund të jenë më të gjata. Mendoj se duhet lënë hapësirë

policisë që të zhvillojë hetime pa presion dhe në mënyrë profesionale. Dhe, nuk mendoj se ky rast duhet të shërbejë për ta partizuar e politizuar këtë institucion shumë të rëndësishëm për të ardhmen e vendit.

Besoj shumë se Policia e Kosovës ka aftësi dhe kurajë për t'u përballuar me krimet e natyrave të ndryshme, pra edhe me këtë rast, që i ka dhënë hije të keqe. Në Policinë e Kosovës ka kuadro të afta dhe profesionale, prandaj përgjegjësia duhet ndarë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, e ka fjalën shefi i Grupit, deputeti Lulzim Zeneli

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zotëri ministër i Punëve të Brendshme,

Sot po e diskutojmë një temë, e cila nuk do të duhej të ishte temë diskutimi, të paktën, në këtë nivel dhe në këtë formë, në asnjë shtet normal. Po e jap këtë vlerësim për vetë faktin se jemi të bindur se ajo çka ka ndodhur në Dhomën e Dëshmive, në stacionin policor, ditë më parë dhe zhvillimet të cilat e kanë përcjellë këtë ngjarje, është më shumë se sa një skandal e aq më shumë se sa një hajni apo një vepër penale e zakonshme.

Me gjithë respektin, zotëri Ministër, shprehim keqardhje që ne duhet të debatojmë në këtë nivel, sepse ju nuk jeni as kreator i kësaj situatë dhe as nuk mund ta zgjidhni këtë situatë. Me vetë faktin që ju, zotëri Ministër, pas dy muajve pranoni të diskutoni për këtë temë në Kuvendin e Kosovës, ky së pari është ofendim për Kuvendin, por edhe për publikun që po na përcjell. Nuk e di se çka mund të konsiderohet më relevante dhe me interes shtetëror se sa Dhoma e ruajtjes së provave dhe dëshmive që lidhen me luftën kundër krimit dhe kriminalitetit.

Të nderuar deputetë,

Mos koordinimi dhe kompleksiteti i raporteve të krijuara edhe nganjëherë ky raport i çoroditur ndërmjet Policisë, Qeverisë, Kuvendit, Komisionit Parlamentar për Siguri, përmban thelbin e problemit. Kuvendi i Kosovës si organi më i lartë nga pozicioni faktor, me këtë rast u shndërrua në spektator dhe fatkeqësisht në Kuvendin e Kosovës, debati dhe fjala publike për Qeverinë e Kosovës nuk qojnë peshë.

Kjo situatë e krijuar po e kompromiton debatin dhe çështjet e ngritura ende pa u debatuar. Pjesëmarrja e partive opozitare në këtë skenar të partive në pushtet po e legjitimon devalvimin dhe komprometimin e institucionit më të lartë të Kuvendit të Kosovës, prandaj, të nderuar deputetë, rishqyrtimi i pozicionit të partive opozitare sot është më i domosdoshëm se kurrë. Kur jemi të informata e ministrit, pyetja shtrohet- çka e informoi sot ministri Kuvendin e Republikës së Kosovës?

Zotëri ministër, ju këtë Kuvend dhe qytetarët e Kosovës duhet t'i njoftoni se vjedhja e dëshmive në stacionin policor të Kosovës a ka implikime politike? Kjo duhet të sqarohet. Nuk e di se për çfarë sigurie të përgjithshme mund të bëhet fjalë kur vidhen dhe zhduken gjurmët e dëshmive dhe provave materiale në Polici, aq u tha nga parafolësit, në një institucion që është mandatuar për ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë. A ka njeri që mund të na mbush mendjen se në këtë Dhomë, në të cilën ka ndodhur ky aksion

spektakular, ka qenë aq lehët e kalueshme dhe e depërtueshme, sikur të ishte ndonjë mini-market apo dyqan ushqimor në një skaj të Kosovës, ku s' ka roje, s' ka qarkullim, s' ka kamera dhe atje ku mund të jetë gjithçka e pritshme? A ka logjikë njerëzore që mund sot t'i arsyetojë argumentet e krerëve të institucioneve të Kosovës dhe të Policisë për mos përgjegjësi dhe distancim nga çdolloj përgjegjësie politike dhe morale?

Të nderuar kolegë,

Në atë vend ku plaçkitet policia e gjithçka zhduket pa gjurmë, e them me shumë keqardhje dhe me bindje të plotë se demokracia po rrezikohet dhe është paralizuar shteti funksional. Po i themi këto, jo për qëllime politike dhe elektorale, por për të shprehur një qëndrim, për një të vërtetë që tashmë është e dukshme dhe nuk ka fuqi që mund ta mbulojë dhe ta arsyetojë se kjo e vërtetë dhe se kjo Qeveri e ka degraduar aq shumë sistemin institucional të vendit sa që po rrezikohet lira dhe siguria e qytetarëve.

Në fund, zotëri Ministër, vjedhjet dhe plaçkitjet ndodhin në çdo vend demokratik, por këto ndodhin nga aktorët e brendshëm dhe aktorët e jashtëm e që është përgjegjësi e juaj ta ndriçoni, deri sa ta kemi një mos përgjegjësi në këtë rast, atëherë fjalën e keni ju. Përgjegjësia tek menaxhimi i situatës sa je transparent, cilët janë hapat dhe çka është në fund rezultati? Dhe në të gjitha këto elemente, Qeveria e Republikës së Kosovës ka dështuar. Debat sot ka filluar për këtë çështje, por gabojnë ata të cilët mendojnë se ky debat rreth kësaj çështjeje do të mbyllet. Ky debat do të jetë prezent derisa të mos ndriçohet rasti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit "7+" fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit, deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedavajući!

Dozvolite da pozdravim zamenike premijerea, ministre, kolege, goste,

Opšta ekonomska kriza koja je zahtavila čitav svet, time i najjače ekonomske zemlje u svetu, a i naše okruženje, pa i našu mladu državu, i ko se iole bavi ovim problemima zna da je došlo do porasta svih vrsta kriminala. Tu ću pomeniti trgovinu ljudima, trafikingu, dakle, i drogom kao pravu industriju biznisa koja se razvila u svetu. Naravno, da naše društvo nije ostalo imuno od ovih pojava. Pogledajmo okruženje, svakodnevnice su zaplene raznih roba, ljudi, nosilaca ovih negatavnih pojava i tako dalje.

Slučaj koji se desio kod nas je izazvao, razumljivo je, veliko interesovanje javnosti. Ovo nam je svima otvorilo oči. Sigurno da ćemo ubuduće biti još budniji u svim sverama gde mogu ovi incidenti da se dogode. Naravno da je došlo i do nas da reagujemo u ovoj analizi kako reagujemo, nadam se da ćemo zadržati strpljenje, dostojanstvo koje je potrebno ovoj instituciji.

Mišljenja sam da trebamo da smirimo strasti, da nadželni počev od ministarstva, na stručan, i ja bih rekao profesionalan način, nastavim istragu. možda uz uključanje i ispomoc i međunarodne misije prisutne na Kosovu. Podržavamo mere koje je preduzelo Ministarstvo i Kosovska policijska služba, podržavamo aktivnosti, uz neophodnost sigurnog proširenja istrage. Nadamo se da će počinioци da se privedu pravdi, a ovo da nam istovremeno bude velika opomena i podsticaj predostrožnosti i mera koje neće dozvoliti slične pojave, incidente u buduću i tako dalje. Kao što neko od kolega reče, dalja stručna i veća osposobljenost naših kadrova ove oblasti neophodna je. Na kraju, ja bih rekao da Švajcarska važi kao zemlja u kojoj se kriminal najefikasnije otkriva i suzbija. Zašto je to tako? Zato što su svi stanovnici Švajcarske pripadnici

policije svoje države. I naše društvo, i naši građani trebali bi da budu, pošto traže uvek od nas transparentnost, da budu transparentni, da budu od pomoći svima, sve sumnjive pojave da prijave, mislim da ćemo lakše doći do otkrivanja nosilaca ove pojave.

Dakle, mi podržavamo sve dosadašnje radnje, kao i današnje izlaganje resornog ministra. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, fjalën e ka kërkuar Slllobodan Petroviq.

SOBODAN PETROVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Uvaženi zamenici premijera, ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Ono što mislim da je kosovska javnost očekivala ranije ovu sednicu, svakako ne znači da treba pozdraviti gest ministarstva i ministra za jednu ovakvu informaciju, koja nije uopšteno shodno da se vodi postupak za ovaj problem, mislim da je to bilo u granicama mogućnosti. Svakako želim da u načelu kažem da kada je u pitanju Kosovska policija, odnosno Kosovska Policijska služba, mogu da kažem da imam jednu pozitivnu ocenu, svakako da je to kao i svuda, da i u Kosovskoj policiji ima pojedinaca koji kvare tu jednu sliku. Ono što mislim da jeste problem, pre svega jeste u komunikaciji sa nivoa ministarstva, odnosno ministra na niže opštinske policijske službe.

Ono što želim sasvim jasno da kažem kada je u pitanju ministar, odnosno Ministarstvo, mi kao pripadnici Srpske zajednice imali smo priliku više puta da se na neposredan način uverimo u spremnost i volju i ministra i njegovih saradnika na rešavanje slučaja. Ja im se u to ime zahvaljujem, čak šta više nekada su bili previše fleksibilni i ako smo ih mi i ohrabrivali u nekim situacijama da budu pre svega dosta parecizniji kada je u pitanju, pre svega, u prvom redu mislim povratak policajaca u KPS iz redova Srpske zajednice, svakako da je to nešto bilo što i sada jeste kao problem bezbednosti, da je upravo zbog toga i stopa kriminaliteta povećan kada su u pitanju područja tamo gde žive u većini pripadnika Srpske zajednice. I ja se iskreno nadam da ćemo taj problem rešiti veoma brzo shodno da je već ministar i Ministarstvo uzelo učešće u tome.

Ono što želim, gospodine ministre, da vam kažem, jeste pre svega to da konkretno za ovaj slučaj ja nisam ekspert policije, ali svakako pre svega kao građanin očekujem da ćete vi shodno vašim mogućnostima uticati da se ovaj problem što pre reši, odnosno da se pre svega javnost blagovremeno upozna sa tim činjenicama. Svakako da to ima deo i moja odgovornost, sakog od nas ovde u Parlamentu, jer svako od nas treba da da svoj doprinos. Ja vam se ovim putem, kako ja, tako i Poslanička grupa Samostalne Liberalne stranke nudi na raspolaganju za bilo šta ukoliko može doći do rešavanja ove situacije.

Što se tiče samo konkretnog slučaja, da ne bih dužio puno, pošto je pre svega ovo informacija, a ne izveštaj za koji se glasa, svakako želim da ohrabrim istražne organe da istraju u naporima kako bi doveli do kraja ovaj istražni proces u interesu istine i u interesu svih građana. Ja se još jednom zahvaljujem i hvala na pažnji.

KRYESUESI: Ju falemidnerit, zoti deputet!

Vazhdojmë me diskutuesit sipas rdhës. Fjalën e ka anëtar i Kryesisë, deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti ministër,

Kabinet qeveritar,

Fjalën time e kam konceptuar që mos të jetë hedhje akuzash në institucionin e Policisë, por të hapet debati në pyetjet të cilave duhet t'u përgjigjeni, zoti ministër edhe në të ardhmen.

Më lejoni, zoti ministër, t'ju falënderoj për gatishmërinë tuaj që një afat më të shkurtër të mundshëm kohor, iu keni përgjigjur ftesës së Kryesisë së Kuvendit dhe keni dërguar informatën dhe keni ardhur për t'u përgjigjur para deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Zoti Ministër, kur kthehemi te informata, të cilën ju na e keni prezantuar, më lejoni që ajo informatë i tërheq disa pyetje dhe dilema. E para është, zoti ministër, a ka ndodhur vërtet më 24 me 25 prill ngjarja, unë them marrja e materialeve të dëshmisë, se ato janë marrë nga institucionet, nga njerëzit. Nuk ka mund të ndodhë kjo pa përkrahje të plotë të fuqishme nga vetë brenda institucionit. Pastaj, regjistri i gjësendeve që janë marrë, zoti ministër, më lejoni që t'i ngre dyshimet e mia se nuk është i plotë regjistri. Pra, unë pyes, zoti ministër, ku është ari që është konfiskuar në linjën e autobusit Pejë – Stamboll vitin e kaluar? Janë mbi 100 kilogram ari. Ku është ari i konfiskuar i argjendarive të Pejës në mandatin e kaluar të Qeverisë nga inspektorët financiarë? Ka të bëjë me qindra kilogram ari. Nuk e kam parë në shpenzimet buxhetore as në të hyrat, as në të dalat e vitit të kaluar dhe nuk kemi informacione se ku janë ato? Dhe, normalisht, a ka edhe diçka tjetër përpos këtyre gjërave që ju i paraqitni në këtë informatë?

Zoti ministër, më lejoni që t'ju jap mbështetje të plotë angazhimeve tuaja në vënien e rendit në Policinë e Kosovës. Unë nuk dua të hy këtu t'i përsëris të gjitha ato që kanë ndodhur në Policinë e Kosovës në vitet e fundit. Kjo është ajo kulmi dhe ngjarja më e dëmshme që e dëmton jo vetëm imazhin e policisë, por është dëmtuar imazhi i Kosovës, për shkak se nuk është e aftë për ta siguruar veten, më së pari, e lëre më të tjerët.

Zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Fjalën time do ta përqendroj edhe në një çështje të “harruar” për Kuvendin e Kosovës dhe për institucionet e Kosovës. Kjo ngjarje që ka ndodhur, ky incident, kjo vjedhje, si po e quani ju, nuk është plaçkitje e zakonshme, sikur të plaçkitet një bankë ose një market, ose një dyqan. Është dashur përgatitje e gjerë, është dashur mbulim i informacionit gjatë përgatitjes, pra, për t'u kryer një akt i tillë. Mungesa e një shërbimi inteligjent të Kosovës, është evidente, zoti ministër, të nderuar deputetë, është evidente që Qeveria e Kosovës nuk e zbaton ligjin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës të miratuar më 15 qershor të vitit të kaluar.

Ligji për Agjencionin Kosovar të Inteligjencës, neni 2, citoj, pika 7, pra: “lufton praktikumin e substancave ilegale, armëve apo qenieve njerëzore.” Pika 5,” krimin e organizuar kundër Kosovës apo në dëm të sigurisë të Kosovës, në cilën do mënyrë, duke përfshirë edhe larjen e parave”, çka do të thotë që ky mekanizëm i mungon Kosovës, që kishte për të qenë i pazëvendësueshëm në parandalimin e ndodhjeve të rasteve të tilla qysh ka ndodhur në Policinë e Kosovës.

Më lejoni ta citoj nenin 6 të këtij ligji, paragrafin 6.3 :” Presidenti i Republikës së Kosovës, së bashku me Kryeministrin i emërojnë zëvendës drejtorin e AKI-së brenda 20 ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lirë”.

Neni 9 , paragrafi 1 : ” Presidenti i Republikës së Kosovës, së bashku me Kryeministrin, emëron inspektorin e përgjithshëm të AKI-së, brenda 20 ditësh pune, nga dita kur pozita mbetet e lirë”.

Të nderuar deputetë,
Qeveri e nderuar, ministra,
Vendet e lira kanë mbetur më 15 qershor, kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Kosovës dhe ky ligj. Pse pengohet dhe mbahet peng një mekanizëm aq i nevojshëm për Kosovën?

Neni 12, pika 2: “Shpalljet e vendeve të punës në AKI i nënshtrohen konkurrencës së hapur dhe publikohen në shumë gazeta ditore që shpërndahen në Kosovë.”

Të nderuar deputetë,
A keni hasur në ndonjë konkurs për t’u punësuar njerëzit në AKI në bazë të këtij ligji?

Kushtetuta e Kosovës, neni 129, paragrafi 3: ”Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri, pas konsultimit me Qeverinë, së bashku emërojnë drejtorin, zëvendës drejtorin dhe inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë”. Pse nuk zbatohet Kushtetuta e Kosovës dhe pse këta njerëz nuk e zbatojnë ligjin?

Të nderuar deputetë, në seancën e kaluar të Kuvendit të Kosovës, Grupi Parlamentar i PDK-së e tërhoqi nga rendi i ditës miratimin e Rregullores së Punës së re të Kuvendit, e cila i hapte rrugë formimit të Komisionit Parlamentar për Kontrollin e Agjencionit Kosovar të Inteligjencës. Puna e parë e atij Komisioni kishte për të qenë monitorimi i Ligjit të miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin e kaluar për Agjencionin Kosovar të Inteligjencës dhe ishte dashur që ai Komision t’i sjellë Kuvendit rekomandime për njerëzit të cilët e pengojnë, ose nuk e implementojnë këtë ligj.

I nderuari zoti ministër,
Në task- forcën e juaj që është ngritur, nuk keni përmendur se kush merr pjesë. I pazëvendësueshëm kishte për të qenë edhe roli i Agjencionit Kosovar të Inteligjencës, po ta kishim, po ta kishte Kosova në këtë task- forcë, jo vetëm që roli i pazëvendësueshëm i atij Agjencioni në hetimin dhe parandalimin që mos të ndodhë kjo, që ne nuk e kemi pasur këtë, por edhe në hetimet pasi që eventualisht një krim i rëndë i tillë ndodh.

Këtu u folën fjalë të rënda për drejtorin e Policisë. Unë nuk dua ta mbroj askënd, por ky Kuvend duhet të kërkojë përgjegjësinë politike ndaj atij që e ka emëruar atë drejtor në qoftë se vërtet ka pasur vërejtje aq të rënda për të dhe në qoftë se ai ka bërë shkelje aq të rënda. Pra, ky Kuvend duhet më së pari ta shkarkojë atë që e ka emëruar atë drejtor. Ai drejtor i policisë, zoti ministër, është emëruar në këtë Qeveri. Nuk dua ta akuzoj askënd, janë pyetje këto, zoti ministër.

Të nderuar deputetë,
A po implementohet ligji në Kosovë, Kushtetuta dhe pse nuk implementohen? Pse po mbahet peng një Agjencion i Kosovës aq i nevojshëm për ta plotësuar infrastrukturën e

sigurisë në Kosovë? Mos janë këto pengesa dhe pse kjo po ndodhë? Këto janë pyetje, nuk janë akuza, zotëri deputetë.

Më lejoni, të nderuar deputetë dhe ministra, t'ju përkujtoj se në nëntë vjetët e kaluara, në dhjetë vjetët e kaluara derisa ne nuk e kishim një agjencion të tillë, çdo krim që ndodhte, çdo vrasje e pazbardhur që ndodhte ose enigmatike, arsyetoheshim të gjithë që Kosova nuk e ka një mekanizëm, i cili do ta bënte parandalimin e krimeve të tilla ose hetimin pasi që ato të ndodhin. Pse tash ne si Kosovë dhe si Qeveri e Kosovës nuk...?

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Vazhdojmë me radhën e deputetëve. Jemi marrë vesh që të mos ketë zgjatje të fjalës. Fjalën e ka kërkuar zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hajredin Kuçi.

ZËVENDESKRYEMINISTRI, HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit!

I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që në emër të Qeverisë t'i shpreh disa qëndrime lidhur me debatin e sotëm dhe mendoj, që në fillim të them, se Qeveria e Kosovës ka mirëpritur diskutimin dhe debatin që po bëhet sot. Dhe, dua të them, diskutimi dhe debati që po bëhen, unë pres, aq sa po e vërej edhe Qeveria e Kosovës, janë në një vijë të ngjashme edhe me atë që ka të bëjë Qeveria e Kosovës dhe me atë që ka të bëjë opozita në Kuvendin e Kosovës, por edhe me atë që ka të bëjë Komisioni për Siguri dhe Rend.

Besojmë që qëllimi i të gjithë neve, pa dilema është se, jo vetëm si të zbulohet ky rast konkret, por mbi të gjitha është, si të motivohet ky vend, të jepet vullneti politik për të pasur rend dhe ligj në tërë territorin e Republikës.

Unë e di që ky debat dhe shumë debate të tjera politike në Kosovë mund të vijnë si rezultat i mos sundimit të plotë të rendit dhe të ligjit në vendin tonë. Sa më pak që ka rend dhe ligj, do të kemi debate politike aq më shumë. Dhe, unë jam ihtar i asaj që të kemi mundësi që problemet legale të zgjidhen përmes rrugëve juridike, ndërsa problemet politike përmes rrugëve të tyre. Por, ajo çka dua të them mbi të gjitha, në vendin tonë çdo problem mund të zgjidhet përmes rrugëve juridike. Në këtë rast, dikush ka mundur t'i vërejë se mund të jenë tri qëndrime apo tri pozicione të ndryshme, atë që e tha Qeveria, dikush mendon edhe për opozitën, por edhe për komisionin parlamentar. Unë besoj që të tre ose tri grupacionet, po e quaj kështu, nëse më lejohet, e kemi një qëllim. Qëllimi kryesor, besoj, i këtij debati duhet të shfrytëzohet edhe për në të ardhmen, jo vetëm në rastin konkret, por edhe në rastet e tjera është si të tregojmë vullnetin politik për të sunduar rendi dhe ligji në Kosovë, si ta bëjmë infrastrukturën legale me ligjin, legjislacion dhe kështu me radhë dhe si t'i ofrojmë logjistikën adekuate?

Nuk besoj, asnjëri prej nesh këtu në këtë Kuvend, nuk besoj që as publikisht e as jo publikisht nuk i mbështet këto tri qëllime, që të tregojmë edhe një herë vullnet politik, infrastrukturë legale dhe logjistikë për rendin dhe ligjin në vendin tonë.

I dëgjuam mendimet e Komisionit, po e them, Qeveria i ka marr me seriozitet. Qeveria nuk e mbron asnjë individ veç e veç, Qeveria mbron ligjin, mbron të drejtat. Kushdo që është në anën e ligjit, do ta ketë mbështetjen e Qeverisë, kushdo që është në anën tjetër

të ligjit, nuk do ta ketë mbështetjen e Qeverisë, pa marrë parasysh në cilindo pozicion që gjendet ai.

Po ashtu, dua të them se edhe mendimet e opozitës që u shprehën sot, mendoj se kanë të njëjtin qëllim. Siguria në një vend nuk ofrohet për një kategori të njerëzve apo për një kategori më pak e për tjetrën më shumë, ofrohet për të gjithë qytetarët ose jo dhe, unë jam i bindur se të gjithë e kemi një qëllim të kemi siguri më të madhe për të gjithë qytetarët e Republikës sonë.

Ne i kemi ndërmarrë disa masa, që tha edhe ministri i Punëve të Brendshme, por unë do t'i përmend disa prej tyre. Është përmendur në opinion, përveç që është themeluar task - forca, ka pasur diskutime të tjera. Kryeministri dhe unë bashkërisht kemi kërkuar nga zoti Kermabon, nga EULEX-i që të marrë masa në zbulimin e këtij rasti. Një çështje që është shumë me rëndësi, që po e them, pak sa po e zbuloj, shumë më të ashpër kemi qenë ne me përgjegjësit e kësaj dukurie, me përgjegjësit që duhet ta zbulojnë këtë rast se sa që është sot Kuvendi i Republikës së Kosovës. Dhe, unë besoj që këtë masë po e quaj në kuptimin pozitiv, këtë presion që e bën Kuvendi i Republikës së Kosovës është presion mbi Qeverinë, në kuptimin pozitiv, që të bëjmë presion pozitiv që të zbulohet rasti. Sa më pak që të zbulohet rasti, aq më shumë ka dilema dhe, shumë hapur jemi të bindur, zbulimi i çdo rasti në Kosovë, atribuohet për të mirën e qytetarëve, por në kuptimin politik atribuohet për Qeverinë më shumë se sa për të gjithë të tjerët. Pra, edhe si qeveri, edhe si individë, edhe si qytetarë jemi të interesuar që të bëhet një gjë e tillë.

Ne e dimë që ka përgjegjësi në këtë rast, ka përgjegjësi edhe objektive, edhe subjektive. Ne e dimë që ky rast ka ndodhur mu në një vend ku ka përgjegjësi dhe këtë përgjegjësi e kam thënë publikisht, po e përsëris prapë, të gjithë ata që do të vërtetohen që kanë përgjegjësi objektive ose subjektive, do të përgjigjen. Nuk ka përfunduar storja. Askush nuk ka fituar imunitet mbi rastin. Në momentin që për rastin do të jepen hetimet e para nga organet e hetuesisë, ne nuk kemi ndërhyrë e as nuk ndërhyjmë në organet e hetuesisë, por momenti kur japim ose marrim informacionet adekuate, po e them që përgjegjësisë nuk do t'i ikë asnjë individ nga cilido nivel dhe në cilindo pozitë që mund ta ketë. Natyrisht, ne jemi shumë të interesuar që të ruhet imazhi i Policisë së Kosovës dhe besoj se në këtë drejtim Policia duhet të punojë më shumë për ta ruajtur imazhin e vet se sa të gjithë ne të tjerët. Por, natyrisht, edhe ne si vend demokratik, që e thanë edhe të tjerët që e bëjnë kontrollin civil, ne do të jemi shumë të kujdesshëm që ky imazh, për hir të disa individëve të mos dëmtohet në asnjë rast.

U përmendën shumë raste që mund të jenë efektive ose jo. Në këtë vend sistemi i rendit dhe i drejtësisë mund të jetë efikas nëse i kemi tri shtyllat kryesore të këtij funksionimit të vendit. E para shtyllë është, që unë e quaj institucionale, ku hyn edhe Kuvendi, pozitë dhe opozitë, shtylla që hyn edhe Qeveria, shtylla që hyjnë edhe institucionet e tjera. Nëse këtu kemi dhe unë besoj që kemi një vullnet të madh politik, jo vetëm deklarativ, por edhe konkret dhe nëse ne këtu bashkëpunojmë shumë ngushtë me qytetarët e Republikës, si shtylla e dytë, besoj të cilët duhet të jenë shumë më bashkëpunues, në këtë drejtim do t'i propozojmë masat më konkrete, qoftë Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, që jemi duke përgatitur, qoftë shpërblimet adekuate që mund të jenë për persona që ofrojnë informata të duhura apo edhe siguri për pjesëtarët e policisë që ata e rrezikojnë jetën në detyra, por edhe kanë humbur jetën, duhet të ketë siguri edhe në kuptimin fizik, por edhe më pastaj në rastet e ndonjë aksidenti apo të humbjes së jetës, të ketë edhe siguri materiale për familjet e tyre.

Një segment i tillë i veçantë është sistemi i shtyllës së drejtësisë. Në këtë drejtim, Qeveria e di që ka shumë gjyqtarë dhe prokurorë efikas, por e dimë të gjithë ne që ka mundësi të jetë pak më shumë efikas, pak më shumë efektiv dhe në këtë drejtim Qeveria është një balancues, por nuk është ndikuese. Unë jam shumë i bindur se ky Kuvend mund të ketë ndikim më shumë në sistemin e drejtësisë se sa Qeveria. Dhe, ju e dini, po ashtu edhe Presidenti i Republikës dhe unë jam i bindur që edhe bashkësia ndërkombëtare, që është e pranishme në Kosovë, ne kemi nevojë për reforma që kemi bërë dhe duhet t'i bëjmë në cilindo sistem por, në veçanti, në sistemin e drejtësisë dhe të policisë. Nëse sistemi i drejtësisë dështon, vullnetet politike, deklarative, unë them që janë të kota. Tek e fundit, edhe veprimet institucionale që i bëjmë secili prej nesh, duhet të kalojnë përmes rrugës së sistemit të gjyqësisë, i cili duhet ta ketë pavarësinë, por të mos t'i ikë llogaridhënies.

Ajo që e kisha lutur secilin prej nesh, është në kohën e përgjegjësisë. Unë e di që Qeveria identifikohet, bile kur është me të mirat, ne edhe kërkojmë të identifikohet. Por, edhe e di se kur ka dobësi identifikohet, por në Kosovë ka një sistem të ndarë të pushteteve, sistemi ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, sidomos gjyqësorin duhet ta pranojmë shumë afër që është shumë më larg, por besoj që duhet të punojmë shumë t'i bindim. Ata mund të jenë të pavarur si sistem, por nuk janë pa llogaridhënie dhe unë nuk e di ku japin ata llogari momentalisht. Ne e kemi tani riemërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe unë i kisha ftuar deputetët, Presidentin e Republikës, po edhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, të marrin masa adekuate për një sistem adekuat.

Unë do ta përfundoj fjalën time duke thënë edhe një herë, Qeveria e Republikës së Kosovës i jep mbështetje të plotë zbulimit të secilit rast që ka të bëjë me shkeljen e rendit dhe të ligjit. Qeveria e Republikës së Kosovës është e gatshme të gjitha rekomandimet që i bën ky Kuvend t'i kryej me përgjegjësi të lartë, por Qeveria e Republikës së Kosovës kërkon nga të gjithë prej nesh të tregojmë, jo vetëm vullnetin politik, por edhe masat konkrete. Unë jam i bindur që ky rast do të zbulohet dhe unë besoj që duhet të ndërmerren të gjitha aktivitetet që të zbulohet dhe unë jam i bindur që në Kuvendin e Republikës së Kosovës do të ketë debate politike, por çështjet legale do t'i zgjidhim në rrugë legale, edhe pse Kuvendi vetëm i ndihmon, por kurrësi nuk i pengon. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Kalojmë në diskutuesit e radhës. Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit, ka replikë, 2 minuta.

RRUSTEM MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë mirëpres deklaratën e zëvendëskryeministrit për mirëpritjen e rekomandimeve, me sqarimin edhe të anëtarit të komisionit që vjen nga Lidhja Demokratike e Kosovës, që plotësisht pajtohem me fjalët që i shtroi. Unë e bëra një propozim më parë, që rekomandimet që i kemi shtruar, të vijjnë, të urdhërohet sekretariati dhe t'i sjellë rekomandimet para deputetëve, në mënyrë që ato rekomandime të votohen. Unë pres pas kësaj kohe që ju ta urdhëroni administratën dhe t'i sjellin rekomandimet që ta dinë deputetët për çka kanë rekomanduar. Këtë e kam bërë në emër të komisionit. Në komision janë 11 deputetë, e mirëpresim edhe deklaratën e Qeverisë dhe ju, Kryesia e Kuvendit, nuk keni pse të thoni jo. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Por, për ne sot është, domethënë rendi i ditës i caktuar kohë më parë. Është shumë i qartë i caktuar që është diskutim lidhur me informatën e ministrit dhe nuk ka votim

sipas këtij rendi të ditës, sidoqoftë ju mund të insistoni në mbledhjet e radhës të Kryesisë që t’i riaktualizoni edhe njëherë rekomandimet e komisionit.

Vazhdojmë me diskutuesit, veç dua t’ju përkujtoj se diskutuesit kanë nga 5 minuta, luten që ta respektojnë se nuk ka zgjatje të kohës së diskutimit. Diskutuesi i parë është deputeti Emrush Xhemajli, le të përkatet deputeti Shkumbin Demaliaj.

EMRUSH XHEMAJLI: Përshëndetje, zoti kryesues!

Përshëndetje zoti zëvendësministër,

Ministra,

Më lejoni që ta përshëndes në veçanti ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti, për gatishmërinë që në respekt të ligjit vjen këtu të japë informatën konform ligjit.

Rastet e grabitjeve brenda policisë nuk janë tipar vetëm i Kosovës dhe nuk domethënë se ka ndodhur ose mund të ndodhin edhe tjera herë, por siç i menaxhojnë vendet e tjera, do të ishte mirë që konform praktikave më të mira të bëhej edhe të reagohej edhe për këtë rast, njësoj. Tash, përkundër hetimeve që janë bërë, ne urojmë më së pari që rasti të zbardhet edhe përgjegjësit të dalin para drejtësisë. Ky është qëllimi edhe i krejt kësaj çka po bëjnë të gjitha institucionet, edhe Kuvendi.

Nga ana tjetër, ne si deputetë kemi përgjegjësi të veçantë që të shohim se brendapërbrenda sa janë zbatuar ligjet të cilat merren me këtë problematikë. Është fjala për Ligjin e policisë, rekomandimet e ndryshme që i kanë bërë auditorët e brendshëm brenda policisë, pra edhe auditorët e jashtëm, siç është Inspektorati i policisë, e kështu me radhë. Tash, sipas këtyre auditimeve të brendshme të vetë policisë del se nuk është në rregull menaxhimi në kuadër të këtij sektori, në kuadër të Drejtoratit për Krimet e Organizuara, bëhet fjalë edhe për këtë dhomën e provave. Unë po flas për auditimet e brendshme, urdhëroni këqyrni auditimet e policisë flasin kështu, të vetë policisë që i kanë ngarkuar për këtë punë.

E dyta, shteti ynë e ka një institucion që quhet Inspektorat i Policisë, ai me shumë donacione është ngritur, është formuar dhe funksionon. Ky inspektorat i policisë duhet të respektohet nga institucioni i Policisë së Kosovës. Pra, ky inspektorat ka bërë një raport edhe pikërisht përputhet me këtë rastin, është raport i zakonshëm i inspektoratit. Unë nuk po flas për personat e veçantë në kuadër të inspektoratit, unë po flas si institucion. Ky institucion e ka bërë një raport – Hetimi i krimit të organizuar. Pra, ka raportuar krejt qysh është gjendja në Policinë e Kosovës, posaçërisht rreth krimit të organizuar dhe ka ardhur në përfundim se pikërisht për dhomën për të cilën po flasim duhet ndryshuar gjendja. Urdhëroni, shihni rekomandimin që është numër 6 i këtij inspektorati, ku thuhet se gjendja është e keqe në dhomën e provave edhe duhet të ndryshohet.

Bëhet fjalë për katër muaj ditë, Policia e Kosovës, gjithmonë nuk po më intereson kush e ka hartuar këtë as nuk e di, por si institucion e ka hartuar, 4 muaj ditë Policia e Kosovës ka pasur kohë të ndërmarrë masa të ndryshme lidhur me këtë edhe për shkak të këtij auditimi edhe për shkak të auditimit të brendshëm të vetin. Nuk e ka ndërmarrë asnjë masë të nevojshme, kështu që, për këtë, sipas Ligjit të policisë, nëse dëshirojmë mund t’ia përmendim edhe emrin nenit 37 të Ligjit të policisë, thotë se drejtori i policisë është përgjegjës për këtë punë për të marrë masa edhe masa nuk ka marrë. Pra, mua nuk po më interesojnë këto imtësitë policore, as hetimet policore, mua si deputet

dhe si ligjdhënës më intereson prurja e ligjeve të mira, zbatimi i ligjeve të mira. Këto për mua janë ligjet me të cilat dua të funksionojë Policia e Kosovës. Këto ligje nuk respektohen, përgjegjësi është konkret, kush s' është duke e respektuar këtë ligj edhe është shumë me vend që Komisioni për Punë të Brendshme ka rekomanduar Qeverinë, përkatësisht Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Kryeministrinë, nuk ka kërkuar ta heqë Sheremet Ahmetin komisioni, sepse nuk e heq komisioni edhe krejt interpretimet janë bërë në mënyrë të panevojshme, të gabuara, është kërkuar rekomandim prej njerëzve përgjegjës...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Vazhdojmë me diskutuesin e radhës, deputetin Shkumbin Demaliaj, le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zot kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Fillimisht, mendoj se ky informacion i sotshëm nuk përmbush vakuumin shumë mujor që kanë pasur institucionet, por edhe vetë legjislativi i vendit për një informatë, sepse pikërisht ky informacion dhe ardhja deri te kjo informatë në Kuvend nga ministri i Punëve të Brendshme, vjen si rrjedhojë e punës së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, që Kryesisë së Kuvendit i ka dërguar rekomandimet, që ato rekomandime sot nuk i kanë asnjë nga deputetët e Kuvendit, por as raportin e inspektoratit dhe as raportin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, që ka ardhur në Komisionin për Siguri. Është një informatë e bazuar në numra dhe në shifra që e ka ofruar ministri i Rendit, që e falënderojmë që e ka sjellë këtë informatë sot në Kuvend, por ne nuk do të mund të debatojmë për thelbin e çështjes, që për Policinë e Kosovës dhe Ministrinë përkatëse është në hetim.

Unë kisha pasur dëshirë të ndërlidhem me vetë rastin, sepse ne po i shmangemi. Qeveria thotë se ne jemi për sundimin e rendit dhe të ligjit, ndërkaq i gjithë ky proces po shkon larg asaj që dikush është i përgjegjshëm për këtë çështje. Askush nga Qeveria e Kosovës nuk thotë se duhet të largohet nga detyra e drejtorit të përgjithshëm zoti Sheremet Ahmeti. Unë, duke e njohur për së afërmi, për aq sa kam mund ta vërej përgjegjësinë morale të vetë ministrit të Punëve të Brendshme, e di se deri tash ai do të kishte dhënë dorëheqje nga 20 herë, për vetë përgjegjësinë çka ka ndodhur në Policinë e Kosovës. Por, duke qenë peng i Qeverisë për shkak të nepotizmit që qëndron brenda këtyre strukturave, është peng i mos dorëheqjes të ministrit, në këtë rast, për shkak se Sheremet Ahmeti është familjar i vet Kryeministrit. Nuk është Sheremet Ahmeti ai që ka bërë një shkallë të madhe për këtë vend, as diçka që deri tash si drejtor i policisë ka treguar një afinitet se ai me të vërtetë meriton të jetë aty. Ka policë, ka struktura policore vetë Policia e Kosovës që mund t'i kryejnë këto punë. Po flas me përgjegjësinë më të madhe për çka jemi mbledhur lidhur me informatën.

Ministri e tha, shkallëve emergjente është kryer krimi. Dera nuk është thyer me ujë, në qoftë se ka qenë një derë e hekurit, me ujë nuk është thyer që të mos dëgjohet zhurma. Ka shumë personalitete brenda strukturave shtetërore të Kosovës që janë përgjegjës edhe për mbrojtjen e institucioneve shtetërore dhe të institucioneve të rëndësishme. Askush nuk e ka përmendur asnjëherë emrin e Kamer Januzaj a Januz Kemberi, a kush është ai përgjegjës lidhur me këtë çështje. Ne gjatë kësaj periudhe kemi pasur raste kur institucionet janë kërcënuar me bomba. Është kërcënuar Ministria e Arsimit edhe vetë Qeveria e Kosovës, ndërtesa e Qeverisë edhe nuk kemi asnjë rast apo shpjegim. Kapen njerëzit në rrugë, janë njerëz që kanë pasur substanca narkotike, secili që kapet thuhet

është kah hetohet edhe a ka qasje kjo në vjedhjen në dhomën e dëshmive të policisë. Lidhur me këtë çështje ju bëj me dije se nuk ka hetime, se ajo ka ndodhur nga brenda, sepse aty kanë qenë vendosur edhe kamerat, por edhe për çështjen që nuk janë marrë udhëzimet e nevojshme që ka dhënë Inspektorati i Policisë me kohë, askush nuk ka ndërmarrë as vetë përgjegjësi që është drejtori i përgjithshëm i policisë, i cili edhe ka ofenduar komisionin, e ka ofenduar Parlamentin, sepse nuk ka lejuar kontroll parlamentar mbi te. Nuk ka ardhur asnjëherë në komision dhe del e thotë, unë as që do të merrem me këtë punë, unë jam duke i ndjekur procedurat. Është staf ekzekutiv, ne nuk jemi kah flasim për përgjegjësinë politike që kemi, por për përgjegjësinë ligjore dhe ekzekutive që ka Qeveria e Kosovës, respektivisht mekanizmat përgjegjës që vazhdojnë këtë trend.

Në raportin e vetë Drejtoratit të Policisë, thotë ne e kemi informuar edhe Agjencionin e Inteligjencës lidhur me rastin. Agjencioni i Inteligjencës ka vetëm një kryeshef dhe asnjë nëpunës tjetër. Në qoftë se ka të jashtëligjshëm të punësuar aty, le të urdhërojnë, por me ligj edhe në bazë të normativës ligjore, që e theksuan parafolësit më herët, asnjë tjetër bartës brenda këtij agjencioni, çka do të thotë ka qenë vetëm një raport kalimthi sa për sy e faqe për ta futur se gjëja ne jemi kah i respektojmë mekanizmat shtetëror dhe nuk ka diçka të ngjashme. Kemi raportime në forma të ndryshme, por këtë rast policia, Ministria e Punëve të Brendshme edhe mekanizmat e tjerë nuk janë duke e trajtuar në vendin e duhur, duke e ruajtur përgjegjësinë individuale të një drejtori të përgjithshëm. Çdonjëri nga qytetarët e Kosovës, apo nga Policia e Kosovës që ka një përgatitje më të lartë mund të jetë drejtor, sepse ai emërohet. Një i emëruar mund edhe të shkarkohet. Ne kemi rekomanduar si komision, jemi fyer ndoshta nga qytetarët prej interpretimeve të ndryshme se ju po doni ta shkarkoni, nuk keni të drejtë. I kemi rekomanduar Qeverisë që të shkarkohet. Rekomandimet as tash s'kanë ardhur në Kuvend, sikur nuk kanë ardhur as rekomandimet që kanë qenë lidhur me veriun dhe me sigurinë e vendit më herët. Vazhdimisht edhe në publik, shumë prej formave që aplikojnë mediumet tona, thonë se Komisioni për Siguri...

KRYETARI: Ju faleminderit, shumë!

Secili grup parlamentar ka një anëtar të Kryesisë dhe një shef të Grupit Parlamentar dhe anëtarët e Kryesisë, pa asnjë kundërshtim, me shefat e grupeve parlamentare janë pajtuar për këtë rend dite dhe mendoj se është e panevojshme të hyjmë në fjalë. Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ne sot jemi duke biseduar për një çështje mjaft të ndjeshme për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe për ne si deputetë. Them se është çështje e ndjeshme, sepse ka ndodhur një vjedhje në Policinë e Kosovës dhe mua më duhet ta citoj Ligjin për policinë e Kosovës, nenin 10, ku thotë se Policia e Kosovës janë që ta mbrojnë jetën, sigurinë dhe pronën e të gjithë qytetarëve. Ju lutem, cilën pronë mund ta mbrojnë Policia e Kosovës, kur nuk mund ta mbrojnë pronën e vet? Do të thotë, është neni 10, pika (a). Mandej, i kemi disa nene tjera që i përkufizojnë punët e Policisë së Kosovës. Është fjala te themelimi i policisë, neni 4 dhe neni 5.

Policia funksionon nën autoritetin e Ministrit të Punëve të Brendshme dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e drejtorit të përgjithshëm të policisë. Do të thotë, policia funksionon nën autoritetin e ministrit të Punëve të Brendshme, është e rregulluar me ligj kjo, na nuk kemi çka të flasim për këtë.

Ne këtu, të nderuar deputetë, në rend dite kemi një informatë, ndërsa në brendi kemi një raport, lexojeni. Ne, faktikisht nuk dimë a të flasim për informatë, apo për raport?

Kryesia e Kuvendit të Kosovës na e ka prurë një informatë, faktikisht, ministri i Punëve të Brendshme ka prurë një raport. Pra, unë tash momentalisht nuk di a po bisedoj për informatë apo për raport, sepse në letra e keni shkruar ashtu.

Nën 4, ne e kemi Ligjin për Inspektoratin e Policisë, që e kemi miratuar së bashku me bashkësinë ndërkombëtare, edhe Kushtetutën e kemi miratuar bashkë me Bashkësinë ndërkombëtare. Dhe, unë do të thirrrem në nenin 17, Fusha e veprimit të Inspektoratit të Policisë. Ministri na thotë se e kanë formuar një task-forcë, ndërsa neni 17 decidivisht thotë: Kryeshefi i Inspektoratit përgatit një numër protokollesh, nën a) menaxhimi i objekteve policore, do të thotë, Inspektorati i Policisë e ka menaxhimin e objekteve policore dhe vjedhja ka ndodhur në objekte policore. Nuk kanë vjedhur ata hajnat në shtëpi të askujt, por në shtëpi të policisë.

Menaxhimi i hetimit dhe i zbulimit të krimit është nën i), neni 17, të Inspektoratit të Policisë dhe është formuar një task - forcë nga ministri, me urdhër të ministrit, sepse ne na ka shpjeguar se me urdhër të ministrit është formuar task-forca dhe tash ne duhet të kërkojmë përgjegjësinë aty ku kemi të drejtë ta kërkojmë. Faktikisht, ne kemi bërë edhe rekomandimet, por përgjegjësinë kemi të drejtë ta kërkojmë tek ata për të cilët kemi ngritur gishtin ne.

I kemi inspektimet e jashtëzakonshme. Është një inspektim të Inspektoratit të Policisë, neni 4, i cili zhvillohet kur ka dyshim mbi baza të arsyeshme që të besohet se veprimi ose sjellja e Policisë së Republikës së Kosovës përfshin shkelje serioze të Doracakut të Policisë, që Kryetari e përmendi edhe Bashkësinë Evropiane në ato nene të cilat unë nuk po mund t'i mbaj në mend tash.

Mua po më vjen keq singërisht prej ministrit, sepse më së paku është fajtor ministri. Mua po më vjen keq edhe prej ministrave të Lidhjes Demokratike të Kosovës, sepse më së paku janë ministra ata. Por, ministri i Punëve të Brendshme, them me singëritet, e ka ministrin në kafe dhe ai ministri në kafe pyetet për këtë ministrin këtu dhe ky është ministër për të dalë para gazetave edhe para mjeteve të informimit. Këtë e dimë, sigurt. Kur kam pas thënë njëherë që ai ministri i Punëve të Brendshme është në kafe për të tjerë, ju ka pas ardhur mërzi, por po ju them edhe tash. Po ju them se ministri i Punëve të Brendshme s'është këtu, është zëdhënësi apo ushtruesi i detyrës, qysh të doni e quani, po më vjen keq. E di vetë Ministria, e di vetë Qeveria çka kanë hequr ata ministra në kafe për t'i hequr prej liste që të mos bëhen ministra...

KRYETARI: I nderuari deputet, përqendrohu në temë.

GANI GECI: Në temë është kjo, po flasim për Ministrinë e Punëve të Brendshme. Dhe, po flasim për vjedhje. E dini ju të gjithë, e di edhe vetë Kryetari çka kanë hequr, por megjithatë, po ju them singërisht juve se nuk ka ndodhur vetëm kjo vjedhje, vjedhjet kanë ndodhur sistematike. Kanë vjedhur përditë nga pak, përditë nga pak letra, përditë nga pak drogë, përditë nga pak para, si i ka tubuar dikush prej policie dhe i ka qar në dhomë të dëshmive, ata i kanë vjedhur. I kanë vjedhur edhe dosjet, faktikisht, dëshmitë për raste të caktuara. Dhe, unë po ju them me plot singëritet, se është vjedhur edhe një dosje, dosja për vrasjen...

KRYETARI: Edhe një minutë, mos e zgjatni shumë dhe prandaj flisni për temën, e kur flisni për temën, e kryeni për 5 minuta.

...e gazetarit të "Bota Sot" dhe për vrasjen e truprojave të Presidentit të Kosovës, Besim Dajaku dhe Bekim Kastratit. Unë s'dua të flas për vetveten, por është vjedhur kjo dosje, sepse policia e EULEX-it kanë shkuar në Skenderaj për ta kërkuar dosjen, dosja nuk është. Ajo është matanë ure, Prokuroria e ka djegur, serbët. Të gjitha dosjet i kanë djegur, kurse këndej urës i kanë vjedhur hajnat. Sinqerisht, mu po më vjen keq, por nuk di kush me kënd është këtu. A janë këta këndej ure me ata matanë ure, apo ata matanë ure me këta këndej ure? Mua po më vjen keq, kërkoj nga ministri që të angazhohet, është një prej ministrave më të zellshëm, por shumë pak ka faj në këtë drejtim. Ju faleminderit!

KRYEARI: Ju faleminderit!

Kisha kërkuar që vërtet të debatojmë lidhur me temën, një, dhe dy, mos ta akuzojmë Policinë e Kosovës, se Policia e Kosovës i ka 7000 e më tepër anëtarë. Fjalën e ka Zylfi Hondozi, le të përgatitet Numan Baliq.

ZYLFIJE HONDOZI: Zoti kryetar,

Zotërinj ministra,

Deputetë të nderuar,

Shumica e qytetarëve të Kosovës ka qenë e shokuar me lajmin që e kanë dëgjuar në media, se nga dhoma e dëshmive në Policinë e Kosovës janë vjedhur 47 kilogramë substanca narkotike. Në kohën kur liderët institucional me plot gojë deklarohen se prioriteti i institucioneve të Kosovës, pas pavarësisë, është integrimi në Bashkimin Evropian, ndodh vjedhja e substancave narkotike nga dhoma e dëshmive, gjë që i tregon Bashkimit Evropian që krimi i organizuar në Kosovë është prezent dhe po zhvillohet me të madhe në institucionet e shtetit të Kosovës.

Në raportin e progresit të vitit të kaluar është dhënë vërejtje sa i përket luftimit të krimit të organizuar, por këto vërejtje nuk u kanë lënë përshtypjeve institucioneve përkatëse dhe udhëheqësve të tyre, kështu që jo vetëm nuk kanë filluar ta luftojnë krimin e organizuar, por sikur e kanë lejuar krimin të ndodhë në zyrat e policisë, kështu që e kanë rënduar imazhin e Kosovës para të gjithëve, sidomos sivjet, kur sukseset e këtyre institucioneve janë më se të nevojshme pasi që pritet të bëhet një raport pozitiv i fizibilitetit dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së stabilizim- asocimit.

Mos luftimi i krimit të organizuar e pamundëson që Kosova të përfshihet në grupin e shteteve që do të jenë të përfshira në liberalizimin e vizave. Liberalizimi i vizave do t'i hapte perspektiva të reja për jetë më të mirë qytetarëve të Kosovës, por me këtë neglizhencë ndaj krimit, Qeveria po ia mbyll vetë rrugën për liberalizimin e vizave, por po duket qartë që as ministri i Punëve të Brendshme, as Kryeministri nuk po mërzhiten fort për vjedhjen e drogës, përndryshe aktorët e kësaj ngjarjeje deri më tani do të ishin aty ku duhet.

Opinionit i servohen të dhënat për burgosjen e disa të dyshuarve të cilët sot veç janë liruar, por jo të kriminelëve të vërtetë dhe kjo të lë të mendosh se organet e sigurisë të Kosovës janë totalisht të papërgatitura, ose qëllimisht nuk dëshirojnë ta zgjidhin rastin, kështu që dyshohet që në të janë të implikuar vetë organet shtetërore për qëllimet e veta.

Nuk është hera e parë që Qeveria po e tërheq vëmendjen me mbulimin e një skandali që asaj i duket më i rëndësishëm me një skandal më pak të rëndësishëm, me të cilin populli merret një kohë të gjatë dhe harron atë që ka qenë para tij dhe, kështu, vëmendja e popullatës mbahet e përqendruar në atë çka donë Qeveria dhe kështu blihet kohë për veprime të tjera, të cilat ndoshta do të merren vesh ndonjëherë tjetër. Të dyja këto japin një porosi shumë të keqe, në rend të parë për qytetarët e Kosovës sa i përket sigurisë së tyre personale, për arsye se secili prej tyre dhe shumë prej nesh e shtrojnë pyetjen, nëse vjedhja ka ndodhur në polici, ku siguria është maksimale, çka do të ndodhë me qytetarët e thjeshtë, kush do t'i mbrojë ata? Dhe, në rend të dytë për bashkësinë ndërkombëtare, për kualitetin e shtetit tonë dhe aftësitë tona ta ndërtojmë një shtet, ku ani pse një pjesë e madhe e qytetarëve janë të papunë dhe jetojnë në varfëri, por bile të jenë të sigurt.

Ky skandal nuk do shumë komente, sepse është i qartë. Nuk është e qartë vetëm se nuk po veprohet. Është pritur mjaft që kjo vjedhje të ndëshkohet dhe pasi që nuk është ndëshkuar, atëherë Kryeministri duhet ta rishikojë pozicionin e përgjegjësve të policisë, gjegjësisht t'i shkarkojë nga pozitat e tyre dhe me këtë të krijojë një imazh pozitiv për Policinë e Kosovës dhe shtetin e Kosovës.

Prandaj, e përgëzoj Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri për iniciimin e këtij debati të sotëm dhe kërkoj nga Kryesia që rekomandimet e Komisionit t'i sjellë në një seancë tjetër për votim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryesia, realisht, e ka sjellë debatin këtu, kurse për rekomandime nuk ishte zhvilluar fare debat.

Fjalën e ka deputeti Numan Baliq, le të përgatitet Naser Rugova

NUMAN BALIĆ: Ju falemidnerit, zoti Kryetar!

Selam svima koji su prisutni i želim da dam nekoliko riječi doprinosa vezano o ovom razgovoru.

Glavna je teškoća u cijeloj ovoj provali i kradji, jer se desila teška provala i kradja u središtu policije, a glavna je teškoća u tome upravo što se još uvijek nisu okrili počinioci. Dakle, ne zna se ko je kriv uprkos hapšenjima i randnjama koje su jesu preduzeta i koja nadamo se će ići u dobrome pravcu, mi još uvijek nemamo uhvaćene počinioce, ne znamo ko su krivci i ne znamo koji je uradio pljačku i kradju koja se desila. To je jedna stvar.

Druga je stvar, neznamo ni ko stoji iza tih ljuidi i šta su njihovi stvarni motivi, dali je u pitanju droga i novac koji su pokrali ili su u pitanju možda i neki drugi ciljevi, a ne treba naravno i isključiti mogućnost politizacije ovih stvari, mogućnost da je u pitanju afera ili slučaj koji je uperen protiv određenih ličnosti, rukovodioca u policiji, ministarstvm, Vladi i tako dalje. Dakle, mogućnosti i pozadine cijelog ovog događaja su veoma raznovrsne s obzirom da nemamo fakte i nemamo krivce. Ali u najmanju ruku ono što je ovaj slučaj otkrio jeste da postoji slabost policijskog sistema, dakle ne svih policajaca i ne Policije ucjelini, nego na onim odredjenim mjestima gde je to utvrdjeno da se desilo. Odjel za podatke, osdnosno odjel za svijedoke, za dokaze, oprostotke, odjel za dokaze, koji treba da bude mozak Policije, jedan od najvažnijih delova je pogodjen pravo u metu i dokazano je da je potpuno nezaštićen.

Kako su se se drznuli pljačkaši da prodru na peti sprat, da provale ta vrata i da ukradu ono što su ukrali, to ostaje da se tek vidi nakon što se slučaj riješi. Ali se slučaj desio i potoji naravno odgovornost ljudi u odjelu, postoji odgovornost ljudi u rokovodećim

službama u Ministarstvu, postoji odgovornost naravno i direktora Policije i odgovornost ministra, i ... se na tome i pojedini ljudi i Vladi, međutim, takodje postoji pitanje na koje trebamo odgovoriti. Ako obavimo zamjenu direktora Policije ili ministra, da li će to riješiti, dali će to riješiti problem. Hoće ukoliko se potvrdi da su oni direktno odgovorni na to, naravno da hoće. Ali ukoliko ne utvrdimo to, onda ostaje sve da se manipulira sa tim stvarima.

Tako da, mislim da u svemu ovome trebamo izvući neke zaključke, a oni su sledeći: da način kako se odigrao slučaj i dalje navodi na to da postoji osnovana sumnja da postoji povezanost između ljudi u odjelu ili možda u ključnim rukovodećim službama u rukovodstvo Policije ili Ministarstvu vezano sa, koji su povezani sa organizovanim kriminalom. Taj problem stalno postoji, problem povezanosti, kao što inače postoji problem povezanosti u vlasti i organizovanog kriminala ili kriminala bilo koje vrste. Tako da, da bi Ministarstvo, Vlada i smi zbog javnosti Kosova, zbog svih nas trebali da preporučimo najmanje dvije konkretne stvari koje bi trebale biti vrlo važne. Prvo, razmotriti cirkularni sistem sigurnosti i reda koji postoji na Kosovu i preduzeti prave mjere.

Uprkos značajnim pomacima koji se se desili, uprkos ukupne stabilizacije prilika u oblastima reda i sigurnosti građana, mi i dalje imamo značajne teškoće u suočavanju i gušenju, sprečavanju kriminala svih vrsta na Kosovu i naravno da trebamo takodje prijedložiti, bilo bi dobro da osim razmatranja, da se nakon tog razmatranja preduzmu konkretne mjere, jasne mjere, transparentne mjere koje će dokazati javnosti, građanima, vladi, parlamentu, svima nama da smo u stanju da ordiniramo određene promjene koje će voditi ka tome da se na Kosovu konačno zavede red i sigurnost kakvu i zaslužuju građani Kosova. To je bila moja diskusija. Hvala vam ljepa!

KRYETARI: Faleminderit edhe për kohën! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet Edita Tahiri.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të çmuar kolegë deputetë,

Ministria e Punëve të Brendshme prej themelimit të saj në vitin 2006, angazhim kryesor ka pasur formimin e një strukture të qëndrueshme dhe efikase për realizimin e të gjitha objektivave të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Deri ku ka mbërri me strukturën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, mund të shihet edhe në Ueb-sajtin e MPB-së, në linkun e organogramit, shkruan, po citoj: “Ministria e Punëve të Brendshme është në proces të rishikimit funksional të strukturës organizative dhe shumë shpejt pritet të miratohet struktura e re në përputhje me kompetencat e transferuara të legjislacionit të ri”.

Zoti ministër, që një vit e gjysmë e keni marrë mandatin, jemi shtet i ri, e kemi legjislacionin adekuat, pse nuk ka një strukturë të qëndrueshme Ministria e Punëve të Brendshme, qoftë në aspektin organizativ dhe atë menaxherial.

Kjo përmbajtje e tekstit është nga shtatori i vitit 2008, e dihet se rishikimin funksional të strukturës së MPB-së janë duke e bërë organizata të ndryshme ndërkombëtare. Deri më sot nuk kanë arritur ta krijojnë një strukturë sepse, si duket, ose mungon vullneti politik, ose diçka e çuditshme është kah ndodhë këtu dhe kisha dashur që të më përgjigjeni në këtë pyetje.

Në kuadër të Ligjit për Policinë, neni 5 thotë: “Policia funksionon nën autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nën mbikëqyrjen e drejtorit të përgjithshëm të policisë”. Në këtë kontekst janë bërë disa lëvizje pa organogram në kuadër të menaxhmentit të lartë dhe të emërimeve të caktuara edhe në administratë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Unë po ju njoftoj që shumë profesionistë të policisë, njerëz me përvojë, me karrierë të shkëlqyeshme dhe që këto dhjetë vitet e fundit Kosova dhe shoqëria kosovare dhe miqtë tanë ndërkombëtarë kanë investuar në ngritjen e tyre profesionale, janë përjashtuar dhe janë lënë plotësisht jashtë loje. Kjo ju dëmton juve, zoti ministër po e dëmton edhe Policinë e Kosovës, që ata 7.500 burra dhe gra, që vërtet janë institucion shumë i besueshëm, mos të demoralizohen, mos të zhgënjehen sepse kjo i kushton sigurisë dhe imazhit të Kosovës, tek e fundit, e jo të individëve. Emërohet drejtor i një drejtorie shumë të ndjeshme, ju e dini për kë e kam fjalën, një major dhe largohet një kolonel në të cilin ka investuar shteti i Kosovës. Ose një kolonel shumë i përgatitur, që i ka kryer të gjitha trajnimet e mundshme edhe në instancën ndërkombëtare – në shenjë pakënaqësie për këtë degradim, jep dorëheqje zoti ministër. Kjo duhet të ju shqetësoj juve, por edhe drejtorin e Policisë.

Sa i takon informatës apo raportit, që ju na e keni sjellë, po citoj: “Dhoma ku janë mbajtur evidencat ka qenë e siguruar me dy dyer, njëra e rëndomtë ndërsa tjetra e hekurt”. Dhe, kryerësit kanë arritur që me forcë, do të thotë, t’i thyejnë këto dy dyer në katin e pestë në ndërtesën më të sigurt të vendit tonë. A vallë, askush nuk ka dëgjuar që po thehen ato dyer, kush ka qenë në sigurim, çfarë masash janë marrë. Ky është një shqetësim shumë serioz jo vetëm për mua, si deputet, por për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe kjo tregon se kryerësit e kësaj vepre kanë qenë në ndërlidhje të plotë me dikë brenda dhe kanë pasur informacione të sakta për kryerjen e këtij akti.

Sa i takon arrestimeve që i keni bërë, zoti ministër, arrestohen njerëz që kanë pas fletë-arrest, njerëz të cilët pas dy dite dolën në konferencë për shtyp dhe avokatët e tyre thanë se s’ka të bëjë asgjë me këtë rast. Fatkeqësisht, është ulur edhe imazhi i policisë, edhe profesionistët e vërtetë, por iu ka rënë autoriteti edhe ju, zoti ministër, sepse nuk kishte diçka konkrete. Bile për opinionin është dashur të jepet diçka më konkrete, edhe pse zëdhënësit e policisë po insistojnë që këto arrestime kishin të bëjnë mu me këtë çështje.

Arrestime të tilla spektakulare keni bërë edhe më herët. Ju rikujtoj, arrestimi i agentëve të BND-së, nuk ndodhi asgjë dhe na komprometuat para një shteti mik që e ka ndihmuar shumë Kosovën dhe me një komb të fuqishëm evropian. Dhe, këto janë përgjegjësi edhe politike, edhe menaxheriale.

Arrestime të tilla spektakulare që të tërhiqet vëmendja e opinionit nga dështimet e Qeverisë në fusha atë caktuara janë bërë edhe me arrestime të mjekëve.

KRYETARI: Në temë, në temë! Ju lutem!

NASER RUGOVA: Po kjo është tema, zoti Kryetar! Do të thotë, pse po ndodh kjo. Këto janë prapë dështime që lidhen me nenin 5 të Ligjit për Policinë e Kosovës, ku ministri e ka përgjegjësinë politike, kurse drejtori i policisë e ka përgjegjësinë menaxheriale...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri, le të përgatitet Adem Salihaj. Më falni, ministri e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Të nderuar deputetë,
Janë të kuptueshme shqetësimet tona të përbashkëta për rastin që ka ndodhur e, po ashtu, pas shumë shpjegimeve këtu dhe pas informatave sado të kufizuara, që sot kam mund t'ua sjell këtu, keni megjithatë informata për angazhimet tona për reagimin tonë në rastin në fjalë dhe në rastet tjera prej se ne qeverisim me këto segmente në Kosovë.

Më lejoni t'ju them se Ministria e Punëve të Brendshme ka futur në prioritet, në agjendë Raportin e progresit të Komisionit Evropian dhe të gjitha ato të gjetura dhe rekomandime që kemi marrë nga Komisioni Evropian. Më lejoni t'ju përkujtoj që Ministria e Punëve të Brendshme në segmentin që e mbulon përfshin numrin më të madh të veprimeve që janë në kuadër të planit të veprimit për partneritet evropian, që është plan i Qeverisë dhe që adresohet vite me radhë, ose që është në agjendën e Qeverisë jo vetëm tash.

Ministria e Punëve të Brendshme jo vetëm me këtë rast, por me të marrë raportin e fundit të progresit ka adresuar dhe ka rishikuar të gjitha veprimet e veta dhe është fokusuar fuqishëm në realizimin e tyre.

Më lejoni t'ju sjell disa statistika për t'ju thënë që luftimi i krimit të organizuar...

(Ndërhyrje)

Më lejoni t'ju përgjigjem disa prej pyetjeve! Më lejoni t'ju them se krahasuar, vetëm statistikën po ju sjell për luftimin e krimit të organizuar. Raste të hapura në vitin 2007 kanë qenë 7, -15 në vitin 2008. Janë statistika të policisë. Raste të përfunduara -6 kanë qenë vitin 2007, -12 në vitin 2008. Të arrestuar të dyshimtë -44 persona në vitin 2007, -51 persona në vitin 2008. Grupe kriminale kemi 11 në vitin 2008, deri sa nuk kemi pasur në vitin 2007 dhe kallëzime penale -14 krahasuar me -6 në vitin paraprak. Policia i ka adresuar këto. Ju mund të bëni pyetje ku janë, cilat janë vendimet e gjykatave, cili është reagimi i drejtësisë e tjerë, por mendoj se nuk është kjo pyetje që duhet të më adresohet mua.

Më lejoni t'i përmend disa çështje që u shtruan këtu. Unë ju kam referuar raportit zyrtar të policisë, i cili raport është ardhur te unë menjëherë pas ngjarjes së inspektimit të parë dhe është verifikuar disa herë dhe interesimi im ka qenë, po ashtu, të shikohet vërtetësia e këtij raporti.

Më lejoni t'ju them, po ashtu, që çështja e inspektimeve, u përmend këtu. Inspektorati policor, jo vetëm inspektimin që kam kërkuar unë, ka dhjetëra inspektime të jashtëzakonshme që i ka kërkuar ministri për çështje nga më të ndryshmet, që ju nuk i keni këtu sot, si informatë, e që janë po aq të ndjeshme për funksionimin e policisë dhe për imazhin e policisë.

Çështja e reagimit të policisë në këto..., nuk mund të jetë çështje e shpejtë për shkak se, e përmenda edhe një herë, është fazë e hershme e tranzicionit dhe për shkak se policia është në fazë të reformave të transformimit.

U shtrua këtu edhe çështja e rishikimit ose pse nuk është bërë një skemë organizative stabile e policisë në përputhje me... Policia është e strukturuar mirë. Struktura organizative tash nuk është konfront me ligjin e ri. Ajo që ne kemi kërkuar është, ka disa ligje të reja të miratuara nga ky Kuvend, e që kërkojnë angazhime shtesë të policisë dhe adaptim të strukturës së policisë në përputhje me ligjin e ri. Policia do të menaxhojë çështjen e eksplozivëve, të kompanive private, çështje të ndryshme të emergjencave, e tjerë. Policia domosdo duhet rishikuar dhe ne jemi në proces të rishikimit. Rishikimi i strukturës organizative të policisë nuk bëhet brenda dite, është një çështje që lidhet edhe me kapacitetet tona që i kemi.

Ajo që mund të ju them tash është se kemi përfunduar skemën organizative ose rishikimin funksional. Ajo është në tavolinën time, kemi aprovuar, edhe Qeveria e ka miratuar rishikimin funksional dhe unë po ju siguroj se nuk do të mund të gjeni një institucion tjetër të adaptuar konform ligjeve të reja dhe nevojave të reja sa Policia e Kosovës. Po ashtu, edhe në Ministrinë e Brendshme kemi ristrukturuar disa departamente në përputhje me nevojat e reja dhe me ligjet e reja që janë adaptuar.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

...edhe për mungesa tjera të mundshme ose u shtrua edhe mundësia e implikimeve politike e tjerë. Unë, ju them, flas me shifra zyrtare dhe flas me informacione zyrtare. Nuk kemi informacione për implikime të ndryshme politike, e tjerë. Ju kisha lutur, kush ka informacione të tilla, le të deponojë te organet e hetuesisë, është më së miri.

Po ashtu, te provat e konfiskuara e tjera, u përmend ari. Tash mora informacionin që pritet vendim i prokurorit çka duhet të bëhet më tej me atë sasi ari që është e konfiskuar dhe që gjendet në dhomën e provave. Po ju them, po ashtu, se duhet të shikohet në të ardhmen dhe bashkë me segmentin e drejtësisë të mbulohet me legjislacion çështja e aseteve të konfiskuara.

Më lejoni t'ju them, u përmend, po ashtu, që do të duhej të informoja pak më shumë se çka ka bërë ministri në këtë rast. Po ju them që një varg masash të ristrukturimit dhe të reformimit në polici po ndodhin dhe do të ndodhin vazhdimisht. Kjo nuk është veç për shkak të këtij rasti, por të nxitura ndoshta me shpejtësinë më të madhe pas ndodhjes së rastit për shkak të nevojave që i ka policia të angazhohet dhe të performohet sa më mirë.

U përmend, po ashtu, edhe vaji sulfurik. Mund t'ju them që ne e kemi çuar para drejtësisë. Më vjen keq që duhet të përmend raste të veçanta këtu. Po ju përgjigjem, meqenëse një deputet e shtroi. E kemi futur brenda njeriun dhe ai që ka e porositur atë materie është liruar nga organet tona të drejtësisë. Mund ta marrim edhe emrin, por nuk u interesova për emrin, pa problem, nuk janë emra anonimë.

Unë dëshiroj t'ju them që nuk më kanë munguar... Një deputet e përmendi, po ashtu, edhe informatën e plotë. Nuk kam hezituar t'i përgjigjem para Kuvendit. Në kohën kur më ka ftuar Komisioni parlamentar për Siguri kam shkuar me informatë të plotë që e kam poseduar, kam treguar gatishmërinë time personale, të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Qeverisë për t'u marrë me rastin dhe, po ashtu, me rastin kur jam ftuar në Parlament, bile kam kërkuar të zhvendoset data për shkak të angazhimeve të mia në datën kur është paraparë ky rast.

E kam për detyrë, po ashtu, të rikujtoj shumë shkurtër dhe më falni për kohën që po ju marr. Sipas analizave të institucioneve të besueshme ndërkombëtare, si NATO, BE, OSBE, NDP e tjerë, Policia e Kosovës mbetet institucioni më i besueshëm në Kosovë. Qytetarët e Kosovës janë më së shumti të kënaqur me punën e Policisë së Kosovës, sipas raportit të fundit të paralajmërimit të hershëm të UNDP-së. Është fjala për raportin tashmë të fundit. Gjithashtu, me punën e vet Policia e Kosovës e tejkalon në disa prej këtyre sondazheve edhe KFOR-in për sa i përket besueshmërisë te qytetarët tanë.

Unë ju përmenda më herët edhe një shifër të numrit të rasteve të lajmërimit të qytetarëve kur është fjala për bashkëpunimin e policisë me komunitet, është në rritje numri i komunikimit të qytetarëve me Policinë e shtetit tonë.

Ju mund ta merrni edhe një çështje që, po ashtu, u përmend në Kuvend. Vendimi i fundit i NATO-s për zvogëlimin e trupave ushtarake, përveç tjerash është thënë si argument, se kemi forcim të institucioneve të sigurisë së vendit dhe është përmendur, po ashtu, edhe Policia e Kosovës.

Në fund të fundit, më lejoni t'ju them që sipas të gjitha këtyre informatave që i marrim edhe nga vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare, tani Kosova nuk ndihet vetëm si konsumues i sigurisë. Kosova tani konsiderohet si kontribuues i sigurisë në rajon dhe kjo është mirë për ne, për vendin tonë, për institucionet e sigurisë dhe për policinë e vendit tonë.

Gjithashtu, me të gjitha vlerësimet imazhi i policisë ka qenë i pamohuar, po ashtu edhe nga vlerësimet e miqve tanë që janë këtu.

Dëshiroj t'ju them edhe një herë që do të jemi të gatshëm, askush nuk dëshiron, nuk ka ndonjë gatishmëri për mbylljen e këtij debati. Ajo që ne po insistojmë tash është që rasti të zbardhet dhe organet e drejtësisë dhe të hetuesisë ta përfundojnë sa më shpejt rastin. Zbardhja e rastit do t'i ndriçojë të gjitha përgjegjësitë, edhe ato penale, edhe menaxheriale.

Më lejoni t'ju them të ju them, po ashtu, edhe rreth...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, kursehuni, nga pesë minuta kohën e keni. Ju lutem, a ta bëjmë një debat, se mendoj që të gjithë jemi të interesuar për t'i bërë institucionet sa më të përgjegjshme. Fjalën e ka kërkuar Edita Tahiri, le të përgatitet Adem Salihaj.

EDITA TAHIRI: Faleminderit!

Zoti Kryetar,

Deputetë e nderuar,

Qeveri e nderuar,

Kjo çështje që po e diskutojmë sot, është një çështje jashtëzakonisht shqetësuese për të gjitha institucionet, por veçmas për qytetarët e Kosovës, sepse fjala është për një ngjarje e cila ka ndodhur në sferën e sigurisë dhe, në anën tjetër, ka treguar një performancë jo të mirë të institucionit përkatës i cili do të duhej, pra, të ishte më i përgatitur për situata të tilla.

Nuk ka dyshim se Qeveria, por edhe Ministria në fjalë punon dhe angazhohet dhe ka dëshirë që të dalë me rezultatet më të mira. Kjo është, secili kur ta marrë përgjegjësinë, e ka edhe atë synim.

Mirëpo, kur ndodhin këto ngjarje, pra kur ndodhin ngjarjet, në fakt, kjo tregon rrënjët e performancës së institucionit në fjalë. Në këtë rast, edhe të Policisë, por edhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Dhe, për mendimin tim, për këto dy muaj sa ka ndodhë kjo ngjarje, nuk është arritur të vihet një funksionalizim në trekëndëshin performancë, përgjegjësi dhe masa të ndërmarra. Rënia e performancës është e madhe sepse ngjarja është skandaloze. Pavarësisht se është e vërtetë që kemi pasur në të kaluarën rritje të performancave të punës edhe të Ministrisë së Brendshme, edhe të sigurisë, edhe të policisë, kjo është rënie dhe kjo duhet të evidentohet si e tillë.

E dyta, pasi që konstatohet rënia e performancës, pason përgjegjësia. Dhe, unë sa po shoh, përgjegjësinë nuk e keni trajtuar ashtu siç duhet. Për mua janë dy nivele të përgjegjësisë. Niveli i parë është përgjegjësi për ngjarjen e ndodhur dhe niveli i dytë i përgjegjësisë është kur ndriçohet rasti dhe kur identifikohen aktorët. Në nivelin e parë nuk janë marrë masat e duhura, sepse nën një – përgjegjës dihet kush është për dështimet e institucionit në rastin e caktuar. Prandaj, u deshtë që ju, si njëshi i kësaj sfere, sigurisht që të veproni në kërkesën tuaj për të marrë përgjegjësi, sepse ju përmendët ristrukturimet që po ndodhin, madje edhe respektimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, që është inkurajues për mendimin tim, por gjatë ristrukturimit, pra, që është një menaxhim strategjik, duhet të përmenden edhe njerëzit, se ristrukturimi nuk bëhet vetëm nëpër organograme, duhet edhe njerëzit, pra, kush janë përgjegjës, në fakt, menjëherë të merren masa ndaj tyre.

Kjo për mua, që Komisioni ynë për Siguri na tregoi sot që njëshi i policisë nuk ka ardhur në Komision, ju lutem, kjo është për mendimin tim një sjellje jo e përgjegjshme dhe aty ju keni mundësi të ndikoni, sepse një shtet demokratik nuk mund të funksionojë pa një rol të mirëfilltë të Parlamentit në punën e sigurisë dhe të ushtrisë, sepse është parim bazë për funksionimin demokratik të një shteti. Prandaj, së paku këto çështje mund të realizohen për të rritur besueshmërinë në institucione, por për të rritur po ashtu besueshmërinë te qytetarët që qasja e institucioneve dhe e atyre që janë përgjegjës, është serioze dhe sa i përket asaj se një ditë mund të dalë kjo përgjegjësi, t'ju them të drejtën, unë jam pesimiste, sepse ka dhjetë vjet që ne kemi institucione, kemi qeveri, por shumë krime, përfshirë edhe gjëra që lidhen me krimin e organizuar nuk janë ndriçuar. Ju vetë e përmendët edhe gjyqësinë, si një prej faktorëve që nuk po jep rezultate në këtë drejtim, prandaj nuk e di kur mund të vjen deri te përgjegjësia dhe si qasje mendoj se nuk i jep mundësi fuqizimit të institucioneve, që është synim i gjithë të gjithë neve, edhe i juve si Qeveri, edhe neve si Parlament, por veçmas i atyre, pra, qytetarëve të cilët duan një shtet ku siguria është në nivelin e duhur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Adem Salihaj e ka fjalën, le të përgatitet Gani Koci.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministër i Punëve të Brendshme, ministër i Bujqësisë,

Unë kisha dilemë, edhe pse e shtypa butonin dhe kërkova fjalën, kisha dilemë se a ka efekt ky debat sot në Kuvendin e Kosovës. Më duket një debat shumë i zbehtë dhe pa asnjë efekt dhe mendoj që Ministria e Punëve të Brendshme dhe Qeveria e Kosovës kanë arritur që ta relativizojnë dhe ta zbehin efektin e një veprimi shumë skandaloz që ka

ndodhur në dhomën ose në objektin që do të duhej të ishte më i ruajturi në Kosovë dhe kjo tregon diçka shumë konkrete.

Përpjekja e ministrit për ta zbehur këtë, për ta zvarritur, për të mos e sjellë në Kuvend, mos sjellja e rekomandimeve të Komisionit janë shenja jo të përpjekjeve të angazhimit dhe të përkushtimit të luftës kundër krimit, por janë e kundërta. Janë përpjekje dhe angazhim që të mos luftohet dhe të mos zbardhet krimi.

U përmend prej shumë kolegëve këtu që dhoma më e ruajtur është plaçkitur, është vjedhur me lehtësi të pa imagjinueshme dhe kjo është një shenjë që mund të ekzistojë dhe ne jemi të bindur dhe dyshojmë seriozisht se ekziston një bashkëpunim i vetë institucioneve brenda policisë me njerëzit që e kanë kryer këtë vjedhje dhe këtë krim. Ka organe në polici që do të duhej të merreshin me hetimin dhe zbulimin e krimit, po nuk ka organe të mirëfillta, siç i kanë shtetet tjera të zhvilluara. Shtetet e Bashkuara e kanë Agjencinë Qendrore të Zbulimit, e ka Anglia Scotland Yardin e tjera, kanë të gjitha shtetet shërbime sekrete. Kosova nuk e ka agjencinë e zbulimit për shkak se kjo Qeveri nuk dëshiron ta formojë atë, sepse nuk dëshiron ta zbulojë dhe ta luftojë krimin. Ka më tepër se një vit që është dashur të jetë kjo agjenci dhe nuk është. Kosova nuk e ka, kurse disa njësite, të themi, inteligjente brenda Policisë së Kosovës janë të vogla, të papërfillshme dhe s'kanë asnjë aftësi serioze që ta zbulojnë krimin. Do të thotë, këtu është një përkushtim, është një koordinim i segmenteve të ndryshme institucionale që të sabotohet lufta kundër krimit dhe të mos zbulohet krimi i vërtetë.

Tash lind pyetja, a ka brenda segmenteve të Policisë së Kosovës njerëz të involvuar në krime? Ne dimë shumë, shumë raste të zbulimit, të arrestimit të policëve të Shërbimit Policor të Kosovës, që kanë qenë të involvuar dhe kanë kryer krime. Ne e dimë rastin kur në oborrin e policisë, në veturën e policisë është vlarë personi dhe policia s'ka qenë e aftë ta mbrojë personin prej vrasësve. Ne dimë iks e iks raste në Ferizaj, që janë futur eksplozive, kanë ndodhur eksplodime dhe brenda dy minutash, gjithmonë i njëjti ekip i policisë ka arritur në vendin ngjarjes. Kjo lë të nënkuptojë se dikush, një ekip ka qenë afër, ka qenë një eksplodim i planifikuar dhe me një shpejtësi shumë të madhe ka arritur në vendin e krimit, në vend të zbulimit janë zhdukur gjurmët e krimit. Do të thotë, ka shumë shenja që ne duhet të na shqetësojnë shumë seriozisht. Dhe, tash lind një pyetje, a duhet, a kanë besim qytetarët e Kosovës që t'i raportojnë krimet në Policinë e Kosovës? Unë di shumë raste kur qytetarët e Kosovës kanë informata shumë të rëndësishme dhe nuk guxojnë të raportojnë në polici, sepse thonë, mund të ndodhë që unë raportoj pikërisht te ai që e kryen këtë krim ose e ka kryer këtë krim. Dhe, çka është më e keqja, më shqetësuesja, është se në vetë Policinë e Kosovës, njerëz që merren me zbulimin dhe hetimin e krimeve, nuk kanë guxim të raportojnë te eprorët e tyre, sepse kanë informata ose dyshime që ata vetë janë të involvuar në krim. Prandaj, kjo është tepër shqetësuese dhe unë mund të them që në kohën kur kam qenë në Qeverinë e Kosovës, ne e kemi lavdëruar në pedestal Policinë e Kosovës, si një shërbim të mirë dhe efikas, sepse ka qenë interes i yni i procesit të pavarësimit të Kosovës. Por, sot, ne duhet të jemi real, të flasim realisht, ta shohim i e kemi gjendjen e sigurisë dhe të mos lejojmë që kjo gjendje tash të vazhdojë më tutje, sepse interesi ynë është që ta zbulojmë dhe ta luftojmë krimin, jo ta fshehim, jo të jemi joefikas në zbulimin e tij, sepse po na dëmtohet imazhi i policisë ose i institucioneve të Kosovës. Mendoj se kjo sot na duhet dhe ne duhet të krijojmë atmosferë të tillë, situatë të tillë që të gjithë qytetarët ta ndjejnë se Policia e Kosovës është në shërbim të tyre dhe mund ta raportojnë krimin lirisht te ai shërbim dhe ai shërbim do të tregohet efikas në luftimin e tij. Unë mendoj se kemi arsye të mëdha që të shqetësohemi për rastin që ka ndodhur...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYTARI: Faleminderit! Fjalën ka Gani Koci, le të përgatitet Esat Brajshori.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Kisha ndërmend të flas për këtë temë, që është mirë që diskutohet këtu, por para se të lëshohem në çështjet që unë dua t'i shtroj këtu, dua të them diçka që vërtet të kuptohemi drejt dhe të kuptohemi qartë. Nuk është fjala këtu për drejtorin e Policisë me emrin Sheremet Ahmeti dhe Sheremet Ahmetin kjo Qeveri e ka gjetur këtu, ai e udhëheq policinë që tetë vjet e më shumë dhe nuk është instaluar sot po vazhdon të jetë i instaluar akoma dhe do të vazhdojë akoma për deri sa nuk verifikohet edhe shkalla e asaj që po e quani ju përgjegjësi menaxheriale, por edhe përgjegjësi politike ndoshta në nivele tjera. Unë dua të them botërisht se zoti Ahmeti nuk është nip i Kryeministrit – nip i Hashim Thaçit. E thanë këtu disa më përpara. Me sa e njoh unë dhe e njoh shumë mirë familjen e Kryeministrit, Hashim Thaçi i ka dy nipa, njërin e ka njëvjeçar dhe tjetrin e ka dyvjeçar dhe e ka pasur të tretin që vitin e kaluar tragjikisht ka humbur jetën. Besoj se edhe Shkumbini ka shkuar për ta parë, sigurisht në ngushëllime atje. Unë jam nip i kastratëve dhe kastratë ka në të gjitha qytetet e Kosovës, por nuk jam nip i të gjitha qyteteve të Kosovës. Prandaj, të mos i ngatërrojmë këto çështje dhe të mos i individualizojmë këto çështje, sepse nga një debat që do të duhej të ishte shumë serioz kalojmë në atë që quhet jo serioze dhe si temë nuk është mirë që të mos ketë seriozitetin e vet. Thuhet se nëse do ta dish se kush qëndron dhe kush e ka bërë një vepër, çfarëdo qoftë ajo, ktheu te ajo dhe analizo se kush përfiton prej asaj veprë dhe ai që përfiton prej saj, ai mund të jetë edhe aktor i asaj veprë. Zhurmat që janë dëgjuar kohëve të fundit, zhurmat që janë dëgjuar kohëve të fundit sikur japin edhe një nga pistat e hetimeve, po them, edhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme, edhe për task-forcën që merret me këtë çështje, edhe për prokurorinë, edhe për të tjerët që të hetojë edhe një nga pistat e tilla mos eventualisht, mos eventualisht na del ndonjë lidhje e tillë. Këtu përfitimet mund të kenë qenë të dyllorshme, një materiale. që s'besoj që është bërë shumë për përfitime materiale dhe tjetra për përfitime politike. Nuk e besoj se kjo qeveri përfiton shumë politikisht po të kishte, po të mos e kishte vullnetin për ta zbuluar dhe për ta hetuar këtë çështje. Dhe, të ju them të drejtën, shtëpinë time nuk mund ta vjedh askush në qoftë se nuk dëshiron, në qoftë se nuk është dikush i shtëpisë time që mund t'i sjell aty brenda. Dhe, të gjithë ata që kanë qenë të instaluar në atë shtëpi, nuk janë instaluar që një vit e gjysmë, janë instaluar që 8 vjet dhe pse kjo zhurmë në kohën tash që, vërtet, në vend që të hetohet drejt dhe qartë, pse kjo zhurmë bëhet pikërisht edhe në një formë tjetër duke ikur prej policisë dhe ku grumbullohen këta që ikin prej policisë, ku janë, ku shkojnë. Jo, shkojnë në Deçan atje. Nuk shkojnë në Skenderaj, por shkojnë në Deçan dhe nëse dëshironi ta ngatërrooni edhe Skenderajn me Deçanin, e keni shumë gabim, se nuk mund të ngatërrohet absolutisht këtu.

KRYETARI: Në temë, në temë!

GANI KOCI: Prandaj, le të jetë si vërejtje kjo edhe për ministrin e Punëve të Brendshme, edhe për task-forcën që merret me këtë çështje, që vërtet hetimet të bëhen në shumë drejtime dhe jo vetëm në një drejtim, sepse vetëm në një drejtim nuk shkojmë askund. Po e them publikisht, meqë po flisni ju atje. Sa njerëz nga Shërbimi i Policisë dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme kohëve të fundit i reklamoni nëpër... që aderojnë në

partinë tuaj atje, a mos ju sjellin ata informacione të rrejshme juve, a mos janë ndoshta projektuesit e veprimeve të tilla. Ju lutem!

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! A po e sheh që ia ndalëm. Fjala është për deputetin Esat Brajshorin, le të përgatitet Gjylnaze Sylja.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë, sinqerisht, edhe pse isha përgatitur për këtë fjalë rasti, u mendova disa herë që në shenjë të një proteste ose, më saktë, të një refuzimi estetik, të mos e jap fjalën time për shkak të nivelit dhe të deformimit ose, më saktë thënë, të devalvimit komplet të debateve në Parlamentin tonë.

Nuk është rast i parë që gjërat shumë serioze nuk trajtohen seriozisht. Po ndërlidhem që në fillim me fjalën e Kryetarit të Parlamentit, që e tha, kjo është një informatë, e ndoshta do të duhej të ishte edhe një interpelancë dhe është vështirë tash të shtrihet fjalimi im në çfarë rrafshi ta trajtoj, si informatë apo si interpelancë, edhe pse forma përfundimtare duket që të jetë një informatë.

Zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Sinqerisht, jam shumë i shqetësuar, se nuk është hera e parë që ky Kuvend debaton pa asnjë përfundim, pa asnjë konkluzion, pa asnjë rekomandim, pa asnjë votim, me orë të tëra dhe kështu edhe i torturojmë qytetarët edhe veten tonë.

KRYETARI: Esat, për këtë lexoje Rregulloren, po vazhdo në temë.

ESAT BRAJSHORI: Kjo i bie... po, zoti Kryetar, kjo i bie sikur të luajmë futboll, po pa porta fare, sepse gola nuk duhet të ketë në fund.

Dhe, tani, a është interes i yni i përbashkët, sinqerisht pyes – a është interes i yni i përbashkët zbulimi i aktorëve të vjedhjes apo pretendimi i dikujt për të përfutur mbi këtë histori dhe i dikujt tjetër që të ikën nga përgjegjësia me të cilin e obligon ligji dhe Kushtetuta.

Dua të them se qasja apriori nga këto dy pozicione nuk do të ishte serioze, aq më pak në dobi të zbulimit dhe të zbardhjes së këtij rasti. E them këtë edhe për faktin sepse në këtë Kuvend është bërë shprehi që vetëm të thuhet diçka ashtu bosh, skajshmërisht bosh, pa asnjë ide, pa asnjë solucion mbi çfarëdo çështje që shtrohet për debat, të mos them sa për t'u notuar pozitivisht nga monitoruesit e këtij Kuvendi.

Çështja për të cilën po debatojmë sot ka të bëjë me një vjedhje spektakulare në dhomën e hetimeve në Ministrinë e Brendshme, përkatësisht në Policinë e Kosovës. Për mua është indikative si ka mund të zhvillohet gjithë ky operacion vjedhjeje, aq më tepër në një institucion të sigurisë së lartë. Diçka të ngjashme, por për motive tjera, kemi mund të shohim vetëm në burgjet greke, kur arratisja e të burgosurve bëhej me helikopter. Në rastin tonë, vjedhjen nuk kanë mund ta bëjnë hajnat ordinerë, aq më pak ajo pjesë e policisë së pandikuar politikisht e Kosovës, e cila polici me stomakun e zbrazët, kujtojmë

këtu pagat e tyre, po jep maksimumin e vet për sigurimin e jetës së qytetarëve dhe të pronës së tyre.

Atëherë, cila është adresa që çon në zbulimin dhe kapjen e hajnave? Mendoj se kjo do të duhej të ishte edhe informatë edhe debati mbi të cilin do të duhej të drejtohej i gjithë ky debat, në fakt.

Realisht, mua tashmë nuk më bën përshtypje fare ose shumë pak më bën përshtypje se çka është vjedhur aty, por çfarë do të ndodhë nesër me sigurinë e qytetarit, të pronës dhe të jetës së tij në këtë vend. Frikohem se dy janë pistat dhe adresat e hajnave në dhomën e dëshmime në Policinë e Kosovës. E para, mund të jetë mafia e racave të ndryshme, që do të ishte kërcënim për institucionet dhe të ardhmen e këtij vendi dhe, e dyta, politika që mund të ketë shumë adresa, politika që mund të ketë shumë adresa, që gjithashtu do të ishte kërcënim për fëmijët tanë.

Zoti ministër,

Ajo çfarë i ofruat ju këtij Kuvendi, si informatë, është pak për qytetarët e vendit tonë. Ata kanë pritur se në çfarë faze ndodhen hetimet, edhe sa hapa, edhe sa kilometra, edhe sa javë apo muaj do të mund të kapen kriminelët. Kjo është në interes për mua dhe qytetarët apo logjika e vazhdimit të hetimeve do vazhdojë edhe më tutje pafundësisht – hetimet vazhdojnë dhe që do të ndodhin ngjarje tjera që kjo të ngelet në harresë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! I nderuari deputet, Kreu IX i Rregullores - Puna në Kuvend, kështu quhet, Rregulla 22, nën pikën 5, shkronja g) shkruan: “Në fund të diskutimeve propozuesi i projektligjit ose i mocionit përmbajtjesor ka të drejtë të përgjigjet dhe pastaj Kryetari i Kuvendit mbyll diskutimet”. Kështu shkruan në Rregulloren e Kuvendit.

Shkumbin Demaliaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, Kryetar!

Është bërë e zakonshme në Kuvendin e Kosovës që të debatohet dhe të përmenden emrat e njerëzve, por kryesisht më erdhi shumë rënd atë çka e tha kolegu im i nderuar, zoti Koci, kur përmend linjat Skenderaj – Deçan. Unë shpresoj se ata ende i kanë plagët e hapura dhe nuk kanë kohë të merren me kilogramë të tillë të drogës. Ngjarja ka ndodhur në stacionin e Policisë, ku është e vendosur edhe Drejtoria e përgjithshme e Policisë, e jo në Deçan, as në Skenderaj. Unë s’kam diçka për të shtuar më tutje, por i lus deputetët që mos ta kthejnë këtë problem politik, sepse është problem ekzekutiv, ka përgjegjës dhe përgjegjësi dihet, dihet përgjegjësi i ligjshëm, është përgjegjës për të gjitha ato që kanë ndodhur dhe këtu po e ndërpres replikën për të mos vazhduar më tutje, por uroj që qytetarët të mos përzihen në këtë, sepse publiku tashmë po e di.

KRYETARI: Faleminderit deputet! Ju lutem, nuk ka kundër replikë. Kësaj radhe nuk ka. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla. Armend Zemaj është i radhës.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar dy ministra,

Deputetë të nderuar,

Sot po shqyrtojmë një çështje shumë serioze, prandaj edhe trajtimi dhe qasja duhet të jetë shumë serioze.

Zoti ministër, jam shumë e zhgënjyer me informatën tuaj. Është e varfër, e paplotë dhe pa rezultate konkrete. Për më tepër, në hyrjen tuaj ju keni shkruar se është raport që ka qëllim t'i informojë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës me situatën e përgjithshme të sigurisë. Asnjë fjalë s'e ndjeva për situatën e përgjithshme, sepse debati për veriun e Kosovës do të ishte i pa evitueshëm.

Tash po kthehem te tema – vjedhja e dëshmime, e cila është bërë para dy muajve, siç thatë edhe vetë, më 24 dhe 25 prill. Dy muaj, pa asnjë rezultat, edhe pse ky rast është krimi më flagrant i bërë kundër institucionit të policisë. Ju them se me këtë rast nuk është sulmuar policia, por shtylla e shtetit dhe vetë shteti. Me fjalë të tjera, kjo vjedhje paraqet funksionim të krimit të organizuar.

Veprimet të cilat i ka marrë ministri dhe policia po i numëroj. Së pari, janë shkarkuar 5 zyrtarë të policisë. Pastaj, 3 u zunë në kufirin me Maqedoninë dhe u arrestuan. Tash pyetja ime dhe pres të jeni i sigurtë, i saktë dhe preciz në përgjigjet tuaja. Në qoftë se i keni arrestuar ata dhe ata janë liruar, çfarë keni gjetur. A keni gjetur ndonjë nga objektet të cilat janë vjedhur në dhomën e dëshmime në polici. Tjetra është, zoti ministër, nuk jam e sigurt se na e keni dhënë listën e plotë të evidencës. Kërkoj listën e plotë të gjërave të vjedhura. A është saktësisht vetëm droga dhe monedhat e ndryshme të Indisë, të Turqisë, të Rumanisë dhe të Shqipërisë apo ka pasur edhe diçka tjetër? Ju vetë keni premtuar në seancën e kaluar se së shpejti do të zbardhet rasti. Na tregoni kur, apo ndoshta skandali do të heshtet. Tjetra është se 9 vjet është investuar në këtë institucion dhe ka qenë dhe është tregimi më i suksesshëm i Kosovës.

Keni arritur që gjatë kësaj kohe me këtë ngjarje të rritni ndjenjën e mosbesimit te qytetarët. Për më tepër, përgjegjësia tanimë nuk është vetëm e Qeverisë ose e menaxhmentit të policisë, por përgjegjësia është edhe e Kuvendit të Kosovës në qoftë se ne nuk ushtrojmë përgjegjësinë tonë për të mbikëqyr dhe masat adekuate që të zbardhet deri në fund, por edhe që ky rast të mos përsëritet më.

Na e shpjegoni atë si është e mundur të futet dikush në dhomën e dëshmime, e cila duhet të ketë nivelin më të lartë të sigurisë, kur vetë drejtori i përgjithshëm i policisë thotë se edhe vetë ka qenë vetëm dy herë dhe se asnjëherë nuk ka pasur ndonjë kërkesë për marrjen e masave shtesë lidhur me sigurinë.

Veprimet tjera të cilat janë marrë – është formimi i task-forcës. Si keni mund të formoni task-forcën për ta hetuar vetveten. Është dashur të formoni një organ të pavarur. Në fund të fundit, kjo është shkelje e ligjit, të Kodit të procedurës penale.

Tjetra është se, në qoftë se duhet kërkuar përgjegjësinë, patjetër përgjegjësia nuk mund të kërkohej në nivelin e pestë, do të thotë administrative, siç është bërë me shkarkimin e pesë zyrtarëve të policisë. Përgjegjësia është politike. Zoti ministër ju keni përgjegjësinë për funksionimin e policisë dhe është dashur të japësh dorëheqje. Për më tepër, në rastet ku funksionon demokracia, kryeministri është dashur të japë dorëheqje.

Po ju lexoj Ligjin e Policisë, neni 37.1: “Drejtorin e përgjithshëm të Policisë e emëron Kryeministri, bazuar në propozimet e ministrit”. Prandaj, përgjegjësia është e Kryeministrit dhe përgjegjësia është e juaja. Dhe, po të funksiononte shteti ose po të kishim Qeveri si duhet, ju sot do të jepnit dorëheqje.

Në fund, të flas edhe për një dëm të madh që i shkaktuar Kosovës, e që ka të bëjë me integritimin e Kosovës në familjen evropiane. A mund të jemi pjesë e familjes evropiane kur e vjedhim shtëpinë tonë?

Dhe, po e përfundoj, shumë më me dëshirë sot do të flitja për rritjen e pagave të pjesëtarëve të policisë dhe jo për vjedhjen në polici. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për hir të opinionit, po them, që Parlamenti nuk mund ta luajë rolin e hetuesit as të Gjyqësorit. Komisionet e rregullta të Parlamentit janë komisionet e rregullta dhe nuk mund të shndërrohen në komisione hetuese dhe kjo duhet të vlejë për të gjitha komisionet e Kuvendit. Do të thotë, kështu duhet ta trajtojmë këtë lëndë, konform me ligjet që janë në fuqi, edhe me Kushtetutën, edhe me ligjet.

Mendoj se para pauzës, deputeti i fundit për debat është deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: I nderuar Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra të respektuar,

Është shumë e kuptueshme se dukuria e krimit të organizuar në Kosovë është një sfidë e madhe për institucionet tona, që janë kompetente për luftimin e kësaj dukurie negative.

Sot ne po diskutojmë për një vjedhje, vjedhje të dhomës së dëshmive, që ruhen provat materiale të krimeve të ndryshme dhe dhomë e cila duhet të ishte e super siguruar.

Unë, së pari, bëj pyetje: cila është përgjegjësia e drejtuesve të institucionit më të respektuar dhe që njihet më pak i korruptuar në Kosovë? Është shumë jo normale që qytetarët e Kosovës të ndihen të sigurt me këtë komandë të Policisë së Kosovës, kur në mes të kryeqytetit të Republikës së Kosovës, në vendin i cili është më kompetenti për mbrojtjen e rendit publik dhe të qendrës së luftimit të krimeve dhe të krimit me peshë serioze, të ndodhë një hajni dhe të mos vërehet nga askush. Komanda e Policisë së Kosovës deklaroi se rasti është i izoluar dhe raste të tilla ndodhin edhe në vendet më të përparuara të botës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Këto deklarime për mua nuk janë fare çuditëse duke marrë parasysh që kjo komandë udhëheq që nga përfundimi i luftës. Këto fjalë dhe këto veprime të marra, për mua janë joserioze, sepse këto veprime dhe këto masa të njëjtat janë konsideruar të izoluar edhe kur është vrarë polici hetues i Kosovës Hajdar Ahmeti, edhe kur është vrarë deputeti Smajl Hajdaraj, edhe kur është vrarë Tahir Zemaj, Enis Zemaj dhe Hasan Zemaj, edhe kur janë vrarë dy vajzat e mitura Antigona Dedushaj dhe Florina Kelmendi, në atentat, njëra 11 vjeçare, tjetra 14 vjeçare, vetëm 20 metra larg nga stacioni i policisë në Pejë. Edhe sot, kur vrasësi i Sebahate Tolajt dhe Isuf Haklajt sillet lirshëm, ka dalë lirshëm nga burgu dhe sillet lirshëm në Pejë dhe në Deçan. Të njëjtat masa, të njëjtat veprime merren nga komanda e kësaj policie. Pra, veprimi i kësaj komande është më shumë zero dhe mbeten raste të izoluar.

I nderuar ministër,

Nëse politikë e Ministrisë është që njerëzit që nuk kanë kapacitete vepruese për të luftuar krimin e organizuar që i bënë dëm shoqërisë dhe prish imazhin e suksesit të vendit tonë, vazhdojnë të udhëheqin me sektorin e sigurisë, atëherë nuk di çka mbetet tjetër dhe me çka do të çuditemi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po flasim për një vjedhje në dhomën e dëshmive. Në vitin 2003 e njëjta dhomë, me karakter të njëjtë, është sulmuar në Pejë me zollë dhe nuk kemi çka të çuditemi pse ndodh edhe pas gjashtë viteve, sepse atëherë s'është dënuar askush dhe as sot nuk do të dënohet askush, se prapa saj qëndrojnë veprime tjera inkriminuese që lidhen më shumë me politikën.

Këto veprime nuk merren parasysh edhe kur kemi deklarata publike për inkriminim të njerëzve të politikës në krim të organizuar. Cili është veprimi i komandës së Policisë së Kosovës dhe i organeve të hetuesisë. Kemi njerëz që deklarojnë publikisht për njerëz që janë të inkorporuar në krim, në mito dhe në të gjitha dhe asnjë veprim nuk e kemi.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, i nderuar ministër, rekomandimet e Komisionit për Punë të Brendshme që ne nuk i kemi përpara, po i kemi lexuar dhe janë të ditura, duhet të merren shumë seriozisht nëse dëshironi që t'i ndihmoni vendit tonë, t'iu ndihmoni qytetarëve dhe ta ngritni nivelin e sigurisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po, komanda e Policisë nuk është hetuesi as gjyqësi. Tash kemi pauzë. Vazhdojmë në ora 15:00. A jeni dakord? Në orën 14:00 Kryesia e ka një mbledhje.

Drejtimin e seancës e merr zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Të nderuar deputetë, luteni që t'i zëni vendet. Vazhdojmë me diskutuesit e radhës, ashtu siç janë paraqitur. Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi, le të përgatitet deputetja Njomza Emini.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ministër, zëvendëskryeministër,

Para se të filloj unë, më duhet të them që reagimet e disa kolegëve nga pozita, mu kujtua një moment kur ndodhi rasti i vjedhjes së shtëpisë së Kryeministrit dhe zëvendëskryeministri doli menjëherë dhe akuzoi Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës.

Më e keqja është se në këtë rast doli një zyrtar i policisë dhe tha – jo, është një vjedhje ordinere dhe ai u hesht, iu mbyll goja dhe as sot e atë ditë nuk kemi dëgjuar më asnjëherë zërin e tij. Kjo flet për diskursin që ka kjo Qeveri dhe në veçanti Partia, që po thotë më e madhja.

Kthehem te aspekti i vjedhjes në polici. Kam këtu një raport të auditorit të brendshëm dhe disa dëshmi të cilat kanë një numër të pyetjeve që kërkojnë përgjigje, që besoj do t'i marrim sot nga ministri.

Dhoma e dëshmive është dhomë e siguruar mirë, ku ruhen dëshmitë, e cila është nën administrimin e njërive të hetimeve në stacione policore, komandë rajonale policore dhe shtab të përgjithshëm të policisë - PSO për dhomat e dëshmive.

PSO për dhomat e dëshmive ka paraparë inspektime të paparalajmëruara të dhomave të dëshmive nga ana e menaxherëve, të shefave të hetimeve, një herë në vit parashihet inventarizimi i tyre nga përgjegjësi i dhomave të dëshmive, kurse revizioni i brendshëm

parashihet çdo tre muaj. Këto veprime nuk janë ndërmarrë asnjëherë nga menaxhmenti përgjegjës dhe unë pyes pse?

Përfundim bën inspektimi nga IPK-ja në janar të vitit 2008. Ka zhvilluar një inspektim të jashtëzakonshëm për të siguruar se objektet policore, zonat e ndjeshme brenda këtyre ndërtesave dhe automjetet iu nënshtrohen protokolleve të rrepta të sigurisë.

Raporti i publikuar mbi gjendjen aktuale të asaj periudhe ka vë në pah nivel jo të pranueshëm të sigurisë së objekteve policore. Siguria e objekteve policore është nën çdo nivel. Ky raport potencon se të gjitha dhomat e dëshmimeve duhet të jenë të pajisura me alarm të ndërhyrjes, i cili detekton kur hapet dera pa autorizim, instalimin e video mbikëqyrësit në hyrjen kryesore apo në të gjitha pikat kryesore dhe me elemente të tjera të sigurisë.

Në raportin e Njësitit të inspektimit e të auditimit të brendshëm të policisë, raport i datës 19.3.2008 dhe në raportin e këtij njësi janë potencuar shqetësimet lidhur me udhëheqjen e dhomave të dëshmie, sigurimin e kushteve brenda kësaj dhome. Këto dy raporte i janë dorëzuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Raporti i IPK-së dhe zëvendëskomesarit të SHPK-së, tash drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Raportet nuk janë përfillur dhe asnjë nga këto pika nuk është zbatuar. Formimi i task-forcës është ilegal. Personeli në këtë forcë është nga personeli i Drejtorisë ku edhe ka ndodhur vjedhja, që është direkt konflikt interesi. Tash kush po i bie që po e kontrollon e kush ka vjedhur. Do me thënë, ata që kanë vjedhur po i bie që po e kontrollojnë vjedhjen.

A ka ndonjë organ, pyes ministrin, i pavarur i cili do të siguronte publikun e gjerë se janë duke u zhvilluar hetime të paanshme, të pavarura e objektive dhe në bazë të Kodit evropian të etikës policore – neni 19, hetimet do të jenë të përgjegjshme e transparente.

Nuk dihet qartë, nga informatat që na i dhatë, nën kompetencë të kujt është dhoma e dëshmimeve. Në disa raste nuk korrespondojnë dëshmitë me të dhënat e dëshmimeve. Nuk është mbajtur evidencë strikte mbi dëshmitë dhe qasjen në dhoma të dëshmimeve. Marrja e dëshmimeve nga ndërkombëtarët për asgjësim dhe kryerja e dëshmimeve pa evidencë për marrje dhe pa evidencë për kthimin e tyre, është një shkelje tjetër e radhës. Ka dyshime të bazuara se nga dhomat e dëshmimeve janë nxjerrë dëshmi të kundërligjshme. Rasti i një A4-47 armë, e cila u gjet në Mitrovicë dy herë, qysh është e mundur prej dhomës së dëshmimeve një armë të hyjë, të dalë dhe prapë të hyjë. Një armë tjetër – revole, është gjetur edhe në Vushtri, prapë prej të njëjtit rast, prej të njëjtit burim. A po e konfirmon kjo atë që e tha kolegu im më herët se vjedhja ka ndodhur në mënyrë të vazhdueshme dhe a ka ndodhur vjedhja ditën që është raportuar publikisht.

Pas vjedhjes së dhomës së dëshmimeve, inventarizimi është bërë nga personeli i kësaj shtylle. Dyshohet në inventarizim subjektiv.

Përgjegjësi për marrje kanë, do të thotë për marrje apo vjedhje, qysh po e quajmë ne, por po konsiderojmë se ka qenë një marrje e kohëpaskohshme, në bazë të interesave: ministri i Punëve të Brendshme është përgjegjës për neglizhimin e rekomandimeve të IPK-së, drejtori i përgjithshëm i policisë është përgjegjës për mos ndërmarrje të veprimeve të rekomanduara nga IPK-ja dhe Njësi i inspektimit

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, e nderuar deputete!

(Ndërhyrje – reagim)

Regjia, ia zgjatni diskutimin edhe për një minutë!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Në fund, po dua të them se sot ky Kuvend nuk kërkon llogari prej përgjegjësve të cilët i ceka më herët. Përgjegjësi kryesor është i pari i Qeverisë, që iku dhe e neglizhoi këtë seancë. Mund të konsideroj se duke pas parasysh të gjitha të dhënat e lartshënuara, konsiderojmë se ekziston vetëm një përgjigje: në Kosovë është instaluar krimi i organizuar dhe ky krim burimin e ka në kokë.

Vjedhja e një sasive të madhe të drogës në dhomën e dëshmitë në Policinë e Kosovës paraqet funksionimin e krimit të organizuar. Zgjidhja e këtij rasti është politizuar, sepse peshkut i vjen era nga koka dhe me këtë rast nuk kemi interes dhe vullnet politik për ta zgjedhur këtë rast. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Vazhdojmë me deputetin e radhës, Njomza Emini, nuk është këtu. Sipas radhës deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Më befasove i nderuari kryesues! Megjithatë, të falënderoj që ma dhe fjalën.

I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Diskutimi i cili po zhvillohet sot, pa dyshim ka një ndikim të madh në opinionin publik i cili po na përcjell, pastaj edhe vetë ky rast eklatant i krimit ordiner, i cili ka ndodhur në një institucion të rëndësishëm të sigurisë në Kosovë, zgjon interesimin e opinionit.

Pa dyshim, edhe unë si deputet dhe i Partisë të cilës unë i takoj, jemi të gjithë të shqetësuar dhe angazhohemi që ky rast eklatant i krimit të zbardhet sa më shpejt.

Lajmi për këtë krim ordiner i cili ka ndodhur në polici, padyshim ka ngritur edhe shumë shqetësime dhe shumë dyshime në lidhje me funksionimin e këtij institucioni.

Ne duhet të kemi parasysh kohën kur është krijuar Shërbimi Policor i Kosovës, rrethanat politike në të cilat është formuar ky institucion dhe padyshim shihet qartë se brenda këtij institucioni ka edhe dobësi. Megjithatë, nuk kisha dëshiruar që të shfrytëzohet debati për të stigmatizuar një shërbim policor i cili me përkushtim po e kryen punën e vet dhe, në përgjithësi, pjesëtarët e këtij shërbimi kanë manifestuar vullnet dhe gatishmëri që të jenë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Mua, si deputet i Kuvendit të Kosovës, zoti ministër, më shqetëson fakti se si është kualifikuar ky krim ordiner, cilat janë pistat e hetimit, pavarësisht se ju nuk mund t'i bëni të gjitha publike, mirëpo mua më intereson se a ka ky krim ordiner edhe motive politike. Për vetë faktin se pasi që ka ndodhur krimi ordiner, për të cilin po flas, një pjesë e pjesëtarëve të Shërbimit Policor, dy drejtorë të dy departamenteve të rëndësishme, kanë dezertuar nga ky institucion dhe kanë kërkuar azil politik në një parti politike. Pastaj, një ish ministër i rendit, gjithashtu është zyrtar i lartë i një partie politike, parti politike e cila

që në momentin kur ndodhi ky krim ordiner, i prejudikoi edhe kryerësit e mundshëm dhe e prejudikoi, domethënë, fajtorin për këtë krim.

Pastaj, një këshilltar i lartë i ish-ministrit të rendit, gjithashtu është zyrtar i një partie politike. Padyshim, krimi ordiner i cili ka ndodhur në Ministrinë e Rëndit ka dëmtuar imazhin e vetë Policisë së Kosovës, por edhe të Kosovës në përgjithësi, mirëpo imazhin e Kosovës e ka dëmtuar shumë edhe vetë prejudikimi i kryerësve të mundshëm të këtij krimi nga një parti e caktuar politike.

Unë jam i brengosur dhe i shqetësuar dhe dëshiroj të di a ka elemente të krimit politik ky krim që ka ndodhur aty dhe krimi i organizuar në Kosovë sa e ka kapur Shërbimin Policor të Kosovës, sa është i implikuar në këtë shërbim. Pastaj, sa është i politizuar ky shërbim aktualisht dhe a keni ju mundësi që të verifikoni përkatësinë partiake të pjesëtarëve të këtij shërbimi dhe njëkohësisht a respektohet ligji që të gjithë pjesëtarët e policisë duhet të jenë politikisht të paanshëm.

Ka edhe mjaft shqetësime që mund të ngrihen këtu dhe besoj se ju duhet me stafin tuaj ta zgjeroni pistën e hetimeve dhe mos të prejudikoni edhe ju, të prejudikoni kryerësit e mundshëm të këtij krimi.

Unë kisha pasur dëshirë që ky të jetë një krim i pastër ordiner, kriminel, për qëllime të përfitimit, por mos të ketë edhe motive politike në këtë krim i cili ka ndodhur aty.

Se krimi ka qenë i organizuar, i planifikuar dhe i kryer në mënyrë profesionale, kjo nuk do mend. Mua ma merr mendja se jeni vonuar me masat ndëshkuese të cilat është dashur t'i merrni, zoti ministër.

Ju nuk keni të drejtë të burgosni askënd, por keni të drejtë të suspendoni. Mua më intereson sa kanë qenë larg...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Vazhdojmë me deputetin e radhës, Eset Cakolli.

(Ndërhyrje)

Të lutem, nuk ua ka përmendur emrin!

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

I nderuari ministër,

Të respektuar kolegë deputetë,

Sot, para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës është dhënë një informatë nga ana e ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vjedhjen e rëndë që ka ndodhur më 22 prill 2009 në dhomën e provave të Policisë. Kjo informatë është e përgatitur në pesë pika dhe të dhënat e kësaj informate dallojnë shumë pak nga informacionet që janë dhënë përmes mjeteve të informimit, qoftë të atyre të shkruara apo elektronike dhe të cilat janë dhënë për opinion e gjerë publik prej momentit kur ka ndodhur rasti e deri më sot. Kjo informatë ndoshta është dashur të ketë të dhëna më të shumta dhe më konkrete se si ka ndodhur incidenti në fjalë, masat e ndërmarra për zbardhjen e këtij rasti, si dhe kur

priten të përfundojnë hetimet rreth këtij rasti. Por, ndoshta Policia e Kosovës, për shkak se ende nuk kanë përfunduar hetimet, i mban konfidenciale disa informata dhe mbetet që të shihet në kohën në vazhdim.

Në pikën 2 të kësaj informate është dhënë raporti i policisë, ku është përshkruar vendi i ndodhjes së dhomës së dëshmime dhe sasia e substancës narkotike prej 47 kilogramë e 620 gramë, si dhe një sasi e konsideruar e mjeteve financiare në valuta të ndryshme që është vjedhur.

Për këtë pikë mund të shtrohen shumë pyetje konkrete. Me këtë rast unë kam një pyetje. Në dhomën e dëshmime a ka pasur të montuara kamera të vëzhgimit? Nëse po, a kanë funksionuar ato, nëse jo pse nuk janë montuar kamerat e vëzhgimit kur sot edhe nëpër shitore dhe restorante private i montojnë kamerat e vëzhgimit.

Në pikën 3 të kësaj informate janë përshkruar edhe masat ndërmarra nga drejtori i përgjithshëm i policisë me qëllim të zbardhjes së këtij rasti. Nga raporti i policisë shihet se janë arrestuar 3 persona me datën 2 qershor 2009, ku thuhet se këta persona janë përcjellë për një kohë të gjatë nga policia dhe dyshohet se kanë qenë të involvuar në aktivitete të ndryshme kriminale, si dhe po hetohen edhe për përfshirjen e mundshme të tyre në vjedhjen e rëndë që ka ndodhur në dhomën e dëshmime, e cila gjendet në katin e pestë të ndërtesës së policisë dhe janë suspenduar 5 zyrtarë policorë.

Të nderuar deputetë,

Ne jemi dëshmitarë se qytetarët e Kosovës janë të zhgënjyer që edhe pas dy muajve që ka ndodhur rasti, ende nuk janë gjetur kryerësit e kësaj veprë të rëndë dhe kjo ka ndikuar që të zbehet imazhi i policisë edhe pse deri më tani Policia e Kosovës ka qenë një institucion i besueshëm dhe i ka kryer të gjitha detyrat e parapara sipas Ligjit mbi policinë.

Zbardhja e rastit dhe marrja e dënimit të merituar i të gjithë atyre personave që kanë qenë të involvuar në këtë rast, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, duhet të jetë me interes për institucionet e Kosovës sepse këtë e presin qytetarët e Kosovës, prandaj kjo vjedhje e rëndë që ka ndodhur në objektin e policisë, nuk guxon të mbetet e harruar, as hetimet të vazhdojnë për kohë të pa fundme.

Në fund, shpresoj dhe besoj se ekipi i hetuesve policorë profesionalë do të dalë me rezultate konkrete për këtë vjedhje të rëndë që ka ndodhur dhe kjo do të ndikonte që policia e Kosovës ta fitojë besimin dhe mbështetjen e gjerë të popullit të Kosovës në të ardhmen. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Ramadan Avdiu.

RIZA SMAKA: Të nderuar, zotëri kryesues,

Deputetë të respektuar,

Ministër i nderuar,

Incidenti që do ta kisha quajtur skandaloz në dhomën e provave, në prillin e këtij viti, ndodhi. Do me thënë, ndodhi, kjo është një ngjarje.

Për këtë çështje kaq delikate edhe problematike konsideroj se është dashur të mbahet një seancë e mbyllur, prapa dyerve të Kuvendit dhe të prezantohet një informacion shumë më i pasur dhe shumë më detal nga ky që e morëm nga zotëri ministri, sepse për deputetin e

popullit nuk duhet të ketë fshehtësi. Tek e fundit, ne duhet ta kishim quajtur seancën tonë çështje të sekretit, po e zëmë, shtetëror të rangut të caktuar, apo jo. Por, megjithatë, nga informacioni dhe nga diskutimet e kolegëve të nderuar, për mua dalin disa çështje problemore. Një, po e zëmë, çështja e sigurisë, e mbrojtjes, e ruajtjes, e sigurisë së të dhënave, të materialeve të rëndësisë së veçantë. Do të thotë, kjo është çështje shumë problematike kur ndodhi ajo që ndodhi aty ku, po e zëmë, shkalla e sigurisë do të duhej të ishte më e larta, më kualitativja. Më pastaj, edhe nga referimi i ministrit del si çështje problemore relacioni Polici e Kosovës – Ministri e Punëve të Brendshme, që edhe unë e konsideroj se është çështje problemore sepse, sikundër ministri për Punë të Brendshme, ashtu ngjashëm edhe për Drejtësi do të duhej të kishin më shumë ingerenca, më shumë autorizime, më shumë prerogativa referuar këtyre dikastereve kaq të ndjeshme, sepse nuk është e vërtetë sikundër disa që provojnë për të argumentuar se sistemi i ndarjes së pushteteve është i tillë që ministri nuk ka autorizime që mund të mos ketë tani për tani. qoftë i Punëve të Brendshme, qoftë analogjikisht i Drejtësisë. për Gjyqësorin, sepse Gjyqësori, siç tha zotëri ministri, po e zëmë, raste penale kriminale që i prezantohen Gjyqësorit dhe çka ndodh? Në vend që të persekutohen sipas Kodit penal, a po jo, sanksionet a në procedurë sipas Kodit për procedurën penale, lirohen dhe kjo është tepër shqetësuese.

Më pastaj, çështje problemore është zhagitja e skajshme e çështjeve penale. Kur zhduken, për mua nuk është aq tepër e ndjeshme, delikate vjedhja e parasë apo, si të them, e gjësendeve me vlerë, sa zhdukja e provave. Se ne dimë si nga teoria, ashtu edhe nga praktika, kur ka bërë krim, po e zëmë, primusi, mirëpo s'ka pasur prova dhe është shpall se lirohet për shkak të mungesës së provave. Kjo është çështje tepër alarmante. Në vendin tonë duket se sistemi i përgjegjësisë nuk ekziston. Unë do të isha angazhuar në këtë kontekst që të bëjmë ne një projektligj dhe ta miratojmë një ligj për përgjegjësinë politike, edhe objektive, edhe morale.

Shpeshherë ka tentativa për absorbim të përgjegjësisë nëpërmjet mbrojtjes se nuk përgjigjet ky sistem, kjo shtyllë nuk ka ingerencë mbi atë shtyllë. Kuvendi i Kosovës, në rastet më delikate, shpeshherë pikërisht nga ky justifikim del se nuk ka kurrfarë kompetencash. Pse? Sepse qenka sistemi i pavarur e nuk është asisoj në asnjë shtet modern, se është sistemi checks and balances, ku ekziston edhe pavarësia funksionale e tri shtyllave shtetërore, po ekziston edhe mbikëqyrja, edhe kontrollimi, edhe përgjegjësia, e ne këtë duhet ta ndërtojmë në rendin juridik tonë, që mungon.

Përfundimisht, zotëri kryesues, vlerësoj se Policia e Kosovës meriton mbështetje institucionale legale dhe materiale dhe përkrahje për punën që e bën, për kushtet që nuk i ka kurrfarë, për pagat mizerabël që janë, në krahasim, po e zëmë, me bordistët, që herë-herë u mbërrin paga, po e zëmë, disa menaxherëve, të quajtur ekspertë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Edhe një minutë, fjalën deputetit Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit! Edhe, ju lutem, nuk mund të flasim për përgjegjësi, po e zëmë, konkretisht të ministrit për derisa nuk ka autorizime të tilla që të ndërmerre masa efikase, sepse këputet zinxhiri i hierarkisë. Kësisoj, parimisht, flas për tash, po ndryshe të ishte rendi juridik i tillë që ministri, po e zëmë, të kishte ingerenca dhe autorizime të tilla funksionale, apo jo, edhe apozicionale, atëherë natyrisht se do të duhej në ditën e parë të

skandalit, që ministri, po e zëmë, flas konkretisht, të jepte dorëheqje si akt moral të përgjegjësisë dhe funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu, le të përgatitet deputeti Ibrahim Selmanaj.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Të respektuar kolegë deputetë,

Meqenëse pjesa e rëndësishme e debatit është konsumuar gjatë pjesës së seancës së para ditës, unë, të nderuar deputetë, diskutimin tim do ta filloj me dy sintagma të filozofisë sonë popullore, e cila është shumë e pasur, por jo shumë e eksploatuar. E para është se shteti e zë lepurin edhe me qerre dhe, e dyta, askujt nuk i mbetet asgjë për atë botë.

Rasti për të cilin praktikisht debatua sot, është vërtet serioz, mund të them edhe shqetësues, nga se ka ndodhur një akt i rëndë kriminal, duke vjedhur dëshmi në një vend që normalisht duhet të jetë pjesa më e sigurt e objektit ku ka ndodhur rasti dhe vendi më së paku i frekuentuar nga njerëzit. Por, kjo tashmë ka ndodhur.

Dua të theksoj se nuk është hera e parë që vidhet dhoma e dëshmisë. Ka pasur edhe më herët raste të vjedhjes, para vitit 2007, në dy qendra tjera, në Prizren dhe në Pejë, por sikurse deputetët, ashtu edhe opinioni i gjerë publik nuk kanë qenë fare të informuar, e lëre më të debatojmë, siç po debatojmë ne sot. Unë nuk dua të paragjykoj dhe të numëroj pistat e supozuara të hetimeve si disa kolegë diskutues të mëhershëm. Nuk dua të paragjykoj se a është nga brenda apo nga jashtë. Kjo besoj se do të zbardhet nga ekipet që merren me hetimin e rastit. Debatin ynë mund të ndihmojë sektorin e sigurisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, jo për ndriçimin e rastit në fjalë, por për marrjen e masave në drejtim të konsolidimit dhe të forcimit të këtij sektori, i cili pavarësisht se vlerësohet si storie më e suksesshme e pasluftës, akoma nuk ka arritur shkallën e maturitetit dhe të krahasohet me sektorët e vendeve që kanë histori qindrvjeçare të funksionimit të tyre.

Ajo çka dua të theksoj është se, pavarësisht që kjo ka ndodhur, se kjo që ka ndodhur është e rëndë dhe ka cenuar imazhin pozitiv të Policisë së Kosovës dhe të sektorit të sigurisë, në përgjithësi, nuk duhet të jetë si shkas për të neglizhuar sukseset e këtij sektori deri më tash.

Krahas formimit, forcimit dhe funksionalitetit të institucioneve, në përgjithësi, po forcohet edhe sektori i sigurisë. Kjo, pa dyshim, e shqetëson botën e krimit, të cilëve gradualisht po u ngushtohet hapësira e veprimit.

Unë inkurajoj Qeverinë, në përgjithësi, dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, në veçanti, që të vazhdojë ngushtimin e hapësirës së krimit, duke qenë të pa kompromis në luftë kundër krimit të organizuar dhe dukurive tjera devijante në shoqërinë tonë dhe të stimulojë sektorin e sigurisë duke i krijuar mbrojtje ligjore edhe atëherë kur përdoret dhuna legjitime, gjë që nuk e kanë sot gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre si polici e Kosovës.

Nisur nga rezultatet pozitive të policisë, mund të konkludohet se Qeveria po e nxitë dhe rritë efikasitetin e vet edhe në sektorin e sigurisë, si në çdo dikaster tjetër qeveritar, prandaj përgjegjësia dhe llogaria e atyre që janë të involvuar dhe të ndihmësve të tyre, në

rastin në fjalë, do të vjen në pah dhe jam i sigurt se do të vijë vetëm atëherë kur do të zihet lepuri, e lepuri do të zihet.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Selmanaj, le të përgatitet deputetja Njomza Emini.

IBRAHIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër,

U bë debat i gjerë rreth zhvillimeve të fundit, edhe pse kaluan dy muaj, por unë do ta falënderoj kryetarin e Komisionit për Siguri, anëtar i të cilit komision jam edhe unë dhe, sikur me shkas rrëshqiti debati, nuk u trajtua tema dhe problemi për të cilin edhe jemi sot, jemi tubuar, ndoshta pajtohem me profesorin se është dashur të jetë pa media, do të ishte pak më mirë. Më vret një fakt me paragjykimet e disa prej deputetëve këtu, që po flasin. Jemi dëshmitarë të qindra akuzave dhe të vuajtjes së dënimeve të njerëzve pas luftës, deri edhe në Gjykatën Ndërkombëtare, por që kanë dalë të pafajshëm, po në një kohë janë ngritur akuza të fshehta, ndërsa sot po dalin edhe publikisht, kanë guxim edhe të flasin dhe të paragjykojnë.

Populli e thotë një fjalë: “mazdraki në thes nuk hyn”. Janë vjedhur, është thye dhoma e hetimeve, dhoma që është dashur të jetë më e ruajtura dhe të jeni të bindur se nuk i jemi gëzuar këtij fakti, sikur nuk i gëzohemi edhe tash, por debati duhet të shkojë deri atje sa institucionin e Policisë, i cili ka filluar degradimin gati një vit e gjysmë, largimi i sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Rendit, ka kushtuar në zhvillimet në strukturë të vet këtij mekanizmi. Një prej kolegeve deputete, e përmendi hajnin në shtëpinë e Kryeministrit. Krejt çka ka ndodhur, është largimi i zëdhënësit të policisë. Është e njëjta situatë, alarmi për bombë të rrejtshme dhe përderisa evakuohet stafi i Qeverisë së Kosovës, Kryeministri i Kosovës thotë se pushteti nuk merret me bomba e plumba, por pushteti fitohet me votë. Po çka kishte aty te plumbat dhe bombat? Kjo nuk është temë e cila bisedohet nga niveli më i lartë dhe niveli i parë i Qeverisë. Është e njëjta situatë me vajin sulfurik. Çka ndodhi, alarm i madh, fjalë të shumta dhe ndodhë përfundimi. Shkarkohet komandanti i doganave ose shefi i Doganave dhe sekretari i Ministrisë së Përhershme, shefi kthehet, sekretari largohet përgjithmonë dhe, tutje, sot dëgjojmë nga ministri se dihet personi i cili ka bërë tregti me vajin dhe tema tjera nuk ka.

Do të ishte tepër me rëndësi ta dimë emrin e tij, sepse në këtë Parlament prapë është akuzuar pa të drejtë dikush politikisht, pikërisht këtu. Çka duhet të bëjmë në vazhdimësi, në vijim? Ta mbështesim Komisionin dhe qëndrimet e Komisionit për Siguri dhe të ndërtojmë kapacitete dhe ta kthejmë besimin te Policia e Kosovës. Kjo është shumë me rëndësi që debati të orientohej drejt dhe të preken temat të cilat janë të rënda për qytetarin e Kosovës, të respektohet Kushtetuta e vendit, Kushtetutë për të cilin flasim shumë dhe 30% e territorit të Kosovës nuk administrohet nga kjo Qeveri, nga ky mekanizëm dhe nga ky Kuvend. Këto janë probleme të thella dhe, në fund të fundit, e vërteta është kjo: Nuk është bërë kiameti se në Amerikën Latine me tona zhduket sasia e drogës, nuk kanë për t’u ndalur asnjëherë këto probleme, por e mira është të merremi, ta kemi preventivën, e jo të merremi me pasojat, sepse po bisedojmë dy muaj pasi që ka ndodhur rasti dhe nuk kemi asnjë afat kohor dhe sot nuk e dimë saktë se deri ku, çka mundemi t’i ofrojmë qytetarit tonë për një të ardhme më të mirë. E vërteta është se po humbet besimi te ky mekanizëm i ngritur me shumë mund, mekanizëm shumë i besueshëm dhe duhet të ndërrohet në koncept.

Unë e mbështes kryetarin e Komisionit dhe jam i gatshëm për bashkëpunim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka Njomza Emini, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni.

NJOMZA EMINI: Ju faleminderit, kryesues!

Së pari, shpreh keqardhje që nuk është Kryeministri, duke e ditur që kjo që ka ndodhur në Kosovë, është një ngjarje skandaloze që vetëm ndodhë nëpër filma, nëpër xhirime që bëhen dhe dikush duhet të japë përgjegjësi dhe, po ashtu, unë shpreh keqardhje për disa diskutues që këto, kur të është një ngjarje që duhet të debatohet dhe ka nevojë për t'u trajtuar ashtu se në të cilat mënyra do të mundemi t'i adresojmë edhe te gjejmë përgjegjësin e kësaj vjedhjeje që ka ndodhur në dhomën e dëshmive, kjo është me të vërtetë shqetësuese, jo vetëm për ne deputetët këtu që jemi, por edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, duke e ditur që për çdo lëvdatë, Shërbimi Policor i Kosovës ka bërë një punë të madhe që nga fillimi e deri tash, do të thotë, dhe unë personalisht mendoj që me këtë informatë që ka ardhur këtu, kjo informatë që ka ardhur këtu, i kam dëgjuar edhe nëpër media dhe kurrëgjë diçka nuk ka ardhur këtu në mënyrë detaje se kush janë përgjegjësit dhe si ka ndodhur kjo ngjarje deri këtu.

Unë mendoj që kjo nuk ka ndodhur për një ditë, këtu është dashur para asaj dite, do të thotë, është bërë planifikimi se si të shkohet në dhomën e dëshmive, duke e ditur që ato dyer kanë një kod, do të thotë e ka pasur dikush kodin dhe që ka mundur të hyjë me forcë, qysh edhe këtu e keni shkruar që me forcë kanë hyrë dhe në dhomën e dëshmive. Po ashtu, do të thotë, nga këto që po i shoh në bazë të regjistratit të evidencave të ruajtura nga policia, që janë konstatuar që janë vjedhur, unë i shtroj pyetjen ministrit konkret, do të thotë, pse prej vitit 2004, a e dini pse nuk janë, faktikisht nuk janë substancat narkotike, pse ka ekzistuar prej vitit 2004 dhe pse nuk është asgjësuar kjo lëndë narkotike dhe nuk është zhvilluar procedurë për këtë çështje.

Edhe një herë nëpër çdo vend demokratik që ka rregulla dhe sundimi i ligjit duhet të jetë, Qeveria është proklamuar dhe ju si ministri për zero tolerancë, do të thotë, kundër krimit të organizuar dhe pretendojmë që të shkojmë në familjen e madhe evropiane, duke e ditur që tash jemi para studimit të fizibilitetit, do të thotë, do të dalë shumë shpejt raporti i progresit dhe njëra prej sfidave më të mëdha dhe njëra prej kurseve apo kritereve që duhen që së paku të pretendojmë të hyjmë në familjen e madhe evropiane, kjo lërë që na bën pengesë, por edhe ne nuk jemi të sigurt si vend, duke e ditur që jemi një vjet e sa shtet sovran dhe thirrëmi në atë që ne jemi për sundimin e ligjit.

Edhe njëherë shpreh keqardhje, po them, personalisht, unë edhe qytetarët, duke e ditur që duhet të ketë siguri, ata nuk ndihen të sigurt, lërë se, do të thotë, ndonjë provë që duhet të shkojnë dhe t'i adresojnë te organi më i lartë që është, që ata duhet ta mbrojnë qytetarët, kjo ndodhë e kundërta. Unë mendoj që Komisioni funksional që është në Kuvendin e Republikës së Kosovës për Siguri, me rekomandimet që kanë dalë dhe që kanë diskutuar, do të thotë nëpër mbledhjet e tyre, që kanë parë të arsyeshme se çka duhet ndërmarrë, do të kisha sugjeruar që para se të vinte kjo informatë, ne t'i kishim rekomandimet këtu dhe të dal në votim dhe të shohim se dikush është përgjegjës për këtë. Nuk ka ndodhur ajo rastësisht, dikush duhet të japë llogari dhe përgjegjësi për krejt këto që kanë ndodhur, sepse nuk është një vjedhje e lehtë, por është në dhomën e dëshmive, aty ka qenë ajo që është dora e parë ku janë ruajtur dëshmitë.

Edhe njëherë, unë rekomandoj dhe sugjeroj që këto le të dalin në votim rekomandimet dhe le të japë dikush përgjegjësi, sepse duhet të japë, duhet të japë dikush llogari për krejt këto që kanë ndodhur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Vazhdojmë me deputetin e radhës, Hydajet Hyseni, le të përgatitet deputeti Hajdin Abazi.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që duke ju përshëndetur të gjithëve, të përshëndes këtë debat, të përshëndes edhe nismën e Komisionit. E konsideroj krejt të natyrshme, krejt normale pas asaj që ka ndodhur. Për mua nuk ka ndodhur vetëm një incident, por është diçka më shumë, është edhe dështim i policisë dhe kjo duhet thënë me plotë gojë.

Krimi gjithmonë duhet të dënohet, por kur vidhet policia dhe kur vidhet në polici, atëherë vidhet e gjithë shoqëria. Prandaj, për mendimin tim, është krejt e natyrshme që të reagojë shoqëria, që të reagojnë edhe institucionet e shoqërisë, edhe ky kuvend.

Lufta antikrim me të drejtë është vlerësuar si çështje prioritare, si prioritet i të gjitha prioriteteve dhe ky debat do duhej të ishte në funksion të këtij disponimi, një mobilizimi dhe përkushtimi të përgjithshëm kundër krimit, i duhet kjo Kosovës dhe mendoj që efektet do të ishin pozitive vetëm nëse e kthejmë në një lëvizje të tillë kundër krimit, kundër atyre që e mundësojnë ose e lejojnë krimin.

Por, më lejoni që të jem i drejtpërdrejtë, nuk besoj që i kontribuojnë kësaj fryme disa tone politizuese, profitore, pokitikaneske, e tjera. Përkundrazi, ato e minojnë. Nuk besoj, ta zëmë, se janë përgjigje adekuate përpjekjet për të denigruar gjithë policinë e Kosovës edhe përkundër bindjes së përgjithshme edhe të analitikëve, edhe të raportuesve se ajo ka pasur, siç u tha, performancën më të suksesshme, kurse këtu ne dëgjojmë ndonjëherë për rënie të performancës, kurse krejt puna paska qenë a ka rënë apo nuk ka rënë performanca, është diçka shumë më serioze se sa çështje performace ose u dashka të trajnohen policët.

Zonja e zotërinj, ata që e kanë bërë këtë, ata kanë qenë shumë të trajnuar. Çështja është që duhet të krijohen instrumente që e parandalojnë atë çka ka ndodhur ose se ministri dhe kryeministri nuk qenkan mërzitur shumë, përndryshe do të ishte zbuluar rasti! Nuk zbulohet rasti me mërzi ose mosmërzi të ministrave dhe të kryeministrit. Ose sugjerimet nganjëherë për të kthyer kuadrot e vjetra ose mendësitë e raportet e vjetra midis ministrive dhe policisë. Nuk kthehen ato, funksionojnë në kohë moderne dhe duhet të zbatojnë praktika moderne. Ose edhe alarmimet se me këtë ne po e dëmtojmë procesin e integriteteve në Evropë, se ata që vjedhin shtëpinë e vet nuk mund të jenë pjesë e familjes evropiane, e tjera. Nuk shtrohen çështjet kështu, se s'do t'i bindim ata që kanë vjedhur të mos vjedhin, sepse ndryshe nuk do të na pranojnë në Evropë, apo jo! Dhe, sidomos jo me konfrontime, animozitete në baza partiake regjionale, sidomos midis atyre që janë të një brumi, deshën apo nuk deshën, kanë një të kaluar, kanë një gjakim, kanë edhe shumë çka të përbashkët. Në luftë me të vëllanë, thonë, sido që ndahesh, i humbur je. Unë apeloj që ne t'i ulim gjakrat, të kthehemi anë atë që është kryesorja dhe në këtë kryesorja është se na ka ndodhur një diversion, diversion në vend shumë të ndjeshëm, në polici, edhe atje madje në një vend veçanërisht të ruajtur. Por, ju lutem, a ka ndodhur vetëm te ne kjo? Ka ndodhur edhe në vendet më të organizuara, ka ndodhur

dhe janë marrë masat adekuate, por nuk është synuar të destabilizohet tash edhe qeverisja, edhe ministritë, edhe policia për shkak se paska ndodhur një diversion. Diversionet janë çështje kryesisht të grupeve të vockla, grupet e vockla gjithkund mund të depërtojnë, prandaj nuk shkojnë përgjithësimet dhe nuk shkojnë diversionet politike për shkak të një diversionit kriminal.

Unë jam i vetëdijshëm se këtu përgjegjësi ka dhe ka vend për përgjegjësi, por përgjegjësia duhet të vendoset aty ku është dhe, siç u tha, në sistemin që ne e kemi ndërtuar vetë me ligjet që kemi miratuar, përgjegjësia për këtë diversion ndodhet në zinxhirin komandues të policisë. Unë jam nga ata që pres që këtu të funksionojë ndërgjegjja e drejtuesve të policisë dhe ajo të vijë në shprehje edhe me aktet që priten me të drejtë prej tyre.

Dhe, mendoj që ne na takon të krijojmë klimën e përshtatshme për ta parandaluar krimin, për të mbështetur forcat që luftojnë kundër krimit dhe të dëshmojmë se nuk lejojmë të biem në grackën që, për shkak të një rasti që ka ndodhur, t'i përbaltim të gjithë të tjerët. Ka një maksimum të lashtë në drejtësi: “Më mirë është që...”

(KRYESUESI: t'i zgjatet fjala edhe për një minutë ju lutem!)

...asnjë minutë ju lutem, tash është maksima vetëm që “Më mirë është njëqind fajtor të mbetën të pa ndëshkuar, sesa të ndëshkohet një i pafajshëm”. Ndëshkimi moral me akuza që po dëgjohen këtu, është më i rëndë se çdo ndëshkim penal. Prandaj, kujdes, ju lutem! Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi, në vazhdim le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi.

HAJDIN ABAZI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Zoti ministër,

Informata që po e shqyrtojmë sot, vërtet është brengosëse dhe jam i bindur se askush nga ne që jemi këtu, po asnjë njeri i ndërgjegjshëm nuk do të kishte pasur dëshirë të ndodhë. Mirëpo, krimi është ai i cili vepron dhe pikërisht do të godas aty ku ndoshta është një pritje më e madhe, ku janë dhënë edhe vlerësimet më pozitive. Por, përderisa informata ishte e përmbajtur dhe e ekuilibruar, sepse procesi dhe hetimet po vazhdojnë, unë këtu kur e dëgjova një pjesë të debatit, pyesja veten, cila është vetëdija shtetërore e jona? A jemi të vetëdijshëm ne që po bisedojmë dhe po shqyrtojmë për një akt që ka ndodhur dhe që është ende në procedurë apo jo dhe, po të kishim vetëdije tamam shtetërore, ne do të duhej të prisnim që të vazhdojë kjo procedurë, të priten rezultatet dhe pastaj në bazë të vlerësimeve të kërkojmë edhe hierarkinë e përgjegjësisë dhe jo të prejjudikojmë.

Në këtë frymë, unë kam pritur që diskutimi i sotëm këtu do të jetë i tillë që do ta inkurajojë Ministrinë e Brendshme, do t'i japë mbështetje dhe përkrahje që edhe më me vendosmëri ta çojë përpara luftën kundër krimit, në përgjithësi, dhe krimit të organizuar, në veçanti.

Për fat të keq, shumë të pakta ishin këto inkurajime sot, që u dëgjuan nga ne këtu. Përkundrazi, ajo çfarë dëgjuam ishin insinuata kundrejt Qeverisë, kundrejt Kryeministrit,

kundrejt ministrit e të tjera. Kishte edhe aspekte të diskreditimit të segmenteve që përbëjnë një rën prej shtyllave të sigurisë të të gjithë neve dhe, ndoshta, kjo po ndodhë pikërisht në momentin kur prej Policisë ne po kërkojmë profesionalizëm, por nuk kemi ulur asnjëherë ta debatohet se çfarë kushtesh ju kemi ofruar.

Policia e krimit e cila për çdo rast e rrezikon jetën e vet, por edhe pjesa tjetër e policisë, kanë paga që vërtet që janë brengosëse dhe ne do të duhej ndoshta këtu të angazhoheshim se si ta përmirësojmë, si ta shtojmë motivimin e tyre dhe ata që po punojnë me vendosmëri sot në policinë e Kosovës, për mua ata janë duke punuar më tepër sepse e duan shtetin tonë të ri, sepse e duan atdheun tonë, sepse e duan popullin tonë dhe jo për shkak të pagave dhe benifiteve që i kanë. Duke qenë se kërkohet edhe për një rast kë të tillë të bie në njëfarë mënyre edhe Qeveria, do të thotë se kur kërkohet përgjegjësia e Kryeministri, kuptohet që edhe e Qeverisë, kjo do ta destabilizonte vendin, me të vërtetë është një papjekuri këtu e një pjesëve të diskutuesve që vetëm duan ta bëjnë gjendjen llugë dhe mezi që presin gjithçka për të dhënë goditje të ulëta nën brez sikur që quhen në boks. Reformat në polici janë duke u bërë dhe, zoti ministër, personalisht ju inkurajoj që t'i vazhdoni ato, t'i vazhdoni me vendosmëri dhe ta përforconi më tepër Policinë e Kosovës, sepse përforcimi i policisë është rritje e sigurisë sonë. Por këtu del në pah edhe për të satën herë një pengesë tjetër, ajo e Gjyqësorit. Do të thotë, janë arrestuar njerëzit dhe, nëse për asgjë tjetër, të paktën për shkak se i kanë rezistuar policisë për arrestim do të ishte dashur të mbaheshin në burg dhe janë liruar.

Ne kemi pasur edhe Agjensionin kundër Korrupsion që tregon se njerëz me padi, me fakte janë liruar nga Gjyqësori. Konsideroj se ndoshta po vjen koha kur ne, si Kuvend, duhet ta shtrojmë çështjen se çfarë duhet të bëjmë me Gjyqësorin, si duhet ta rregullojmë Ligjin dhe çka duhet të reformojë që Gjyqësori të jetë më efikas.

Zoti ministër, vazhdoni me përkushtim që të korrni sukses, ta luftoni pa kompromis krimin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi, le të përgatitet Bahri Hyseni, diskutuesi i fundit.

MARK KRASNIQI: I nderuar, kryetar!

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Tema me të cilën sot po merremi është debatuar edhe në opinionin publik, edhe në mjetet e informimit për sa kohë. Mjetet e informimit si dihet, na informojnë, nganjëherë edhe na dezinformojnë. Prandaj, raportin e ministrit e kemi pritur me padurim që të na informojë ashtu si duhet dhe të marrin me qëndrimet tona dhe të informohemi, më në fund, në mos kurrë tjetër.

Po më duket se ky raport që e ka dhënë ministri, mirë ka bërë që e ka dhënë këtë, por është i mangët, është trajtuar vetëm vjedhja e drogave, kurse në opinion është interesimi shumë më i madh për vjedhjen e dëshmimeve, të dokumenteve. Ju nuk e keni përmendur fare këtë pjesën tjetër të krimit që është bërë në polici, në ndërtesën e policisë. Prandaj, është dashur ndoshta vetëm ta dimë, nuk po them se duhet ta dimë emër për emër sepse dëmtohen atëherë hetimet, por të paktën çfarë detyre kanë këto dëshmi, a është po mendoj organizatë antishtetërore apo lloj vjedhjeje e madhe apo diçka tjetër, kështu që i

mbeteni ju borxh këtij Parlamenti të na informoni pak edhe për këtë pjesën tjetër të këtij krimi që është bërë në polici.

Policia kudo është shtylla, një nga shtyllat kryesore të shtetit. Ajo garanton gjithçka dhe garanton zbatimin e ligjeve, mandej garanton sigurimin e qytetarëve. Me këtë ngjarje që ka ndodhur këtu në qendër të policisë, mendoj se një pjesë e madhe e popullsisë sonë pak bile edhe është dëmtuar, sepse ka humbur deri diku besimi aty ku duhet ta ketë gjithmonë më të fortë, do me thënë në organet e sigurisë.

Policia, para së gjithash, na duhet se jemi në formim e sipër. Po se patëm shtetin të fortë, atëherë ma mirë mos të përpiqemi që të bëjmë diçka. Policia duhet të jetë para së gjithash e përgatitur në mënyrë profesionale si duhet, mandej të ketë kompetenca të cilat sot nuk i ka. Policia sot ka pak a shumë vetëm konstatimin e ngjarjes, pastaj e bën një referat për këtë prokurorin dhe me aq mbaron puna. Por, në disa raste i ka edhe duart e lira. Mandej, policia duhet të veprojë në atë mënyrë sa që ta përfitojë popullin, se kur e përfiton simpatinë e popullit, atëherë po e fiton edhe përkrahjen e saj.

Në Evropë, në shtetet që kanë një histori shtetërore, qytetarët janë njëkohësisht edhe policë, policë jo zyrtar, por polic me ndërgjegje. Për shembull, si është në Zvicër. Prandaj, po them është më se e nevojshme përkrahja e popullit dhe e policisë që ta ketë punën më të suksesshme. Mendoj se ky akt i shëmtuar që është bërë në polici, dëmton edhe ekonominë e Kosovës, sepse investitorët e mundshëm tash do ta prekin ballin, a ka leverdi të vijë këtu në një vend ku nuk ka siguri. Pa siguri nuk të vjen askush, edhe pa rrymë pa ndërprerje nuk do të kemi investitorë. Po, mendoj, këto dy elementet më të domosdoshme për jetën normale edhe për tërheqjen e investitorëve, duhet të sigurohen sa më parë. Ju faleminderit, Kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit, shumë deputet!

Fjala është për deputetin e parafundit, Bahri Hyseni, le të përgatitet anëtari i Kryesisë dhe deputeti Sabri Hamiti.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëendetje, të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Jemi në fund të debatit dhe do ta kem vështirë, sepse shumica e diskutimeve që u bënë nga deputetët, ishin me vend dhe besoj që asnjë deputetë dhe asnjë qytetarë i Kosovës nuk iu ka gëzuar faktit, kur në institucionin i cili është obligativ për kujdesin e të gjitha institucioneve, të jetës së qytetarëve dhe të familjeve tona, ndodhë një krim, siç u përmend deri me tani. Por, besoj që nuk është në interesin e asnjë subjekti politik, të asnjë deputeti të Parlamentit të Kosovës, që për qëllime politike apo me qëllim të fitimit diçka nga kjo që ka ndodhë, të ngrehim çështjet dhe t'i vendosim apo t'i zhvendosim në drejtime të ndryshme.

Nuk është në interes të cilitdo subjekt politik që ne sot të mos e kemi një polici profesionale, një polici të reformuar, një polici e cila do të ishte më efikase dhe një polici e cila, në fund të fundit, kujdeset për sigurinë e të gjithëve neve. Nuk dua të aludojmë sot që krimi që ka ndodhur, ka ndodhur pikërisht nga policia. Është e vërtetë që ka ndodhur në vendin ku nuk do të duhej të ndodhte. Mirëpo, është shumë me keqardhje, nëse ne aludojmë që sot Policia e Kosovës e kanë kryer. Unë besoj që ka qenë një neglizhencë dhe askush nuk po e mbron përgjegjësinë e policisë, sepse përderisa krijohet situata që

dikush të vjedhë në polici, çka bëjmë ne të tjerët, është shumë e vërtetë, por është mirë tash të mos aludojmë se ndoshta vetë policia e ka bërë krimin për të cilin po bisedojmë.

U tentua para deputetëve të sqarohet apo të thuhet se krimi po instalohet, dhe ai është instaluar. Jo, krim në Kosovë ka pasur prej vitit '99, ka pasur vjedhje prej vitit '99, nuk po ndalem tash para vitit '99, krim mund të ndodhë që do të ketë edhe në vitin 2010, sepse këto janë të mundshme dhe ndodhin në çdo vend, kudo edhe në vendet më demokratike në botë. Prandaj, është mirë që mos të dalim me deklarata që sot është instaluar krimi.

Ne i kemi disa rezultate që po i shohim. Po, më duket që ka qenë një angazhim i madh i Qeverisë dhe i Policisë, në veçanti, me këtë status që e kanë, me këto paga që i kanë, me këtë siguri që e kanë, sepse vdesin në detyrë dhe askush nuk ua siguron mjetet edhe për varrim, e nuk po flasim që familjet e tyre nuk marrin as pension, asnjë të ardhur, kanë bërë përpjekje ta luftojnë krimin aq sa kanë pasur mundësi, por nuk do të thotë që në mesin e policisë nuk kemi njerëz të cilët i kanë ndihmuar edhe krimin, siç ndodhë në të gjitha institucionet. Prandaj, do të ishte mirë që të angazhohemi të gjithë, që t'i ndihmojmë Institucionit të Policisë që, natyrisht, bashkë me ne, me institucionet e tjera, të bëjmë një luftë pa kompromis për të gjithë ata të cilët gjenden në krim apo bëjnë situata për të krijuar situatën çfarë ka ndodhur dhe kjo e fundit.

Është shumë diskutabile ajo, është mirë ta lexojmë nga pak edhe ligjin, a ka të drejtë të formojë task-forcë apo nuk ka të drejtë. Po, ka të drejtë task-forcë të formojë në çdo moment dhe nuk është konflikt interesi, brenda një institucioni kur flitet për hetime, duhet pikërisht të jenë njerëzit që janë brenda institucionit. Po flasim për hetime dhe nuk është mos zbatim i ligjit, bile nëse kërkojmë ne ta respektojmë sundimin e ligjit, unë po e përgëzoj ministrin që nuk ka marrë obligim të futet në operative atje, sepse ligji e ndalon, çështjen e hetimeve ligji ia ndalon. Ne kërkojmë nga ministri të menaxhojë, t'i krijojë politikat e qarta, të marrë masa, masa për të gjithë ata të cilët janë fajtor dhe mos t'i mbulojë, por natyrisht nuk është detyrë e ministrit dhe e askujt prej nesh të futet në operative dhe tash të...

KRYETARI: Ju faleminderit!

I fundit për debat, fjalën e ka Sabri Hamiti prej deputetëve.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Zotërinj deputetë të Republikës së Kosovës,

Zotërinj ministra, po ju jeni kryesorët, se ju e mbani sigurinë e Kosovës.

Diskutimi i sotëm ka qenë një interes shtetëror dhe një interes publik. Unë mendoj se Kryesia e Kuvendit, me iniciativë të Komisionit për Punë të Brendshme të Kuvendit, ka bërë shumë mirë që këtë temë e ka sjellë në bankat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Natyrisht, perceptimet e njerëzve dhe diskutimet e tyre janë ato që janë dhe sekush i ka idetë e veta dhe, definitivisht, mund të them që është bërë një diskutim i lirë i të gjithëve që ta thonë atë çka kanë të thonë dhe kjo është me rëndësi. Unë për vete i kam dëgjuar të gjithë, prej të parit deri të fundit, çdo fjalë, por megjithatë nuk kam ndërruar asgjë nga ideja fillestare që kisha të them për këtë problem.

Nën një, unë e përgëzoj ministrin që ka ardhur të japë një informatë, si detyrë që e ka para Parlamentit, por një të njëjtën kohë them që informata e tij është tepër e shkurtër,

e vogël, e pasupstancë gati e parëndësishme për një debat të tillë. Ne kemi pritur një informatë shumë më të thelluar edhe në kuptimin politik, edhe në kuptimin menaxherial dhe kërkimor deri në fazën e tashme. Unë e di që mund ta ketë në buzë dhe në gojë përgjigjen e menjëhershme, jo po do të preken hetimet, jo, jo, është mirë gjithmonë që në Parlament të flitet më së thelli për problemet, aq as mund të flitet publikisht, dhe unë po ju them që, nëse mblidhen deklaratat edhe të organeve rreth Ministrisë dhe të organeve përfaqësuese të Kuvendit, më shumë kemi pasur detaje, deklarime publike dhjetë herë se sa që sublimohen në informatën që është në këtë rast zyrtare. Prandaj, unë mbaj këtë qëndrim që informata është totalisht e paplotë. E thashë që interesi për diskutim është edhe publik, edhe shtetëror. Ka ndodhur një ngjarje që ka krijuar një tronditje publike, ka ndodhur një ngjarje që është testuar, unë do të thosha, fort problemi i veprimit të shtetit të ne, i shtetit ligjor. Pse? Ka ndodhur një vjedhje që është e sojit të veçantë, ka ndodhur një vjedhje e dëshmive të krimit dhe ne sot, si Kuvend, Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Policia e Kosovës është në një sprovë shumë të rëndë. A ka vullnet politik dhe a ka përgjegjësi institucionale në Kosovë, nisur nga Kuvendi, në Qeveri dhe në ministri përkatëse, që të luftohet krimi? Zotërinj, ne jemi në sprovë. Nëse ne e japim vullnetin politik, përgjegjësinë institucionale që të luftohet krimi në Kosovë, ne jo që e dobësojmë sigurinë në Kosovë, ne e fitojmë sigurinë. Nëse zbulohen thyesit e asaj dhome, Kosova fiton dhe Shërbimi i dikurshëm Policor i Kosovës, që thonë tash Policia e Kosovës, bëhet organizatë më e besueshme. Pse më e besueshme? Ne nuk mund ta luajmë njeriun që s'i kupton problemet. Nuk është që është prishur imazhi i Kosovës, është diçka më shumë. Është krijuar pasiguri, perceptimi popullor, perceptimi i njeriut zakonshëm, perceptimi i një përfaqësuesi publik dhe i një njeriu zgjedhës sikurse jemi ne, është sepse është krijuar dyshimi në siguri. Perceptimi, unë vetë e kam thanë në këtë foltore, shpeshherë po e them edhe sot, nuk është e vërteta, po është ajo çka mendojnë qytetarët për një problem dhe kjo nuk është punë e vogël. Prandaj, dy muaj kanë kaluar, ne nuk kemi absolutisht kurrfarë të dhëne çfarë kanë ndodhur me hetimet rreth këtij rasti, kurrgjë nuk dimë ne, pos përsëkrimeve elementare që do të bëhen hetimet e thelluara, hetimet e rëndësishme, transparente e tjera. Janë shumë dy muaj dhe unë kërkoj që ky hetim, duke u pas shoqëruar, edhe një herë po them, me atë që quhet përgjegjësi institucionale dhe vullneti politik për luftimin e krimit, është momenti që kjo të intensifikohet.

Kemi shenja atje që do të angazhohen këtu edhe forca tjera të hetimeve, siç është EULEX-i, mirëpo unë mendoj që forcat e brendshme të Kosovës duhet ta dëshmojnë veten tash, tash me vetveten, tash me ligjin, tash me ndodhinë, tash me spastrimin e brendshëm. Përgjegjësitë le ti marrë sekush ato që i ka. Unë nuk hy në histori, bile mua më duket pak qesharake të krijohen historitë, jo filan njeri ka pas qenë i vendosur më herët, më vonë, është i biri i këtij, është i krahinës, pa krahinës. Nuk ka lidhje, këtu njerëzit kanë funksione, këtu njerëzit kanë përgjegjësi në bazë të ligjit, le ta ushtrojnë përgjegjësinë para ligjit, as më pak, as më shumë, çka më duhen biografitë e tyre ose që sa muaj e kryejnë punën.

Edhe një problem tjetër. Mënyra e përcjelljes së këtyre dokumenteve, zotëri ministër, edhe zotërinjtë njerëzit që i përcjellin. Njëri këtu e tha më herët që dokumenti në një letër quhet raport në një informatë. Ka shumë të drejtë, se ashtu është. Unë kam gjetur këtu edhe një formulim dhe kjo për ministrin dhe për Qeverinë, që teksti na përcillet me një, dëgjoni mirë, shqip çka thotë kjo. Letra përcillet me këtë fjali: "Ju dërgojmë informatën për vjedhjen në dhomën e dëshmive të Policisë së Kosovës, të përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme". Zonja dhe zotërinj, shqip, shqip kjo thotë që Ministria i ka përgatitur vjedhjet. Mos shkruani kështu shqip, mësohuni të shkruani shqip, ose s'e besoj

që e keni bërë me qëllim. Ky formulim kështu, ky është, merreni letrën, këqyreni! Pse po them? Po them se po dëgjoj pasaktësi në shprehjet që janë substanciale, në vend “përgjegjësi”, “përgjegjës”, në vend të “papërgjegjësisë”, “jopërgjegjës”, do të thotë kemi formulime të cilat krijojnë atë që quhen zhurmë në komunikim edhe njeriu po thotë, unë po e hetoj po thotë atë që s’pe mendon hiq. Këtu kemi të bëjmë me probleme serioze.

Do ta përfundoj, zoti Kryetar, edhe një herë me thirrjen që është momenti që institucionet e Kosovës ta prodhojnë vullnetin e vet se janë kundër krimit, të gjitha me rend, aq sa ju takon në bazë të funksioneve kushtetuese. Edhe ai regjistër të tregohet definitivisht çka ka pasur. Për mua qesharake, atje është një evidentim, thotë është marrë edhe një çantë thatë, sigurisht i kanë shti sendet në çantë, a çka ju ka dashur ajo. Po, është qesharake kur thuhet ajo, gjithë ai precizim, është edhe një çantë thatë, është marrë në atë dhomë. Problemi është, zotëri, a janë droga, a janë para. Problemi është se janë vjedhur dëshmitë e krimit. Situata është shumë serioze dhe ne seriozitetin institucional do ta dëshmojmë, tashti meqë kanë dëshirë të thonë edhe para botës, por unë them pa vetvetes dhe opinionit tonë, dhe qytetarëve tanë, duke e luftuar dhe duke e zbuluar krimin më së mirë është të parandalohet, por s’ka shoqëri që i parandalon të gjitha veprat kriminale, por shoqëri të vërteta janë ato që i zbulojnë edhe i qesin para drejtësisë. Kosova ka shansin ta bëjë këtë dhe unë mendoj që ia ka vlerë ky diskutim në Parlamentin e Kosovës, pa marrë parasysh mënyrat e artikulimit, sepse Parlamenti sot bëni, nuk bëni, në kuptimin formal rekomandime, ka dhënë rekomandime publike që ajo është krim dhe ai duhet të zbulohet dhe Kosova duhet ta ketë vullnetin politik e institucional t’i parandalojë ose t’i dënojë krimet. Faleminderit, zotëri!

KRYETARI: Faleminderit! zoti ministër ke fjalën përmbyllëse.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj që jo me shumë fjalë, të mos marrë, ky debat ka ndikuar dhe ka reflektuar pozitivisht në angazhimin dhe shtrimin e angazhimit tonë që t’i ndihmojmë organet e policisë, të hetuesisë që në mënyrë sa më të shpejtë, sa më dinamike ta intensifikojnë procesin e hetimit dhe po ashtu t’i inkurajojmë edhe partnerët tjerë, po ashtu edhe drejtësinë që të na ndihmojnë në zbardhjen sa më të shpejtë të këtij rasti.

Fatkeqësisht, sot nuk ju kam sjellë më shumë informata, informatat i kam konsideruar të tilla që e dëmtojnë procesin e hetimit, por ju siguroj që ju kam sjellë një gatishmëri personale dhe të Qeverisë për të vazhduar deri në fund të hetohet rasti dhe të hetohet jo vetëm ky rast, por edhe rastet tjera dhe të luftohet krimin në përgjithësi.

Po ju siguroj që Policia e Kosovës po vazhdon në hetimin dhe luftimin e krimit në Kosovë. Vetëm sot deri sa jemi këtu, është kah vazhdon një operacion i policisë dhe është kapur një sasi e drogës në qytetin e Prizrenit.

Më lejoni t’ju them që ndoshta do të mund të ishte një informatë që kam menduar që mund t’ju lodhte ju, për masat që i kemi marrë në drejtim të sanimit ose të reflektimit pas rastit që ka ndodhur në polici. Objektet janë në gjendje të vështirë, edhe ky objekt në të cilin janë provat, është një objekt ku është edhe prokuroria, është kah bëhet një objekt i ri për policinë dhe jam i sigurt që dhoma e provave do të jetë në vend të sigurt dhe, po ashtu, jam i sigurt që do të reflektojnë edhe organet e drejtësisë për sigurinë e provave.

Po ashtu, dëshiroj t'ju them që, siç e dini, krimin e organizuar në Kosovë e ka menaxhuar UNMIK-u. E dini, po ashtu, që ka një numër të madh të lëndëve dhe provave të cilat janë siguruar nga Policia e Kosovës, atëherë Shërbimi Policor i Kosovës, dhe të cilat kanë qenë të menaxhuara nga hetues të UNMIK-ut. Një numër i madh i këtyre tani janë bartur te EULEX-i. Ju siguroj që po punojmë në partneritet të ngushtë me misionin e sundimit të ligjit të BE-së, të cilët janë të përkushtuar të na mbështesin në luftimin e krimit në Kosovë. Jam i sigurt që ky bashkëpunim dhe kjo mbështetje do të jetë e rëndësishme për ne, pa hequr dhe pa mënjanuar asnjëherë idenë se përgjegjësia kryesore qëndron mbi organet tona edhe të ndjekjes, edhe të drejtësisë në përgjegjësi.

Duhet ta dini që ka edhe pakënaqësi në këtë proces. Ne nuk mund t'i evitonim dhe nuk do të mund t'i evitojmë të gjitha dobësitë ose mangësitë që i kemi gjetur, një proces që ka qenë i gjatë, një sistem i krijuar me mbështetjen ndërkombëtare, shpeshherë me praktika të ndryshme nga vende të ndryshme dhe shpeshherë edhe me mungesa të kapaciteteve tona të menaxhimit.

Po ju siguroj që procesi do të shkojë pa petkun politik, po ju siguroj që asnjë veprimtimin në Ministrinë e Brendshme nuk e kam me agjendë politike, po me agjendë institucionale. Është e sigurt që do të kemi pakënaqësi edhe në sistemin e procesit të reformave edhe të ndryshimeve, do të ndryshohen njerëzit sikur ne pjesën politike, edhe menaxhmenti i policisë. Ju siguroj që ata që janë më të mirët si menaxher, tani janë në vendet përkatëse në polici edhe ata do të punojnë dhe jam i sigurt që kanë kapacitete të punojnë jo vetëm në këtë rast, por edhe në raste të tjera.

Do të ketë, po ashtu, probleme të vjetra me të reën, po ju siguroj që nuk ka politikë në këtë mes dhe ka vetëm kualitet dhe kemi mbështetje të fuqishme në reformimin e policisë. Dhe, po ashtu, ju siguroj që gjithçka po bëjmë një partneritet dhe një mbështetje me ata partnerë që na kanë ndihmuar dhe vazhdojnë të na ndihmojnë.

Përveç asaj që policia ka krye disa operacione të cilat kanë ndikuar pozitivisht në dinjitetin e qytetarëve të Kosovës, fatkeqësisht ka ndodhur edhe një rast që e ka dëmtuar rëndë imazhin e policisë dhe i ka demotivuar edhe një pjesë të policisë që të jetë edhe më shumë e motivuar edhe më shumë në krye të detyrës. Po ju siguroj që ka vullnet të plotë politikë për ta mbështetur policinë, për të ndërtuar kapacitete të reja, për të kërkuar mbështetje edhe logjistike, edhe tjetër, që Policia e Kosovës të jetë ashtu siç ka qenë në trendin e avancimin, në trendin pozitiv të ngritjes së imazhit të vet.

Më lejoni t'ju them që na ka mbetur edhe një varg çështjesh që lidhen me reformat, kemi përmbyllur pjesën e legjislacionit. Mos harroni, vetëm për një periudhë të shkurtër ne kemi aprovuar legjislacion që përfshinë këtë sferë kaq të rëndësishme. Na ka mbetur edhe një numër i madh i aktiviteteve që kërkohen për t'i adaptuar strukturat tona në kuadër ose në përputhje me legjislacionin e ri dhe në kuadër me kërkesat që lypen nga ne për të qenë të krahasueshëm me standardet ndërkombëtare. Ka edhe një varg çështjesh për të cilat na duhet një partneritet i madh, jo vetëm si qeverisje me institucione vendore, por edhe me legjislativin, edhe me shoqërinë civile, me qytetarët në përgjithësi.

Dëshiroj ta shfrytëzoj rastin, për fund, edhe ju t'ju inkurajoj, por sidomos t'i ftoj qytetarët të bashkëpunojnë me policinë, me organet e rendit. Ata janë të përkushtuar në luftimin e krimit, të marrin përgjegjësitë tona të gjithë për t'u përballur bashkërisht edhe në tejkalimin e pengesave, edhe në zbardhjen sa më të shpejtë të këtij rasti, por edhe në

përballjen e mëvonshme me rastet e ndryshme në të cilat ne mund të përballemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kjo seancë është thirr, të nderuar deputetë, nga Kryetari dhe Kryesia e Kuvendit, në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare. Pa asnjë kundërshtim nga Kryesia dhe shefat e grupeve parlamentare është vlerësuar ose janë vlerësuar rekomandimet e Komisionit si tejkalim i përgjegjësive, për faktin se pushtetet janë të ndara. Deputetët mund të pajisen edhe me procesverbalin e asaj mbledhjeje dhe unë kërkoj që deputetëve t'u shpërndahet kjo pjesë kur është biseduar për këtë seancë.

Është mirë që deputetët t'i shikojnë fjalët e tyre dhe në mandatin e kaluar. Debati i kishte anët e mira dhe të dobëta të këtij, por në fund të fundit, kështu e kanë debatet, kur ka edhe përpjekje të politizimit të skajshëm të kësaj ndodhie, që vërtet është e dhimbshme jo vetëm për Policinë e Kosovës, jo vetëm për Qeverinë e Kosovës, por për të gjitha proceset që janë duke u zhvilluar në Kosovë. Do të thotë, është një diçka që nuk na është dashur, nuk i është dashur askujt, besoj që më së paku i është dashur Policisë së Kosovës.

Kërkesa e Kryesisë ka qenë që kjo të jetë informatë. Kemi kërkuar nga ministri që edhe kjo informatë mos të dëmtojë procesin e hetimeve. Ndoshta është kështu siç është edhe për shkak të kërkesës që e kemi bërë ne. Sigurisht që pajtohem me gjithë ata që u angazhuan për një polici sa më profesionale. Po, ky është niveli i institucioneve tona, dëshira është diçka tjetër dhe mundësitë janë diçka tjetër.

Konsideroj se debati në përgjithësi ishte i frytshëm. Ne si deputetë dhe Parlament kemi obligim të presim rezultatet e hetimeve dhe sigurisht që nuk është çështja e fundit ose hera e fundit që Parlamenti do të merret me punën që kryen Ministria e Punëve të Brendshme, por edhe i gjithë Kabineti qeveritar. Natyrisht, vullneti i të gjithëve është që vërtet ngjarjet e tilla mos të ndodhnin as në Polici, as jashtë saj, por kjo është vetëm një dëshirë e mirë, mundësitë janë të tjera.

Po shpresojmë që edhe Qeveria, edhe njerëzit përgjegjës, këtë debat ta marrin me seriozitet dhe natyrisht që ka vend për përgjegjësi.

Konsideroj se Kuvendi dhe debati që është zhvillua sot, në shumicën e rasteve ka debatuar me përgjegjësi dhe me qëllimin më të mirë që, vërtet, kjo gjendje, do të thotë ky rast të zbardhet dhe ata që e kanë bërë këtë vjedhje të dalin para drejtësisë. Mendoj që nuk ka në këtë sallë njeri që nuk do ta dëshironte që jo vetëm ky rast, por të gjitha rastet e dhimbshme që kanë ndodhur në Kosovë pas qershorit të vitit '99, vullneti im do të ishte që të zbardheshin dhe të gjithë përgjegjësit të dilnin para drejtësisë dhe ta merrnin dënimin e merituar. Të shpresojmë që ky rast do të zbardhet dhe policia, por edhe drejtësia do ta kryejnë detyrën e vet konform kushtetutës dhe ligjit që janë fuqi.

Dhe, me këtë konstatoj se debatin për këtë seancë e mbyllëm. Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale.